

POLITIKA MJEDISORE DHE SOCIALE E BERZH

E miratuar nga Bordi i Drejtorëve
12 Maj 2008

Politika Mjedisore dhe Sociale është përkthyer nga versioni origjinal në gjuhën angleze në disa gjuhë të tjera, ku përfshihet edhe gjuha shqipe, për të ndihmuar kuptimin sa më të mirë të politikës nga aksionerët e ndryshëm të Bankës. Ndërsa Banka është përpjekur të sigurojë një përkthim të saktë, Banka nuk siguron përpikmërinë ose autencitetin e këtij përkthimi në shqip. Në rastin e ndonjë mospërputhje ndërmjet versionit në gjuhën angleze të Politikës Mjedisore dhe Sociale dhe përkthimit në një gjuhë tjetër, versioni në gjuhën angleze është përfundimtar dhe do të merret për bazë.

Politika Mjedisore dhe Sociale	
A. Qëllimi i kësaj Politike	3
B. Angazhimi i BERZH-it	3
C. Integrimi i çështjeve mjedisore dhe sociale në ciklin e projektit.	6
Roli dhe përgjegjësitë e BERZH-it	6
Kërkesat e Performancës (KP)	8
E. Nxitja e investimeve me përfutime të mëdha mjedisore dhe sociale, ku përfshihen edhe puna në bashkëpunim me të tjerët	11
F. Strategjitë e Vendit dhe Sektoriale	12
G. Marrveshjet Institucionale dhe Zbatuese	13
Shtojca 1: Projektet e Kategorisë A	13
Shtojca 2: Lista e BERZH-it për Përjashtimet Sociale dhe Mjedisore	16
Kërkesa e Performancës	18
Plani i Veprimtimit Mjedisor dhe Social (PVMS)	21
KP 2:	25
Puna dhe Kushtet e Punës	25
Kushtet e punës dhe termat e punësimit	26
Shkurtimet	28
Zinxhiri i furnitorëve	28
KP 5:	41
KP 6:	52
Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla	52
KP 8:	68
Trashëgimia kulturore	68
KP 9:	73
Ndërmjetësit Financiarë	73
Proçesi i vlerësimit (due diligence) mjedisor dhe social dhe procedurat e monitorimit	74
Kërkesat për nën-projektet	74
Kapaciteti organizativ brenda Ndërmjetësit Financiar	75
KP 9 - Shtojca 1:	77
Lista e BERZH për Përjashtimin Mjedisor dhe Social	77

Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it

A. Qëllimi i kësaj Politike

1. BERZH është angazhuar të mbështesë “zhvillimin mjedisor dhe të qëndrueshëm” në tërësinë e të gjithë investimeve të saj dhe aktivitetet e bashkëpunimit teknik në vazhdim të marrëveshjes së tij, Marrëveshjes së Themelimit të BERZH-it¹. Banka² beson se zhvillimi i qëndrueshëm është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të biznesit. Për këtë arsye, qëllimi i BERZH për nxitjen e tranzicionit në ekonomitë e tregut dhe nxitja e zhvillimit të sipërmarrjeve private dhe angazhimi i saj në zhvillimin e qëndrueshëm janë të lidhur në mënyrë të paevitueshme. Të gjitha projektet e financuara nga BERZH-i duhet të përmbushin parimet kryesore të veprimtarisë së Bankës si efekti shtues, ndikimi i tranzicionit dhe praktikave të shëndosha bankare. Në vazhdim, Banka thekson se financimi i një zhvillimi të qëndrueshëm duhet të renditet ndër prioritetet më të larta të aktiviteteve të BERZH-it.
2. Kjo politikë mbulon dimensionet mjedisore dhe sociale të zhvillimit të qëndrueshëm. Në qëllim të kësaj politike, dimensionet social përfshin (i) standartet e punëtorëve dhe kushtet e punës ku përfshihen shëndeti profesional dhe siguria dhe (ii) ndikimet mbi popullsinë si shëndeti publik, siguria dhe mbrojtja, barazia gjinore, ndikimet mbi popullsinë vendase dhe trashëgiminë kulturore, zhvendosjet e pavullnetshme të popullsisë dhe mundësia për shërbimet kryesore. Politika përshkruan se si Banka do të vendosë në praktikë angazhimin e saj në nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale duke:
 - Përfshirjen e konsideratave mjedisore dhe sociale në të gjitha aktivitetet e saj;
 - Përcaktimi për klientët i kërkesave e performancës mjedisore dhe sociale që ata duhet të përmbushin brenda një periudhe kohore të miratuar nga Banka;
 - Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësisë përkatëse të Bankës dhe klientëve të saj në arritjen e rezultateve të qëndrueshme në përputhje me Politikën dhe kërkesat e performancës;
 - Përcaktimi i një qëllimi strategjik për nxitjen e projekteve me sa më shumë përfitime mjedisore dhe sociale.

B. Angazhimi i BERZH-it

3. BERZH do të përpiqet të sigurojë nëpërmjet vlerësimit të saj mjedisor dhe social dhe proceseve të monitorimit, që projektet që ajo financon:
 - janë të qëndrueshme nga ana sociale dhe mjedisore;
 - respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe popullsisë së ndikuar;
 - dhe janë të projektuar dhe të zbatuar në përputhje me kërkesat e rregullores së aplikuar dhe praktikës më të mirë ndërkombëtare.

Në mënyrë që këto objektiva të kthehen në rezultate të suksesshme dhe praktike, Banka ka miratuar një strukturë gjithëpërfshirëse të Kërkesave specifike të Performancës (KP) që klientët duhet të përmbushin, ku përfshihen zonat kryesore të ndikimeve dhe çështjeve mjedisore dhe sociale. Banka është angazhuar të përkrahë standartet mjedisore të BE si edhe

¹ Shih Nenin 2.1 (vii) të Marrëveshjes së Themelimit të BERZH-it

² Në këtë Politikë, fjalët “BERZH” dhe “Bankë” përdoren duke nënkuptuar njëra tjetrën

Parimet Europiane për Mjedisin, ku BERZH është nënshkruese e saj, dhe që reflektohen në KP³. Banka shpreson që klientët të vlerësojnë dhe menaxhojnë çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet e tyre në mënyrë që projektet të plotësojnë KP. Roli i Bankës është të: (i) rishikojë vlerësimet e klientit ; (ii) të ndihmojë klientët në zhvillimin e masave të duhura dhe efikase për të parandaluar ose atëherë kur kjo nuk është e mundur të minimizojnë, lehtësojnë ose të mënjanojnë ose kompesojnë për ndikimet negative sociale dhe mjedisore në përputhje me KP; (iii) të ndihmojë të zbulohen mundësitë për përfitime të mëtejshme mjedisore ose sociale; dhe (iv) të monitorojë përputhjen e projektit me marrëveshjet e tij mjedisore dhe sociale për sa kohë Banka ruan interesin financiar për projektin⁴.

4. Banka do të rritë vlerësimin e ndikimit të tranzicionit të projekteve të propozuara⁵ për të reflektuar në mënyrë më të qartë dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe sistematik të tranzicionit dhe përfitimet e një rruge strategjike në këtë fushë. Çdo projekt i financuar nga BERZH në kërkim të objektivave të qëndrueshme të zhvillimit do të jetë në përputhje të plotë me mandatin e tranzicionit të Bankës.
5. Banka është e interesuar të financojë projekte që kanë mundësinë që të japin përfitime shtesë mjedisore dhe sociale, si p.sh përfitime sociale-ekonomike për popullsinë që ndikohet nga zhvillimi i projektit dhe atje ku është e mundur dhe e realizueshme, mundësi të barabartë ndaj këtyre përfitimeve ndërmjet palëve që ndikohen nga projekti. Një vëmendje e veçantë do të kushtohet projekteve të cilat përfshijnë elementë që fokusohen mbi çështjet mjedisore dhe sociale të rëndësishme që hasen në rajon dhe që nxitin zbatimin e strategjive përkatëse të BE, siç është lehtësimi dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, shkretëtirëzimi, ruajtja e shumëllojshmërisë së botës bimore dhe shtazore (biodiversitetit), eficienta e energjisë dhe burimeve; zvogëlimi i varfërisë; nxitja e punëve të përshtatshme; pakësimi i përjashtimeve sociale; mundësia për të përdorur shërbimet themelore, barazia gjinore, transparencja dhe zhvillimi social. Gjithashtu BERZH do të vlerësojë nëse këto projekte të propozuara do të kontribuojnë në zhvillimin e vendit ku do të realizohen dhe ti japin përfitime popullsisë që ndikohet nga projekti në fushën ekonomike, sociale ose mjedisore. BERZH do të ndërtojë ortakëri me klientë për ti ndihmuar ata në rritjen e vlerës të aktiviteteve të tyre, përmirësimin e qëndrueshmërisë me afat të gjatë dhe përfundimin e kapacitetit të menaxhimit të tyre mjedisor dhe social.
6. Banka e konsideron rëndësinë e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike si prioritetin kryesor për aktivitetet e Bankës në rajon. Ajo ka si qëllim të zhvillojë më tej përpjekjet e saj ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në lidhje me zvogëlimin e gazeve të efektit serë, përshtatjes, nxitjes së burimeve të rinoveshme dhe përmirësimit të eficientës së energjisë, në pikëpamjen e përfundimit të trajtimit të këtyre elementëve në veprimtaritë e saj.
7. BERZH i kushton një rëndësi të veçantë parimeve në lidhje me transparencën⁶ e korporatës, përgjegjshmërinë dhe angazhimin e pronarit. Ajo do të publikojë në mënyrë të vazhdueshme, informacione në lidhje me aktivitetin e bankës në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale dhe do të angazhohet në një dialog efektiv me aksionerët e Bankës. Banka do të nxisë zhvillimin e praktikave të ngjashme me klientët e saj. Veçanërisht, BERZH pretendon që klientët të bashkëpunojnë me aksionerët e tyre në mënyrë të

³ Teksti i Parimeve Evropiane për Mjedisin (PEM) mund të gjendet në: www.eib.org/infocentre/epe/declaration/index.htm. PEM është një nismë e marrë për të tju përgjigjur tendencës për një harmonizim më të madh të parimeve, praktikave dhe standarteve mjedisore të lidhura me financimin e projekteve. PEM përcaktohet si principet udhërrëfyese mjedisore në Traktatin e Komisionit Evropian dhe e praktikave dhe standarteve të trupëzuara në legjislacionin detyrësor të BE-së. Detyrimet që rrjedhin prej PEM janë pasqyruar në KP 1, 2, 3, 4 dhe 10.

⁴ Për qëllime të kësaj Politike, Banka nuk konsideron të ketë interesa financiare në një projekt kur ai është shitur, ose ka dalë jashtë skemës së investimit (borxh apo aksioner) në termat të pagesave të mbetura.

⁵ Ndikimi i tranzicionit të projekteve vlerësohet nga Zyra e KryeEkonomistit të Bankës

⁶ Banka ka kërkesa specifike për mirëqeverisjen, pastrimin e parave, rryshfetin dhe korupsionin, transparencën e të ardhurave dhe dhënien e informacionit rreth tarifave, të cilat janë të përshkruara në dokumenta të tjera politike të Bankës.

⁷, Direktivën e BEsë mbi

Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dhe për projekte me ndikim mjedisor të madh ndërkufitar, Konventën e UNECE mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar⁸, pavarësisht nga statusi i ratifikimit.

8. BERZH mbështet një tërësi masash mbrojtëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të biodiversitetit (si psh kafshët e egra, peshqit dhe produktet e pyllit) dhe do të kërkojë të sigurojë që veprimtaritë e saj të përfshijnë masa për mbrojtjen e habitateve shumë të rëndësishme dhe atje ku është e mundur të shtohen vendbanimet natyrore dhe biodiversiteti që mbajnë.
9. BERZH do të kërkojë në mënyrë aktive, nëpërmjet investimeve të saj, të ndihmojë në zbatimin e parimeve përkatëse dhe rregullave të ligjit ndërkombëtar në lidhje me mjedisin, punën, përgjegjësinë e korporatave⁹ dhe publikimin e informacionit mjedisor. Këto parime dhe rregulla janë parashtruar në traktate, konventa dhe marrëveshje shumëpalëshe, rajonale dhe dypalëshe si edhe në dokumenta të tjera përkatëse, por jo-detyruese. BERZH nuk do të financojë projekte të cilat bien në kundërshtim me detyrimet e vendit në traktatet përkatëse ndërkombëtare dhe marrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm, siç përcaktohen në vlerësimin e projektit.
10. BERZH do të bashkëpunojë me institucionet e tjera ndërkombëtare financiare, Bashkimin Europian, donatorët dypalësh, agjencitë e KE dhe organizata të tjera për koordinimin e ndërhyrjeve efektive për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në nivelin rajonal dhe sektorial në shtetet ku BERZH vepron. Në rastet e bashkëpunimit me institucionet e tjera financiare ndërkombëtare, BERZH do të bashkëpunojë me to për të zgjedhur një rrugë të përbashkët për vlerësimin e projektit, kërkesat e projektit dhe monitorimin e tij.
11. Nëpërmjet aktiviteteve të saj të bashkëpunimit teknik, BERZH do të angazhohet në mbështetjen për sigurimin e programeve konstruktive dhe forma të tjera të asistencës për rritjen e projekteve që Banka financon; p.sh duke nxitur praktika për një biznes të qëndrueshëm dhe përgjegjësi për korporatat, duke ndërtuar kapacitetin e nevojshëm për vlerësimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore dhe sociale në shtetet ku Banka vepron ose duke rritur mundësitë e barabarta për përfitimet e mundshme nga projektet e financuara nga Banka.
12. BERZH do të angazhohet në diskutimin e kësaj ploitike dhe atje ku është e nevojshme të sigurojë asistencë teknike për të punuar me njësitë qeveritare dhe partnerë të tjerë për zgjidhjen e çështjeve strukturore dhe të veçanta që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm.
13. Në aktivitetin e saj të brendshëm, BERZH do të ndjekë praktikat më të mira në menaxhimin mjedisor (ku përfshihet edhe efiçenca e energjisë dhe e burimeve, pakësimi i mbetjeve dhe riciklimi) dhe në menaxhimin e burimeve mjedisore (si psh. mundësitë e barabarta, balacimi i punës/jetës, shëndeti dhe siguria). BERZH do të kërkojë të punojë me furnitorë dhe kontraktorë, të cilët zbatojnë standarte të larta të ngjashme mjedisore dhe sociale. Banka do të konsiderojë çështjet e qëndrueshmërisë për sigurimin e të mirave dhe shërbimeve të brendshme.

⁷ “Konventa e Arhusit”: www.unece.org/env/pp

⁸ “Konventa e Espoos”: www.unece.org/env/eia

⁹ Instrumentat ndërkombëtare të miratuar për përgjegjësinë e korporatave përfshijnë Deklaratën Trepalëshe të Parimeve lidhur me Ndërmarrjet Shumëkombëshe dhe Politikën Sociale të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Udhëzuesin për Ndërmarrjet Shumëkombëshe të Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD)

**C. Integrimi i çështjeve mjedisore dhe sociale në ciklin e projektit.
Roli dhe përgjegjësitë e BERZH-it**

Proçesi i vlerësimit të projektit

Metoda e përgjithshme

14. Të gjitha projektet e financuara nga BERZH i nënshtrohen një vlerësimi mjedisor dhe social për të vendosur nëse një aktivitet duhet të financohet, dhe nëse pranohet, mënyra se si duhet të trajtohen çështjet mjedisore dhe sociale në planifikimin, financimin dhe zbatimin e projektit. Vlerësimi social dhe mjedisor i kryer nga BERZH është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të projektit nga BERZH, ku përfshihen edhe vlerësimi i risqeve financiare e të reputacionit dhe identifikimi i mundësive të rëndësishme mjedisore dhe sociale. Ky vlerësim duhet të përshtatet me natyrën dhe rëndësinë e projektit dhe duhet të përputhet me nivelin e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social. Ky vlerësim do të vërtetojë nëse aktivitetet e mbështetura financiarisht nga BERZH mund të zbatohen në përputhje me këtë Politikë dhe Kërkesat e Performancës (KP) të saj. Klienti ka përgjegjësi të sigurojë që studimet e procesit të vlerësimit (*due diligence*), publikimi i informacionit dhe angazhimi i aksionerëve të kryhen në përputhje me KP nga 1 deri në 10 dhe të paraqiten tek BERZH për rishikim si pjesë e vlerësimit të Bankës. BERZH do të rishikojë informacionin e paraqitur, dhe do të sigurojë udhëzime për klientin se si projekti mund të arrijë kërkesat e Bankës.
15. Vlerësimi mjedisor dhe social i BERZH përfshin vlerësimin e tre elementëve kryesorë: (i) ndikimet dhe çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me projektin e propozuar, (ii) mundësia dhe angazhimi i klientit të zgjidhë këto ndikime dhe çështje në përputhje me këtë politikë, dhe (iii) roli i palëve të treta në arritjen e përputhshmërisë me këtë Politikë
16. BERZH mund të refuzojë financimin e një projekti të propozuar për arsye mjedisore dhe sociale, p.sh kur një projekt i propozuar nuk arrin të përmbushë çështjet mjedisore dhe sociale në mënyrën e kërkuar dhe nuk pritet që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në KP të aplikuara në këtë Politikë, brenda një periudhë kohe që konsiderohet e arsyeshme nga Banka, ose kur ndikimet mbetëse janë të papranueshme. Për më tepër, ka disa lloje aktiviteteve që BERZH nuk financon. Një listë e këtyre aktiviteteve mund të gjendet në Shtojcën 2.
17. Në këtë Politikë, termi “projekt” i referohet aktivitetit të biznesit për të cilin financimi i BERZH është kërkuar nga klienti pavarësisht nga lloji i financimit të BERZH. Financimet e BERZH (p.sh proçesi i sigurimit të financimit) përfshin lloje të ndryshme financimi për projektet e propozuara, si p.sh financim i projektit me mbështetje financuese/të kufizuar, financimi i përbashkët, kapital aktiv, aksioner i pjesshëm, aksioner ose grante.
18. BERZH administron një numër të caktuar Fondesh Speciale dhe fonde bashkëpunimi. Projektet ose aktivitetet që financohen të plota ose pjesërisht nga Fondet Speciale duhet të përputhen me këtë politikë. Gjithashtu, kjo politikë do të zbatohet për fondet e bashkëpunimit, megjithëse mund të zbatohen edhe kërkesa shtesë të donatorëve që lidhen me çështjet mjedisore dhe sociale në përputhje me këtë Politikë.

Kategorizimi

19. BERZH i kategorizon projektet e propozuara në A/B/C/FI bazuar në kriteret mjedisore dhe sociale për të: (i) reflektuar nivelin e ndikimit dhe çështjet e rëndësishme mjedisore dhe sociale që lidhen me projektin e propozuar dhe (ii) përcaktuar llojin dhe nivelin e kërkimeve mjedisore dhe sociale, publikimin e informacionit, vendodhjen, ndjeshmërinë dhe nivelin e

*Operacionet Direkte Investuese*¹⁰

20. Një projekt i propozuar klasifikohet në Kategorinë A nëse ai mund të rezultojë të ketë ndikime dhe çështje mjedisore dhe/ose sociale të rëndësishme dhe të pafavorshme në të ardhmen, të cilat në kohën e kategorizimit nuk mund të identifikohen ose vlerësohen dhe që kanë nevojë për një proces vlerësimi formal të kryer nga specialistë të pavarur, që i përkasin palëve të treta në përputhje me KP. Një listë treguese e projekteve të Kategorisë A paraqitet në Shtojcën 1 të kësaj Politike.
21. Një projekt i propozuar klasifikohet në Kategorinë B nëse ndikimet mjedisore dhe/ose sociale të pafavorshme që mund të lindin janë tipike për atë vend dhe/ose të identifikuar lehtë dhe të përcaktuara nëpërmjet masave lehtësuese. Këto ndikime mund të vijnë nga aktivitete të kaluara, aktuale ose të ardhshme. Kërkesat e procesit të vlerësimit (*due diligence*) mund të ndryshojnë në varësi të projektit dhe do të përputhen me kërkesat e BERZH në bazë të çdo çështjeje në përputhje me KP1.
22. Një projekt i propozuar klasifikohet në Kategorinë C kur ai rezulton të mos ketë ndikime të pafavorshme mjedisore ose sociale ose kur këto ndikime janë minimale dhe si rezultat nuk kanë nevojë për vlerësim të mëtejshëm mjedisor dhe social, përveç kategorizimit.
23. Kontrollat Fillestare Mjedisore dhe Sociale (KFMS) duhet të kryhen nga specialistët mjedisorë dhe socialë të BERZH në rastet kur ka informacion disponibël të pamjaftueshëm në kohën e kryerjes së kategorizimit për të përcaktuar kategorinë përkatëse dhe qëllimin e procesit të vlerësimit (*due diligence*).

Operacionet Financiare të Ndërmjetme

24. Një projekt i propozuar do të klasifikohet si FI nëse BERZH siguron financimin për një ndërmjetës financiar (FI). Bashkëpunimi me FI është një mënyrë e rëndësishme për BERZH për nxitjen e tregjeve financiare të qëndrueshme dhe të sigurojë mjete për orientimin e financimeve të BERZH në sektorin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe mesatare (SME). Ndërmjet të tjerave, përfshihen edhe fondet me aksione private, bankat, kompanitë leasing, kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve. Përpara vendosjes së marrëdhënieve me një institucion financiar (FI), BERZH kryen një proces vlerësimi (*due diligence*) mbi këtë institucion dhe portofolin e tij për të vlerësuar (i) politikën egzistuese mjedisore dhe sociale dhe procedurat e këtij institucioni në përputhje me KP të Bankës dhe kapacitetin e saj për ti zbatuar ato; si edhe (ii) çështjet mjedisore dhe sociale të lidhura me portofolin egzistues dhe të ardhshëm të institucionit FI.

Angazhimi i aksionerit

25. KP 10 përcakton kërkesat e Bankës për klientët për të identifikuar aksionerët e ndikuar më shumë nga projektet e tyre, të publikojë informacionin e mjaftueshëm në lidhje me çështjet dhe ndikimet që rrjedhin nga projekti dhe konsultimi me aksionerët me mënyrën e duhur të

¹⁰ Fjala “Operacionet Direkte Investuese” përdoret si fjala e kundërt e “Operacionet e Ndërmjetme Financiare”. Në rastin “Operacioneve të Ndërmjetme Financiare” klienti është ofruesi i shërbimeve financiare. Të gjitha operacionet e tjera referohen si Operacionet Direkte Investuese

kuptueshme dhe sipas veçorive kulturore përkatëse. Në disa raste, Banka mund të drejtojë aktivitetet e veta të konsultimit publik për projektet e Kategorisë A në mënyrë që të gjykojë pikëpamjet e aksionerëve për rolin kryesor që ka Banka në financimin e projektit. Identifikimi dhe angazhimi i aksionerit duhet të paraqitet në mënyrën e duhur në aktivitetet e bashkëpunimit teknik të Bankës.

26. Dokumentacioni i paraqitur për miratim në Bordin e Drejtorëve të BERZH për një projekt duhet të përfshijë një përshkrim të programit të angazhimit të aksionerit, të klientit, komente dhe opinione mbi praktikën e klientit ose ndikimin e mundshëm të projektit të shprehura nga aksionerët, dhe mënyrën se si këto çështje po zgjidhen ose do të zgjidhen nga klientët në përputhje me KP 10. Bordi i Drejtorëve do të marrë në konsideratë komentet dhe shqetësimet e të gjithë aksionerëve në procesin e tij të vendimmarrjes si pjesë e vlerësimit të përfitimeve dhe riskut të përgjithshëm të projektit të Bankës.

Kërkesat e Performancës (KP)

27. Projektet e financuara nga Banka duhet të përputhen me praktikën më të mira ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm. Për të ndihmuar klientët dhe/ose projektet e tyre për të arritur këtë, Banka ka përcaktuar disa Kërkesa të Performancës specifike për fushat kryesore të çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale në renditjen e mëposhtme:

- KP 1 - Menaxhimi dhe Vlerësimi Mjedisor dhe Social
- KP 2 - Kushtet e Punëtorëve dhe të Punës
- KP 3 - Parandalimi dhe Zvogëlimi i Ndotjes
- KP 4 - Shëndeti, Siguria dhe Mbrojtja e Komunitetit
- KP 5 - Blerja e Tokës, Risistemimi i Pavullnetshëm dhe Zhvendosjet Ekonomike
- KP 6 - Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore
- KP 7 - Popullsia Vendase
- KP 8 - Trashëgimia Kulturore
- KP 9 - Ndërmjetësit Financiarë
- KP 10 - Publikimi i Informacionit dhe Angazhimi i Aksionerëve

KP nga 1 në 8 dhe 10 përfshijnë kërkesat për projektet për investimet direkte; KP 2 dhe KP 9 për operacionet e ndërmjetësimit financiar. Çdo KP përcakton në objektivat e saj rezultatet e dëshiruara, të ndjekura nga kërkesat specifike për klientët për ti ndihmuar ata që të arrijnë këto rezultate. Përputhja me ligjet përkatëse kombëtare është një pjesë e rëndësishme e të gjitha KPve.

28. BERZH do të kërkojë klientëve strukturimin e projekteve në mënyrë që ata të plotësojnë të gjitha KP të zbatuara. Për këtë është thelbësore, kujdesi i vazhdueshëm për të gjetur rrugë për të parandaluar ndikimet e pafavorshme tek punonjësit, komuniteti dhe mjedisi ose nëse parandalimi nuk është i mundur, të zvogëlohen, lehtësohen ose të kompesohen ndikimet në mënyrën e duhur. Gjithahshtu KP sigurojnë një bazë të qëndrueshme, mbi të cilën klientët mund të përmirësojnë qëndrueshmërinë e aktivitetit të tyre të biznesit.
29. Mjete të reja dhe aktivitete biznesi të financuara nga BERZH do të krijohen për të përmbushur KP që nga fillimi i projekteve. Nëse aktiviteti i biznesit të propozuar për tu financuar nga BERZH lidhet me mjetet egzistuese që nuk plotësojnë KP në kohën e miratimit nga Bordi, klientit do ti kërkohet të përshtatë dhe zbatojë një Plan Veprimi

30. Kur nga kushtet e një projekti të veçantë kërkohen mënyra alternative nga ato të përshkuara në paragrafët 27-29, këto mënyra do të konsiderohen nga Bordi rast pas rasti. Për të përcaktuar nëse duhet miratuar ndonjë ndryshim nga kjo Politikë, Bordi do të konsiderojë mënyrat e propozuara kundrejt të gjitha kostove dhe përfitimeve mjedisore dhe/ose sociale të projektit.
31. Në të gjitha rastet, kërkesat që zbatohen për projektin do të përmbliidhen në Dokumentin Përmbledhës të Projektit dhe do të raportohen në Bordin e Drejtorëve.

Performanca e Palëve të treta

32. Në disa raste, aftësia e klientit për të arritur rezultatet sociale dhe mjedisore në përputhje me KP do të varet nga aktivitetet e palëve të treta. Një palë e tretë mund të jetë ndër të tjera një ndërmjetës qeveritar, një kontraktor, një furnitor me të cilin projekti/klienti ka një bashkëpunim të ngushtë ose një operator për një objekt të përbashkët. BERZH mundohet të sigurojë që projektet që ajo financon të kenë rezultate në përputhje me KP edhe nëse rezultatet përfundimtare janë në varësi të performancës së palëve të treta. Kur risku i palëve të treta është i lartë dhe klienti zotëron kontroll ose ndikon mbi veprimet dhe sjelljet e palëve të treta, BERZH do ti kërkojë klientit të bashkëpunojë me palët e treta për të arritur rezultatet në përputhje me KP. Kërkesa dhe veprime specifike me palët e treta duhen përcaktuar rast pas rasti.

Dokumentacioni ligjor

33. Marrëveshjet e investimit të BERZH me klientët në lidhje me një projekt duhet të përfshijnë dispozita të veçanta që reflektojnë kërkesat mjedisore, sociale dhe angazhimin aksioner të BERZH. Këto përfshijnë përputhshmërinë me të gjitha KP të zbatueshme dhe PVMS (nëse ka), si edhe dispozita për raportimin mjedisor dhe social, angazhimin e vazhdueshëm të aksionerit, auditimet periodike nga specialistë të pavarur, përfshirjen e kriterit të performancës mjedisore në përcaktimin e “Përfundim i Projektit”, auditet përmyllëse, dhe/ose vizitat monitoruese nga personeli ose përfaqësues të BERZH sipas rastit. Gjithashtu dokumentacioni ligjor do të përfshijë, atje ku përshtatet, të drejtat dhe/ose detyrimet e Bankës në rastet kur një huamarrës ose kompani investuese dështon në zbatimin e dispozitave mjedisore ose sociale gjatë periudhës së marrëveshjeve ligjore.

Monitorimi

34. Banka e konsideron mjaft të rëndësishme monitorimin e performancës mjedisore dhe sociale të projekteve. Monitorimi shërben për qëllime të ndryshme. E para është të sigurojë që standartet e zbatuara dhe përbërësit e ndryshëm mjedisorë dhe socialë të përfshirë në marrëveshjet ligjore, siç është zbatimi i një PVMS, të realizohen plotësisht. E dyta është të ndiqet ecuria e ndikimeve të vazhdueshme mjedisore dhe sociale që lidhen me investimet dhe të sigurohet dhënia e mendimeve mbi efektshmërinë e masave lehtësuese. Përfundimisht, duke ndjekur përmirësimet e arritura gjatë zbatimit të projektit, të dhënat

35. Monitorimi kryhet nga klienti dhe nga Banka. Shkalla e monitorimit duhet të lidhet me çështjet e projektit, ndikimet dhe përmbushjen e kërkesave dhe me aftësinë e klientit dhe/ose autoriteteve lokale për të monitoruar në mënyrën e duhur këto çështje dhe ndikime. Për çdo projekt, Banka do të përcaktojë me klientin një program monitorues në përputhje me KP 1 ose KP 9, duke specifikuar mjetet monitoruese të duhura duke u bazuar mbi rezultatet e procesit të vlerësimit (*due diligence*), rezultatet e çdo konsultimi publik që është kryer brenda sistemit të marrëveshjeve ligjore të rëna dakort me klientin.
36. Në mënyrë që të verifikohet zbatimi i duhur dhe në kohë i PVMS dhe zbatimi i marrëveshjeve mjedisore dhe sociale, Banka do të monitorojë projektet në mënyrë të vazhdueshme, përderisa Banka të ketë interes financiar për projektin, dhe do të ndajë me klientin rezultatet e monitorimit të saj¹¹. Mekanizmi i monitorimit përfshin ndër të tjerash: (i) rishikimin e raporteve periodike të dorëzuara nga klienti (me një minimum, një herë në vit) mbi zbatimin e PVMS dhe çdo kërkesë tjetër mjedisore dhe sociale, (ii) misionet monitoruese nga specialistët ose konsulentët mjedisorë dhe socialë të Bankës për kryerjen e vlerësimeve të detajuara të investimeve për çështje dhe ndikime të rëndësishme mjedisore dhe sociale, në mënyrë që të përcaktohet nëse klienti po zbaton PVMS dhe nëse është në përputhje me marrëveshjet mjedisore dhe sociale; dhe (iii) monitorimet periodike të palëve të treta, si p.sh nga specialistët e pavarur ose përfaqësuesit e komuniteteve lokale, të dorëzuara klientit dhe Bankës.
37. Nëse rrethanat kanë ndryshuar që nga vlerësimi i aktiviteteve të mëparshme monitoruese, dhe këto rezultojnë me ndikimet sociale dhe mjedisore të kundërta me ato të pritura, BERZH do të punojë me klientin për krijimin e një plani për ti adresuar këto çështje. Nëse klienti dështon në plotësimin e kërkesave sociale dhe mjedisore, siç shprehet në PVMS ose dokumentacionet e tjera ligjore, BERZH mund të bjerë dakort me klientin për masa rregulluese që duhet zbatuar nga klienti për tu mundësuar arritjen e përputhshmërisë sa më të mirë. Nëse klienti nuk mund të plotësojë sërish kushtet e vendosura, Banka mund të ndërmarrë veprime dhe/ose të zbatojë rregullime që përmbahen në dokumentacionin ligjor që ajo i konsideron të duhura. Gjithashtu, BERZH do të rishikojë me klientin çdo mundësi të përmirësimit të performancës që lidhet me projektin.

Vlerësimi

38. Vlerësimi i performancës mjedisore dhe sociale të Bankës dhe aspekteve mjedisore dhe sociale të projekteve të financuara nga BERZH kryhet nga Departamenti i Vlerësimit të Bankës (DV), i cili është i pavarur nga veprimtaritë e tjera të Bankës dhe raporton direkt tek Bordi i Drejtorëve të Bankës. Hapi i parë për vlerësime të tilla janë objektivat mjedisore dhe sociale të vendosura për çdo projekt në kohën e zbatimit të projektit, dhe Politika Mjedisore përkatëse, Strategjia e Vendit dhe ajo Sektoriale, efektive në kohën e zbatimit të projektit. Detaje mbi kriteret dhe proceset e vlerësimit të DV përcaktohen nga DV sipas procedurave, të cilat miratohen nga Bordi.

Ndryshimet Operacionale

¹¹ Në rastet kur BERZH shet një investim si aksionere, por ruan një interes minimal, ose në rastin e një instrumenti të bërë publik apo të tregtuar, aftësia e BERZH për të monitoruar aktivitetet mund të jetë e kufizuar. Gjithashtu, sikundërse është shprehur në shënimin nr. 4 në fund të faqes, atje ku BERZH ka shitur ose ka dalë jashtë skemës së investimit (borxhit ose si aksionere) për pagesa, Banka nuk ka interesa të mëtejshme financiare për atë projekt.

39. Në natyrën dhe qëllimin e projektit mund të ndodhin ndryshime, sikundërse edhe në veprimtarinë e BERZH, pas miratimit dhe nënshkrimit nga Banka. Këto ndryshime mund të jenë të lidhura me ndërlikime mjedisore dhe sociale.¹² Kur ndodhin ndryshime të tilla materiale, Banka do të kryejë një vlerësim të ndryshimeve të propozuara në përputhje me këtë politikë dhe dokumentacionit të modifikuar dhe ristrukturuar të projektit duhet ti bashkëngjiten shqyrtime të tjera shtesë të procesit të vlerësimit (*due diligence*), kërkesa të konsultimit publik dhe masa lehtësuese mjedisore dhe sociale. Kur ndryshimet operacionale rezultojnë në një mjedis të ndryshuar material dhe/ose në kushte të ndryshme sociale nga ato të miratuara prej Bankës, ndryshimi duhet të raportohet në nivelet e larta drejtuese, dhe nëse janë të përshtatshme duhet të paraqiten në Bord për informacion dhe miratim.

D. Raportimi Publik dhe Përgjegjësia e BERZH

40. BERZH do të publikojë një Raport Vjetor të Qëndrueshmërisë së aktiviteteve të saj mbi zbatimin e kësaj politike, duke përfshirë pa kufizime të gjithë informacionin rreth shkarkimeve të gazrave të efektit serrë, shpenzimet për mjedisin në projektet e financuara nga BERZH, dhe çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me portofolin e projektit të BERZH si edhe raportimin mbi performancën e brendshme mjedisore dhe sociale të BERZH.

41. Çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me investimet e BERZH do të përmbliidhen në Dokumentet Përmbledhëse të Projektit (DPP) të BERZH siç kërkohen nga Politika e Informacionit Publik të Bankës¹³.

42. BERZH ka vendosur një Mekanizëm të Pavarur Ndihme (MPN) për të vlerësuar dhe rishikuar pakënaqësitë në lidhje me projektet e financuara nga BERZH. MPN ju mundëson grupeve lokale që mund të ndikohen direkt dhe negativisht nga një projekt i Bankës, një mënyrë për të paraqitur pakënaqësitë dhe ankesat për Bankën, në mënyrë të pavarur nga veprimtaria e Bankës. MPN ka dy funksione: një funksion për Rishikimin e Ankesave që vlerëson nëse Banka ka vepruar në përputhje me politikën e saj, veçanërisht lidhur me këtë Politikë dhe dispozitat e veçanta të projektit lidhur me zbatimin e Politikës së Informimit Publik për një projekt të veçantë; dhe funksionin e zgjidhjes së problemit, që synon të vendosë një komunikim ndërmjet palëve, veçanërisht ndërmjet anëtarëve të grupit të ndikuar dhe sponsorit të projektit, për zgjidhjen e çështjeve që kanë çuar në paraqitjen e shqetësimeve dhe ankesave. Vlerësimi e një ankesë mund të ketë rezultojë në një rekomandim për Rishikimin e Ankesës, ose një Nismë për Zgjidhjen e Problemit ose të dyja, ose asnjë prej tyre¹⁴.

E. Nxitja e investimeve me përfitime të mëdha mjedisore dhe sociale, ku përfshihen edhe puna në bashkëpjesëmarrje me të tjerët

43. Në vazhdim të monitorimit të ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe çështjeve që lidhen me të gjitha veprimtaritë, BERZH do të ndërmarrë një sipërmarrje të re parandaluese për nxitjen e projekteve dhe nisma për të marrë veçanërisht përfitime të rëndësishme mjedisore

¹² Kthimi nga një hua në aksione, për shembull, mund ta përfshijë BERZH si të bashkëlidhur me projektin, vendin e investimit ose pajisjet të cilat nuk janë vlerësuar më parë, dhe që mund të ketë barrë të rëndësishme mjedisore ose probleme me përputhshmërinë e punës.

¹³ DPP mund të merren në Njësinë e Botimeve të BERZH dhe në Qendrën e Informacionit si dhe në faqen e internet të BERZH (www.ebrd.com)

¹⁴ Shih www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/.

dhe sociale. Kjo sipërmarrje do të përfshijë:

- Zbatimin e asistencës teknike për plotësimin e projekteve egzistuese ose të propozuara të BERZH, ku përfshihet zhvillimi i sistemeve efektive të menaxhimit, marrjen e çertifikimeve sipas skemave të ndryshme të cilësisë dhe ndihmën e klientëve për identifikimin dhe zbatimin e praktikave më të mira.
 - Përmirësimin e mjedisit të përshtatshëm në mënyrë që klientët e BERZH mund të zgjidhin sa më mirë çështjet mjedisore dhe sociale, duke përfshirë edhe ndihmën mbi reformat e politikës dhe rregullave, ndërtimin e kapaciteteve institucionale, studimet gjithë-sektoriale dhe vlerësime strategjike;
 - Nxitja e projekteve investuese të veçanta në fusha prioritare
 - Financimi i projekteve pilot për të eksploruar linja të reja biznesi me përfitime të mëdha mjedisore ose sociale.
44. Për këto nisma, BERZH do të kërkojë marrëdhënie bashkëpunuese me klientët, donatorët dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. BERZH do të mbajë dialog të rregullt mbi çështjet mjedisore dhe sociale me qeveritë donatore, organizatat ndërkombëtare, vendet e zbatimit të projektit dhe shoqërinë civile.
45. BERZH do të synojë të zhvillojë një mënyrë sistematike mbi identifikimin e mundësive për përmirësimet mjedisore dhe sociale nëpërmjet procesit të vlerësimit (*due diligence*) mjedisor dhe social dhe vlerësimit të projektit duke përfshirë edhe vlerësimet mjedisore dhe sociale ose auditimet, atje ku është e përshtatshme. Identifikimi i këtyre mundësive do të mundësojë klientëve të përfshijnë masat për përmirësimin e performancës mjedisore, sociale, operacionale dhe ekonomike të projektit si edhe do të ndihmojë ata të përmbushin kriteret bankare dhe të ndikimit të tranzicionit të BERZH-it.
46. BERZH do të mbështesë përmirësimet mjedisore dhe përdorimin efektiv të burimeve dhe shpërndarjes, nëpërmjet financimit të infrastrukturës mjedisore bashkiake si p.sh furnizimin me ujë të pijshëm, sistemin e kanalizimeve dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta. BERZH do të vlerësojë se në çfarë shkalle ndryshimi i tarifave mund të krijojë probleme për tu përballuar nga grupe të caktuara konsumatorësh dhe deri në çfarë shkalle mund të përmbushen kushtet e saj për ngritjen ose funksionimin e skemave mbështetëse efektive për lehtësimin e ndikimeve negative sociale. BERZH do të mbështesë masat mitiguese dhe përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike, duke investuar veçanërisht në projektet e efikasitetit të energjisë dhe burimet e energjive të rinovueshme dhe duke mbështetur praktikën më të mira përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike. Fusha të tjera me prioritet për nxitjen e projekteve me përfitime të rëndësishme mjedisore ose sociale, duke përfshirë edhe barazinë gjinore, do të përcaktohen në përputhje me paragrafin 5 të kësaj Politike.

F. Strategjitë e Vendit dhe Sektoriale

47. Çdo njëra prej strategjive të vendit dhe ato sektoriale të Bankës do të reflektojnë mandatin e qëndrueshmërisë së BERZH dhe do të përmbajnë një pjesë që përshkruan ndërlidhjet dhe mundësitë mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të propozuara nga BERZH, duke përfshirë edhe projektet e bashkëpunimit teknik. Strategjitë do të përmbledhin çështjet kryesore mjedisore, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe çështje të tjera sociale në vendin/sectorin përkatës dhe paraqesin propozimet e BERZH për të marrë në konsideratë këto çështje në aktivitetet e saj, ku është e përshtatshme. Për të përshkruar çështjet kryesore mjedisore, sociale dhe të të drejtave njerëzore në vend, strategjitë për vendet do të përgatiten mbi planet dhe strategjitë mjedisore dhe sociale të vendit (si p.sh Planet Kombëtare të Veprimtimit në Mjedis, Strategjitë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Strategjitë Adaptuese për

G. Marrveshjet Institucionale dhe Zbatuese

48. Për të siguruar që udhëzimet strategjike të përshkruara më lart do të orientohen në mënyrën e duhur, BERZH do të japë burimet e duhura për të siguruar një zbatim efektiv të kësaj Politike. Për të filluar dhe zhvilluar projekte përfutuese mjedisore dhe sociale, Banka do të ketë personelin e duhur për të mbikqyrur vlerësimin mjedisor e social dhe proceset monitoruese.
49. Kjo politikë do hyjë në zbatim 6 muaj pas miratimit të saj prej Bordi i Drejtorëve. Projektet që marrin miratimin fillestar nga drejtuesit e Bankës¹⁵ përpara hyrjes në zbatim të kësaj politike, do të nënshtrohen Politikës Mjedisore të Bankës të vitit 2003.
50. BERZH do të zhvillojë dhe mbajë Proçedurat Mjedisore dhe Sociale dhe shënimet dhe mjetet e duhura orientuese për të ndihmuar në zbatimin e kësaj politike, dhe do të sigurojë që punonjësit të nënshtrohen trajnimit përkatës sipas kërkesave të kësaj Politike.
51. BERZH do të vazhdojë të ndihmohet nga Këshilli i saj Konsultativ Mjedisor dhe Social (KKMS) pikëpamjet e të cilit do të kërkohen në çështjet të lidhura me politikën e përgjithshme dhe mbi politikat e të gjithë sektorëve para finalizimit të tyre. Pikëpamjet e tij mund të kërkohen edhe për çështje specifike të projekteve për financim BERZH.
52. BERZH do të monitorojë dhe vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme performancën e saj mjedisore dhe sociale përkundrejt qëllimeve të kësaj Politike. Kërkesat e Performancës do të rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe mund të ndryshohen ose rishikohen, në varësi të miratimit të Bordit të Drejtorëve. Për më tepër, Politika do të rishikohet nga Bordi i Drejtorëve çdo pesë vjet.

Shtojca 1: Projektet e Kategorisë A

Kjo listë i referohet “projekteve që zbatohen për herë të parë” ose projekteve që pësojnë zgjerimeve të mëdha apo transformime në kategoritë e poshtë shënuara. Lista është vetëm udhëzuese dhe projektet që përmenden janë shembuj. Kategorizimi i çdo projekti do të varet nga natyra dhe zgjerimi i mundshëm që sjell ndryshim mjedisor apo ndikim social siç është përcaktuar në specifikimet gjatë projektimit, veprimit dhe vendndodhjes së tij.

1. Rafineritë e naftës së papërpunuar (përfshijë ndërmarrjet që përpunojnë nënprodukte të naftës) dhe instalimet për gazifikimin dhe gazit të lëngët me kapacitet 500 tonë ose më shumë çmyrguri ose rërë bituminoze në ditë.
2. Termocentralet dhe instalime të tjera për djegie që prodhojnë nxehtësi prej 300 megavat¹⁶ ose më shumë, centrale të energjisë bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë përfshirë çmontimin ose shkatërrimin e këtyre centraleve ose reaktorëve të energjisë (përveç instalimeve për kërkimin shkencor në prodhimin dhe shndërrimin e materialeve të fuzionit dhe zbërthimit,

¹⁵ Në kohën e miratimit të kësaj Politike, ky miratim paraprak quhej “Vlerësim i Idesë”

¹⁶ E barazvlefshme me prodhim energjie bruto prej 140 MW për termocentralet për avull dhe turbinat me një cikël të vetëm për gazin

energjia maksimale e të cilëve nuk kalon 1 kilovat ngarkesë të vazhdueshme termike).

3. Instalimet e projektuara për prodhimin ose pasurimin e karburanteve / mbushjeve bërthamor, ripërpunimin, depozitimin ose eliminimin përfundimtar të mbushjeve bërthamore rrezatuese ose për depozitimin, përpunimin e mbetjeve radioaktive.

4. Punët e integruara për shkrirjen fillestare të materialeve të derdhura në hekur dhe çelik; instalimet për prodhimin e metaleve të papërpunuara jo me bazë hekuri nga zeherori, përqendrimin ose materialet sekondare të papërpunuara nga proceset metalurgjike, kimike ose elektrolite.

5. Instalimet për nxjerrjen e asbestit dhe përpunimin e transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest; për produktet që kanë asbest, çimentoje asbesti, me një prodhim vjetor prej më shumë se 20,000 ton produkt i gatshëm; për materiale fërkuese me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 ton materiale të gatshme; dhe për përdorime të tjera asbesti me më shumë se 200 ton në vit.

6. Instalimet e integruara kimike, p.sh instalimet për përpunimin në shkallë industriale të substancave që kërkojnë shndërrime kimike, në të cilat njësitë ndodhen në linjë njëra pas tjetrës të lidhura nga ana funksionale dhe prodhojnë: kimikate me bazë organike; kimikate me bazë inorganike; fosfor; azot ose plehrave kimike fosfatikë (plehërues të thjeshtë ose të përbërë); produktet shëndetësore me bazë bimore dhe biocidet; produktet farmaceutike bazë që kërkojnë procese kimike ose biologjike; lëndët plasëse.

7. Ndërtimi i autostradave, rrugëve të shpejtësisë së lartë dhe linjat hekurudhore për distanca të gjata; aeroportet me pistë me gjatësi 2,100 metra ose më shumë; rrugë të reja me katër ose më shumë korsi të cilat rikonstruktohen ose seksionet e tyre zgjerohen në segmente prej 10 km ose më shumë.

8. Tubacione, terminale dhe ndërtime të ngjashme për transport në volume të mëdha të gazit, naftës dhe kimikateve.

9. Portet detare dhe rrugët e brendshme ujore si dhe portet për trafikun e rrugëve të brendshme ujore të cilat lejojnë kalimin e mjeteve lundruese mbi 1,350 ton; portet tregtare, molet për ngarkimin dhe shkarkimin që lidhen me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të moleve të trageteve) që mund të pranojnë mjete lundruese me më shumë se 1,350 ton.

10. Instalimet për përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve që eliminohen me anë të djegies, përpunimit kimik ose groposjes së mbetjeve të rrezikshme dhe toksike.

11. Diga të mëdha¹⁷ dhe pellgje të tjera të krijuara për mbajtjen ose depozitimin e përhershëm të ujit.

12. Aktivitete për nxjerrjen e ujit nëntokësor ose skema për mbushjen artificiale të ujrave nëntokësorë në rastet kur volumi vjetor i ujit që duhet nxjerrë ose rimbushja arrin 10 milion metra kub ose më shumë.

13. Impiantet industriale për: (a) prodhimin e masës së butë prej fibrave ose materiale të ngjashme druri; (b) prodhimin e letrës dhe dërrasës me kapacitet prodhimi që tejkalon 200 ton

¹⁷ Sipas kufizimit të Komisionit Ndërkombëtar të Digave (ICOLD). ICOLD e përkufizon një digë të madhe atë me lartësi prej 15 metrash ose më shumë nga themeli. Digat me një lartësi nga 5 deri në 15 metra dhe me volum rezervuari prej 3 milion metra kub klasifikohen gjithashtu si diga të mëdha

material të tharë në ajër në ditë.

14. Nxjerrja në sasi të mëdha të torfe, gurësh dhe miniera të hapura, dhe përpunimi i mineraleve të metaleve ose qymyrit.

15. Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror për qëllime tregtimi.

16. Instalime për depozitim e naftës, të nënprodukteve të naftës ose kimike me kapacitet prej 200,000 ton ose më shumë.

17. Prerja në sasi të mëdha e drurëve.

18. Impiante për përpunimin e ujrave komunalë me një kapacitet që kalon barazvlefshmërinë me një popullsi prej 150,000 personash.

19. Përpunimi i mbetjeve të ngurta dhe impiantet për depozitim e tyre.

20. Zhvillimi i turizmit masiv dhe tregut të pakicës.

21. Ndërtimi i linjave elektrike me voltazh të lartë.

22. Bonifikimi masiv i tokave.

23. Zhvillimi i bujqësisë dhe pylltarisë që përfshin intensifikimin ose shndrimin e habitateve natyrore.

24. Fabrika për përpunimin e lëkurës ku kapaciteti i përpunimit tejkalon 12 ton produkt të gatshëm në ditë.

25. Instalime për rritjen intensive të pulave dhe derrave me 40,000 vende për pularinë; 2,000 vende për derrat (më shumë se 30kg); ose 750 vende për dosat.

26. Projektet¹⁸ që janë planifikuar të kryhen në vende të ndjeshme ose që ka gjasa të kenë ndikim jo të vogël në këto vendndodhje edhe pse kategoria e projekteve nuk shfaqet në këtë listë. Në vendndodhjet e ndjeshme përfshihen, *ndër të tjera*, parqet kombëtare dhe zona të tjera të mbrojtura nga ligjet e vendit dhe ato ndërkombëtare si dhe vende të tjera të rëndësishme më rëndësi ndërkombëtare, kombëtare dhe fetare si vendet me burime ujore, pyjet me vlera të larta të biodiversitetit, zona me rëndësi arkeologjike dhe kulturore si dhe zona me rëndësi për banorët vendas dhe grupe të tjera vulnerabël.

27. Projektet që mund të sjellin ndryshime të rëndësishme të pafavorshme për komunitetet lokale ose palët e tjera të përfshira në projekt

28. Projekte që mund të përfshijnë risistemime të mëdha vendbanimesh të pavullnetshme ose zhvendosje ekonomike.

¹⁸ Përfshirë, pa asnjë lloj kufizimi, projektet me orientim social apo mjedisor (si burimet e ripërtëritshme).

Shtojca 2: Lista e BERZH-it për Përjashtimet Sociale dhe Mjedisore

BERZH-i nuk do të mbështesë financiarisht, direkt apo indirekt projekte që përfshijnë si më poshtë:

- a) Prodhimin ose tregëtimin e çdo lloj produkti apo aktiviteti, i cili kryhet në mënyrë të paligjshme në vendin përkatës dhe në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret (e vendit), të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare apo që janë të ndaluara ndërkombëtarisht apo në proces ndalimi si:
 - (i) Prodhimi i produkteve të tregtimit që përmbajnë bifenole të poliklorinuara (PCBtë)¹⁹
 - (ii) Prodhimi i substancave farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe substancave të tjera të rrezikshme që janë të ndaluara apo në proces ndalimi në shkallë ndërkombëtare²⁰
 - (iii) Prodhimi ose tregëtimin e substancave që dëmtojnë ozonin, të ndaluara²¹ në shkallë ndërkombëtare
 - (iv) Tregëtimin e kafshëve të egra apo prodhimeve prej tyre të rregulluara sipas CITES²²
 - (v) Lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të ndaluara sipas ligjit²³ ndërkombëtar
- b) Prodhimin, përdorimin ose tregëtimin e fibrave të asbestit ose produkteve që përmbajnë asbest²⁴
- c) Aktivitetet e ndaluara me legjislacion në vendin e destinacionit apo konventave ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e burimeve të biodiversitetit apo trashëgimisë kulturore²⁵
- d) Peshkimin me rrjetë në mjedisin detar duke përdorur rrjeta që tejkalojnë gjatësinë 2.5 km

¹⁹ PCB: Bifenil i Poliklorinuar—grup kimikatesh shumë toksike. PCB gjenden më shumë në transformatorë elektrikë të mbushur më naftë, kondensatorë dhe çelësa elektrikë që datojnë në vitet 1950-1985.

²⁰ Dokumentat referues gjenden në Rregulloren e BE-së (EEC) Nr. 2455/92 Për eksportin dhe importin e disa kimikateve të caktuara të rrezikshme, me amendime; Lista e Konsoliduar e KB-së me produkte konsumi dhe/ose shitja e të cilave është e ndaluar, është tërhequr është e ndaluar në mënyrë absolute ose nuk është aprovuar nga Shtetet anëtare; Konventa për Informimin e Procedurave Aprovuese për Kimikatet e Caktuara të Ndaluar dhe Pesticidet për tregti Ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për Ndotjet Organike të Qëndrueshme; OSH-ja Klasifikimi i Pesticideve sipas Rrezikshmërisë.

²¹ Substancat ozon holluese (SOH): Përbërje kimike që reagojnë dhe dëmtojnë ozonin stratosferik dhe shkaktojnë ato që njihen gjerësisht si “vrimat e ozonit”. Lista e protokollit të Montrealit rendit SOHtë, objektivin e reduktimit si dhe datat e skadimit. Lista me përbërës kimikatesh e rregulluar nga Protokollit i Montrealit, e cila përfshin aerosolet, antiperitikët, lëndët tymosëse, tretësit dhe përbërësit për mbrojtjen nga zjarri, së bashku me detajet e vendeve që i kanë firmosur dhe datat e skadencës gjendet tek BERZH-i.

²² CITES: Konventa për Tregëtimin Ndërkombëtar të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës. Lista CITES që mbron llojet gjendet në www.cites.org/eng/app/index.shtml.

²³ Dokumenta Referues janë: Rregullorja (VE) Nr. 1013/2006 më 14 Qershor 2006 për tregëtimin e mbetjeve; Vendimi C(2001)107/Përfundimtar i Këshillit të OECD në lidhje me rishikimin e Vendimit C(92)39/Përfundimtar për kontrollin ndërkufitar për lëvizjen e mbetjeve të destinuar për përpunim; Konventa Basel e 22 Marsit 1989 për kontrollin ndërkufitar të lëvizjes të mbetjeve të rrezikshme dhe eliminimin e tyre.

²⁴ Nuk zbatohet për blerjen dhe përdorimin e çimentos me përmbajtje asbesti ku përmbajtja e këtij të fundit është <20%.

²⁵ Konventa të ngjashme ndërkombëtare përfshijnë pa asnjë lloj kufizimi: Konventën për Llojet Migruese të Botës së Egër (Konventa e Bonit); Konventa për Vendet e Lagëta me Rëndësi Ndërkombëtare, sidomos Habitatet e Shpendëve të Ujit (Konventa e Ramsarit); Konventa mbi Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitateteve Natyrore në Evropë (Konventa e Bernit); Konventa për Trashëgiminë Botërore; Konventa dhe Protokollat për Diversitetin Biologjik.

- e) Tregtinë e naftës apo substancave të tjera të rrezikshme me kontenierë që nuk përmbushin kërkesat IMO²⁶
- f) Tregtimin e mallrave që nuk kërkojnë licenca eksporti apo importi ose autorizime të tjera nga vendet përkatëse të eksportit, importit dhe në rastet e tranzitit.

²⁶ Kjo përfshin: kontenierë që nuk kanë certifikatat e nevojshme MARPOL SOLAS (përfshirë pa asnjë lloj përjashtimi, pajtueshmërinë me Kodin ISM), kontenierë të ndaluar nga Bashkimi Europian ose të ndaluar me Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit mbi Kontrollin e Porteve të Shteteve (MM i Parisit) si dhe kontenierëve që kanë dalë jashtë përdorimit sipas rregullores 13G të MARPOL-it. Nuk duhet të përdoret asnjë kontenier që ka kaluar mbi 25 vjet.

Kërkesa e Performancës

KP 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi Mjedisor dhe Social

Hyrje

1. BERZH-i e konsideron shumë të rëndësishme që të gjitha kompanitë që financohen nga BERZH-i të kenë një metodë sistematike për të manaxhuar problemet e mjedisit dhe ato shoqërore që kanë ndikim nga aktivitetet e tyre. Sistemet efikase të manaxhimit, të përshtatshme me përmasat dhe natyrën e biznesit, mundësojnë që kompanitë të manaxhojnë sa më mirë rrezikun, të përfitojnë prej mundësive të ofruara, të zgjerojnë performancën e tyre mjedisore dhe sociale si dhe reputacionin. Të gjitha këto shpesh ndikojnë në përmirësimin e performancës financiare. Një sistem i suksesshëm dhe efikas manaxhimi mjedisor dhe social është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i ndërmarrë dhe mbështetur nga menaxhimi, i cili përfshin një komunikim sa më të mirë midis klientit dhe punonjësve dhe komuniteteve lokale që preken nga projekti apo kompanitë kliente. Kjo kërkon sisteme metodike që përfshijnë planifikimin, zbatimin, rishikimin dhe ndërhyrjen për të gjitha rezultatet në mënyrë të strukturuar me qëllim që të arrihet një përmirësim i vazhdueshëm në performancë.

Objektivat

2. Banka kërkon që klientët që zhvillojnë një mënyrë¹ sistematike, që përshtatet me natyrën e aktiviteteve ose projekteve të tyre për të manaxhuar rreziqet dhe mundësitë mjedisore dhe sociale që ndihmojnë klientin të përmbushë Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës, gjatë gjithë kohës që Banka është e përfshirë në projekt.
3. Kërkesat e Performancës (KP) 1 venë në dukje përgjegjësitë e klientit përgjatë procesit të vlerësimit, menaxhimit dhe monitorimit të çështjeve mjedisore dhe sociale që lidhen me projektin për të cilin kërkohet financim nga BERZH-i. Përfshirja në projektin e aktorëve është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Kërkesat e Bankës në lidhje me përfshirjen e aktorëve janë të renditura në detaje në KP 10.

Objektivat Specifike të KP 1 dhe KP 10 janë si më poshtë:

Vlerësimi dhe Menaxhimi Mjedisor dhe Social (KP 1)	Përhapja e Informacionit dhe Përfshirja e aktorëve (KP 10)
<ul style="list-style-type: none">• Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimit në mjedisor dhe social dhe problemet që dalin prej tyre, si të pafavorshme dhe favorizuese që lidhen me projektin.• Adoptimi i masave për të shmangur, ose kur kjo nuk është e mundur të minimizohen, zbuten ose mënjanohen/kompensohen ndikimet negative tek punonjësit, komunitetet dhe mjediset që preken.• Kur është e mundur identifikimi dhe realizimi për të adoptuar mundësi për të përmirësuar performancën mjedisore dhe sociale.• Përkrahja për përmirësimin e mjedisit dhe shoqërisë me anë të proceseve dinamike	<ul style="list-style-type: none">• Për të identifikuar njerëz ose komunitete që janë të prekur ose që mund të preken nga projekti si dhe palët e tjera të interesuara.• Për t'u siguruar që aktorët janë të përfshirë siç duhet në çështjet mjedisore dhe sociale që mund të ndikojnë tek ata me anë të një procesi që shpalos informacionin dhe me anë të konsultimeve të duhura.• Për të ruajtur një marrëdhënie konstruktive me aktorët në mënyrë të vazhdueshme me anë të përfshirjes së plotë përgjatë zbatimit të projektit.

¹ Ndonëse nuk është e detyrueshme, Banka nxit klientët të marrin në konsideratë sistemet e akredituara të menaxhimit si ISO 14001.

për monitorimin dhe vlerësimin e performancës.	
--	--

Qëllimi i Aplikimit

4. Kjo KP zbatohet për projektet me mundësi rreziku dhe ndikimi në mjedis dhe shoqëri, të cilat duhet të vlerësohen që në fazat e para të zhvillimit të projektit dhe duhen të menaxhohen vazhdimisht.

Kërkesat

Vlerësimi mjedisor dhe social

5. Me anë të aktiviteteve vlerësuese si vlerësimi i rrezikut, auditimi dhe vlerësimi i ndikimeve në mjedis dhe shoqëri, klienti duhet të marrë në konsideratë në mënyrë të integruar mjedisin dhe çështjet sociale si dhe pasojat që mund të rrjedhin nga projekti i propozuar. Përmes informacionit të marrë, BERZH-i do të informohet në lidhje me procesin e vlerësimit (*due diligence*) të klientit dhe projektit dhe do të ndihmojë të identifikohet se ku mund të aplikohet KP-ja si dhe masat e nevojshme për të menaxhuar sa më mirë rrezikun dhe zhvillimin e mundësive në përputhje me KP-në. Proçesi i vlerësimit do të identifikojë edhe ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në juridiksionin ku do të vihet në zbatim projekti përta i përket çështjeve mjedisore dhe sociale përfshirë ligjet që lidhen me detyrimet në vendin e destinacionit sipas ligjeve ndërkombëtare² (për shembull angazhimet që lidhen me planimetrinë e përdorimit të tokës dhe menaxhimin e zonës së mbrojtur).
6. Ndikimet dhe çështjet mjedisore dhe sociale duhet të vlerësohen në kontekstin të influencës që do të ketë projekti në zonën e caktuar. Kjo zonë influence mund të përfshijë një ose më shumë nga rastet e mëposhtme, sipas rastit:
 - i. Asetet dhe ndërtesat që zotërohen ose menaxhohen nga klienti dhe lidhen me aktivitetin që do të financohet në këtë projekt (si impiantet e prodhimit, korridoret për transmetimin e energjisë, tubacionet e naftës, kanalet, portet, rrugët e kalimit dhe kampet e ndërtimit).
 - ii. Aktivitetet mbështetëse/mundësuese, asetet dhe ndërtesat që zotërohen ose janë nën kontrollin e palëve të kontraktuara për të vënë në veprim biznesin e klientit ose për plotësimin e projektit (si kontraktorët).
 - iii. Pajisje ose biznese të ngjashme që nuk janë të financara nga BERZH-i si pjesë e projektit dhe që mund të jenë entite të ndara ligjore, por qëndrueshmëria dhe ekzistenca e të cilave varet ekskluzivisht nga projekti; mallrat dhe shërbimet e së cilës janë thelbësore për të zbatuar me sukses projektin.
 - iv. Pajisje, veprime dhe shërbime që zotërohen ose menaxhohen nga klienti, të cilat janë pjesë e paketës së sigurisë që i jepet BERZH-it si kolateral.
 - v. Zonat dhe komunitetet që ka gjasa të kenë pasojat nga: ndikime shtuese nga planifikimi për zhvillimin e mëtejshëm të projektit ose burimeve të tjera me ndikime të ngjashme në zonën gjeografike, çdo projekti apo kushtesh ekzistuese, dhe zhvillime të tjera që lidhen me projektin dhe pritet që të ndodhin në kohën kur kryhet proçesi i vlerësimit (*due diligence*).
 - vi. Zonat dhe komunitetet që mund të kenë ndikim nga zhvillimet e paplanifikuara, por të parashikueshme, të shkaktuara nga projekti që mund të ndodhin më vonë apo në një vendndodhje tjetër. Kjo zonë e influencës nuk përfshin ndikimet e mundshme që mund të ndodhin pa projektin ose në mënyrë të pavarur nga projekti.

² Për shembull Konventat e Århus, Espoo dhe Biodiversitetit.

Sipas pikave të mësipërme, BERZH-i dhe klienti do të bien dakord për zonën e influencës për çdo projekt.

7. Çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale duhen të analizohen gjatë fazave përkatëse të ciklit të projektit. Këto mund të përfshijnë parandërtimin, ndërtimin, veprimin dhe shkatërrimin, ose mbylljen dhe rikthimin në gjendjen e kërkuar. Në disa raste, vlerësimi duhet të përfshijë edhe rolin dhe kapacitetin e palëve të treta (si qeveritë lokale dhe kombëtare, kontraktorët dhe furnitorët), për masën që mund të influencojnë në projekt, duke ditur që aftësia e klientit për të adresuar këto rreziqe dhe ndikime do të varet nga kontrolli dhe influenca mbi veprimet e palëve të treta. Ndikimet që lidhen me zinxhirët e furnizimit, të cilët janë thelbësorë për funksionet bazë të projektit, do të merren në konsideratë kur burimi i përdorur nga projekti është i ndjeshëm nga ana ekologjike, ose në rastet kur kostoja e ulët e punës është një faktor kryesor në konkurrencën për mallin e furnizuar.³ Vlerësimi duhet të marrë në konsideratë problemet e mundshme ndërkuftare dhe globale si ndikimet nga shkarkimet në ujë dhe ajër, përdorimin e shtuar ose ndotjen e rrugëve ndërkombëtare të transportit ujqor, shkarkimin e gazeve serë, parandalimin dhe përshtatjet ndaj ndryshimeve klimatike si dhe pasojat mbi llojet e egra dhe habitatet në rrezik.
8. Natyra e studimeve për procesin e vlerësimit të kryer duhet të jetë në përputhje me rreziqet dhe problemet që mund të ndeshen. Ai duhet të jetë një vlerësim dhe prezantim i plotë, i saktë dhe objektiv i çështjeve, i përgatitur nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë. Në varësi të rëndësisë potenciale që mund të kenë ndikimet dhe çështjet e lidhura me to, Banka mund të kërkojë që disa studime të vlerësimit (*due diligence*) të kryhen nga specialistë të palëve të treta. Për çdo projekt, Banka do të miratojë së bashku me klientin natyrën e studimeve që do të kryhen për procesin e vlerësimit (*due diligence*).
9. Projektet e kategorizuara nga BERZH-i si “A” kërkojnë procese pjesëmarrëse të veçanta dhe të formalizuara vlerësimi. Në Shtojcën 1 të Politikës mund të gjeni një listë treguese të këtyre projekteve. Zhvillimi i projekteve me nikime të forta mjedisore, zgjerimi i aktiviteteve që mund të sjellin ndikime të rëndësishme dhe pasoja të pafavorshme mjedisore dhe sociale si ato të renditura në Shtojcën 1, kërkojnë një vlerësim të plotë të ndikimit në mjedis dhe/ose çështjet sociale të projektit të propozuar; të identifikohen mundësitë për përmirësim të mjedisit, dhe të rekomandohen masat e duhura për të shmangur pasojat, dhe në rastet kur nuk mund të shmangen, të merren masa për të minimizuar dhe mënjanuar pasojat e pafavorshme. Ky vlerësim duhet të përfshijë një ekzaminim të alternativave të mundshme teknike dhe financiare për shkakun e këtyre ndikimeve dhe dokumentacionin e duhur për të përzgjedhur veprimin më të duhur të propozuar. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) / Vlerësimi i Ndikimit Social (VNS) duhet të përmbushin KP 10 dhe çdo kërkesë tjetër të zbatueshme sipas ligjit të vendit për VNM-së dhe ligjeve të tjera përkatëse.⁴ Në raste të veçanta, mund të kërkohet një vlerësim rajonal, sektorial dhe strategjik. Projektet që përfshijnë zhvendosjet e pavullnetshme dhe ndikime negative mbi vendasit ose trashëgiminë kulturore kërkojnë një vlerësim në përputhje me KP 5, 7 dhe 8 përkatësisht, përveç studimeve të tjera mjedisore dhe sociale në procesin e vlerësimit (*due diligence*) që do të kryhet.
10. Projektet e kategorizuara si “B” mund të kërkojnë një sërë procesesh vlerësuese (*due diligence*) në varësi të natyrës, madhësisë dhe vendndodhjes së projektit si dhe karakteristikave të ndikimeve dhe rreziqeve të mundshme mjedisore dhe sociale. Procesi i vlerësimit (*due diligence*) duhet të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e ardhshme që mund

³ Shiko edhe seksionin e KP 2 dhe seksionin 22 të KP 6.

⁴ Format i raportit për VPM/VPS në përputhje me direktivat e VPM së BE-së gjendet tek BERZH-i. projektet në Vendet Anëtare të BE-së duhet të përmbushin direktivat e BE për VPM-në dhe të marrin leje kur është e nevojshme.

të ndeshen si rezultat i projektit të propozuar, të identifikojë mundësitë për përmirësimin e mjedisit dhe të rekomandojë masat që duhet marrë për të shmangur, kur kjo e fundit nuk është e mundur, për të minimizuar dhe mënjanuar pasojat e pafavorshme. Në varësi të rreziqeve të mundshme mjedisore dhe sociale, Banka mund të kërkojë që impianti/objekti ekzistues t'i nënshtrohet auditimit për të vlerësuar ndikimet e mundshme nga veprimet e kaluara dhe ato aktuale. Qëllimi i këtyre auditimeve është të identifikojë shqetësimet e kaluara dhe ato aktuale, statusin aktual të pajtueshmërisë së rregullores, sistemet e menaxhimit dhe performancës si dhe rreziqet e mundshme, detyrimet dhe mundësitë që bashkëshoqërojnë këtë projekt. Mund të kërkojen edhe hetime të një tjetër lloji si analizat e rrezikut dhe vlerësimi i riskut. Fokusi i vlerësimit, auditimit dhe investigimeve të tjera mund të jetë mjedisi ose shoqëria (p.sh. puna, shëndeti dhe siguria në punë (ShSP), ndikimet në komunitet) ose një kombinim i të këtyre aspekteve në varësi të natyrës së projektit. Çdo investigim i impianteve/objekteve ekzistuese duhet të kryhet nga specialistë që janë të pavaruar nga impianti/objekti që po investigohet.

11. Në rastet kur klientët me operacione në vende të ndryshme kërkojnë nga BERZH-i financim të përgjithshëm korporal, kapital pune ose financim të paanshëm, vlerësimi i përfshirë në paragrafët 4 dhe 10 më sipër, nuk është i përshtatshëm për këtë rast. Në raste të tilla, të cilat do të konfirmohen nga BERZH-i projekt pas projekti, klienti duhet të autorizojë një specialist të jashtëm të kryejë auditimin e përbashkët për sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe shoqërisë (SMMS) dhe performancën e kaluar dhe aktuale të kompanisë sipas KP të BERZH-it. Auditimi duhet të:

- vlerësojë aftësinë e klientit për të menaxhuar dhe adresuar të gjitha rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale nga biznesi dhe veprimet e tij, sidomos në lidhje me çështjet e identifikuara në KP (përfshi edhe këtë KP);
- vlerësojë të dhënat e klientit në lidhje me respektimin e ligjeve dhe rregulloreve në juridiksionin ku vepron projekti përse i përket çështjeve mjedisore dhe sociale, përfshirë ligjet në vendin pritës që zbaton ligjet ndërkombëtare;
- identifikojë grupet kryesore të aktorëve të kompanisë dhe aktivitetet për përfshirjen e tyre.

Qëllimi dhe fokusi i saktë i auditimit të përbashkët duhet të miratohet me BERZH-i, rast pas rasti.

12. Projektet e kategorizuara si “C” që nuk kanë ose kanë pasoja minimale të pafavorshme nuk do t'i nënshtrohen vlerësimeve mjedisore dhe sociale përveç identifikimit të tyre dhe nuk kërkojnë PVMS si për seksionet 14-16 më poshtë.

13. Si pjesë e procesit të vlerësimit klienti do të identifikojë dhe përfshihet me aktorët sipas KP-së 10.

Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS)

14. Duke marrë në konsideratë konkluzionet e vlerësimit mjedisor dhe shoqëror dhe rezultatin e konsultimeve me grupeve të, klienti duhet të krijojë dhe të zbatojë një program parandalues masash dhe veprimesh përmirësuese duke i drejtuar çështjet, ndikimet dhe mundësitë e përcaktuara për çështjet shoqërore dhe mjedisore në formën e një Plani Veprimi Mjedisor Social (PVMS). Masat dhe veprimet lehtësuese duhet të identifikohen në mënyrë që të gjitha fazat përkatëse të projektit (p.sh. të parandërtimit, ndërtimit, veprimit, mbylljes, mos kryerjes /rikthimit në gjendjen e kërkuar) të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe KP-të e kësaj Politike. PVMS duhet të ketë një përafrim afatgjatë dhe të ndarë në periudha dhe të marrë në konsideratë kërkesat e pritshme rregullatore në të ardhmen. PVMS duhet të përqendrohet në shmangien e ndikimeve dhe kur nuk është e mundur, në marrjen e masave për të minimizuar ose pakësuar ndikimet e mundshme në nivelet e

15. Niveli i detajeve dhe kompleksitetit të PVMS dhe prioriteti i masave dhe veprimeve të identifikuar duhet të pasqyrojë rreziqet e projektit, ndikimet dhe mundësitë. PVMS duhet të dokumentojë çështje kyçe mjedisore dhe shoqërore, masat që do të merren për të adresuar saktësisht ato, dhe të gjitha masat për të shtuar maksimalisht përfitimet mjedisore dhe sociale, programin dhe personin/njësine përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin dhe vlerësimin e kostove përkatëse. Klienti duhet të informojë BERZH-in për mënyrën se si do të realizohen këto kosto. Përfundimet e dëshiruara duhet të caktohen duke ju referuar niveit bazë së caktuar gjatë procesit të vlerësimit si tregues të matshëm, me elementë të tillë si treguesit e ecurisë, objektivat ose kriteret e pranimit që mund të maten gjatë periudhave të përcaktuara kohore. Në rastet kur veprimet aktuale nuk përputhen dukshëm me kërkesat rregullatore, për lejet ekzistuese, masat e propozuara dhe programet e këtyre zonave të papajtueshme duhet të bihet dakord me autoritetet kompetente. Duke njohur natyrën dinamike të ecurisë së projektit dhe procesit të zbatimit, PVMS duhet të jetë përgjegjës për rrethanat e projektit, ngjarjet e paparashikuara dhe rezultatet e monitorimit. Për projektet e Kategorisë A, Banka, gjatë vlerësimit, mund të bjerë dakord me klientin për menaxhimin e procesit të ndryshimit, për mënyrën se si të menaxhohen dhe raportohen ndryshimet e projektit të propozuar në rrethana të paparashikuara.
16. Në rastin e klientëve që veprojnë në vende të ndryshme dhe kërkojnë financime të përgjithshme korporatash, kapital pune ose pasuri financiare, PVMS duhet të përfshihet në sistemin drejtues mjedisor dhe shoqëror të korporatës. Duhet të adresohet çdo çështje e përcaktuara gjatë kontrollit të korporatës duke specifikuar masat me afat të përcaktuar, për të arritur dhe ruajtur përputhshmërinë me KP-të e Bankës brenda një afati të arsyeshëm.

Aftësia organizuese dhe përkushtimi

17. Klienti duhet të vendosë, caktojë dhe përforcojë sipas nevojës, strukturën organizative që përcakton rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin për të zbatuar PVMS dhe sistemet përkatëse drejtuese. Duhet të përcaktohen kufijtë e qartë të përgjegjësisë dhe autoriteti i personelit përkatës, përfshirë përfaqësuesin(it) drejtues. Përgjegjësitë kyçe sociale dhe mjedisore duhet të jenë të përcaktuara mirë dhe të komunikohen personelit përkatës dhe pjesës tjetër të organizatës. Përkushtimi i mjaftueshëm drejtues, burimet njerëzore dhe financiare duhet të sigurohen vazhdimisht për të arritur një ecuri eficiente dhe të vazhdueshme sociale dhe mjedisore.
18. Klienti duhet të sigurohet se punonjësit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për aktivitetet përkatëse sociale ose mjedisore të projektit ose kompanisë janë të kualifikuar sic duhet dhe të trajnuar në mënyrë që të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punën e

Kontraktuesit drejtues

19. KP-të, përfshirë çdo kërkesë specifike të vendosur në PVMS, duhet të zbatohen në projekt, pavarësisht nëse kryhet drejtpërdrejt nga klienti ose nëpërmjet kontraktuesve ose nën kontraktuesve. Është përgjegjësi e klientit të sigurojë se punimet e kontraktuesit në vendin e punimeve përputhen me këto kërkesa. Drejtimi efektiv kontraktues përfshin:
- vlerësim të rreziqeve mjedisore dhe sociale të kontratave.
 - përfshirje të dispozitave përkatëse të KP-ve /PVMS në dokumentet e tenderave, projektimit të kapaciteteve të kontraktuesve potencialë për tu përputhur me kërkesat.
 - kërkim kontraktual i kontraktuesve për të zbatuar këto standarde dhe për të përfshirë ndreqjet përkatëse për mospërputhjet e vërejtura.
 - sigurimin se kontraktuesit kanë njohuri dhe aftësi për të kryer detyrat e projektit të tyre në përputhje me kërkesat e KP-ve dhe PVMS.
 - përputhje e kontraktuesit të monitorimit me kërkesat e mësipërme.
 - në rastet e nënkontraktimit, kontraktuesit përkatës do të kenë marrëveshje të ngjashme me nën kontraktuesit e tyre.

Kërkesat në lidhje me kushtet e punës së punonjësve jo të punësuar, paraqiten në KP 2, paragrafi 19.

Monitorimi dhe rishqyrtimi i ecurisë

20. Klienti duhet të caktojë procedurat për të monitoruar dhe matur përputhjen me dispozitat mjedisore dhe sociale të marrëveshjeve ligjore, përfshirë zbatimin efektiv të PVMS dhe KP-ve, dhe përmirësimet e arritura gjatë kohës së përcaktuar gjatë vlerësimit. Shkalla e monitorimit duhet të jetë në raport me rreziqet dhe ndikimet e pafavorshme në komunitetet dhe mjedisin e prekur. Monitorimi duhet të përfshijë zakonisht, regjistrimin e informacionit për të ndjekur ecurinë dhe vendosur kontrolle përkatëse vepruese, për të verifikuar përputhshmërinë dhe progresin, si dhe për të vepruar nga autoritetet përkatëse të zbatimit dhe mendimet e grupeve të interesuara si anëtarë të komunitetit. Për më tepër, klienti mund të përdorë palë të treta, si ekspertë të pavarur, komunitetet lokale ose OJF-të, për të plotësuar ose verifikuar informacionin e vet të monitorimit. Për projektet e Kategorisë A, klientit do ti kërkohet të ketë specialistë të kualifikuar dhe me përvojë për të kryer funksionet/ kontrollet periodike të monitorimit gjatë jetëgjatësisë së përfshirjes së Bankës në projekt. Klienti duhet të dokumentojë rezultatet e monitorimit.
21. Rezultati i monitorimit do të përdoret për të korrigjuar dhe përmirësuar ecurinë e veprimeve. Në mënyrë të ngjashme, aktivitetet e monitorimit mund të rregullohen sipas ecurisë, përvojës së fituar dhe rezultatit. Gjatë zbatimit të projektit, rezultatet e vetë monitorimit të klientëve, raportet qeveritare të kontrollit, kontrollet/raportet e palëve të treta ose monitorimi nga kreditorët mund të paraqesin ndryshime të nevojshme për PVMS. Bazuar në rezultatet e monitorimit, klienti duhet të caktojë dhe pasqyrojë të gjitha masat e nevojshme korrigjuese dhe parandaluese në një PVMS të ndryshuar dhe/ose një program pasardhës, i cili duhet ti paraqitet për miratim Bankës. Klienti duhet të zbatojë masat korrigjuese dhe parandaluese të rëna dakord dhe të ndjekë këto masa për të siguruar efikasitetin e tyre.

22. Drejtuesit më të lartë në organizimin e klientit do të marrin një vlerësim të rregullt të ecurisë së sistemit menaxhues mjedisor dhe social dhe/ose progresin në zbatimin e PVMS, bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave sistematike. Qëllimi dhe frekuenca e këtij raportimi do të varet nga natyra dhe qëllimi i aktiviteteve të identifikuara dhe të ndërmarra në përputhje me sistemin/programin drejtues të klientit, PVMS dhe kërkesa të tjera të projektit në fuqi.
23. Klientët duhet të lehtësojnë vizitat monitoruese në vendet e tyre nga specialistët mjedisorë dhe socialë të Bankës ose konsulentëve që veprojnë në emër të Bankës. Frekuenca dhe kohëzgjatja e këtyre vizitave duhet të jetë në raport me rreziqet mjedisore dhe sociale të projektit.
24. Si pjesë e raportimit të tyre të rregullt për Bankën, klientët duhet t'i sigurojnë BERZH-i përditësimet rreth progresit të tyre në zbatimin e PVMS. Angazhimi i grupeve të interesit gjatë zbatimit të projektit, përfshirë raportimet e jashtme për ecurinë e zbatimit të PVMS duhet të ndërmerren në përputhje me KP 10.

KP 2: Puna dhe Kushtet e Punës

Hyrje

1. BERZH beson se për çdo biznes, fuqia punëtore është një pasuri me vlerë, dhe menaxhimi i mirë i burimeve njerëzore dhe marrëdhëniet e shëndetshme punëtorë -- menaxhim e bazuar në respektin e të drejtave të punëtorëve, duke përfshirë të drejtën e organizimit në shoqata dhe të drejtën për marrëveshje kolektive janë elemente kyçe të jetëgjatësisë së ndërmarrjes. Nëse punëtorët trajtohen me drejtësi dhe nëse atyre u krijohen kushte pune të sigurtat e të shëndetshme, klientët mund të arrijnë përfitime të prekshme, si rritja e efikasitetit dhe produktivitetit të operacioneve të tyre. Në të kundërt, moskrijimi dhe realizimi i një marrëdhënieje të shëndoshë punëtor/menaxhim mund të minojë përkushtimin dhe qëndrimin në punë të punëtorëve, mund të rrezikojë projektin dhe dëmtojë reputacionin e klientit.

Objektivat

2. BERZH do të përpiqet të mbështesë, nëpërmjet operacioneve të saj, nismat e institucioneve të tjera si ONP dhe BE për të promovuar një program pune të përshtatshëm. Si minimum, politikat, procedurat dhe standardet për burimet njerëzore të klientit do të përqendrohen në:
 - krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të shëndosha punëtor/menaxhim;
 - nxitjen e trajtimit të drejtë, mosdiskriminues dhe dhënien e mundësive të barabarta për punonjësit;
 - nxitjen e veprimit në përputhje me marrëveshjet kolektive, në të cilat klienti bën pjesë; ligjet e punës e të punësimit në vend; dhe parimet themelore dhe standardet kryesore rregulluese të parashikuara në konventat e ONP që qëndrojnë në bazë të këtyre marrëdhënieve¹;
 - të mbrojnë e të promovojë shëndetin e punëtorëve, duke nxitur në mënyrë të veçantë kushte pune të shëndetshme e të sigurtat;

Kuadri i aplikimit

3. Banka do të bjerë dakort me klientin mbi mënyrën se si do të vihen në zbatim kërkesat e kësaj KP, si pjesë e përgjithshme e planit të veprimit mjedisor e social dhe/ose të sistemit të menaxhimit. Kërkesat e vlerësimi dhe menaxhimit social e mjedisor janë përcaktuar në KP 1 dhe KP 10.
4. Termi "punëtor" në këtë KP përdoret për t'ju referuar punonjësve të klientit. Aplikimi i KP për punonjësit pa kontratë afat-gjatë përshkruhet në pikën 19. Çështjet që lidhen me zinxhirin e produktit trajtohen në pikën 20 dhe 21.

¹ Konventa e ONP 29 dhe 105 (puna e detyruar dhe puna e skllavërve); 87 (liria e organizimit në shoqatave); 98 (e drejta për marrëveshje kolektive); 100 dhe 111 (diskriminimi); 138 (mosha minimale); 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve).

Kërkesat

Menaxhimi i Marëdhënieve me Punënjësit

Politikat e Burimeve Njerëzore

5. Klienti duhet të ndryshojë dhe/ose mbajë politikat e burimeve njerëzore në përputhje me përmasat e tij dhe fuqisë punëtore, që përcakton mënyrën e tij për menaxhimin e fuqinë punëtore në përputhje me kërkesat e kësaj KP. Këto politika duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të mundshme për punonjësit.

Marëdhëniet e Punës

6. Klienti duhet ti dokumentojë dhe komunikojë të gjithë punonjësve kushtet e tyre të punës dhe termat e punësimit duke përfshirë pagesat e tyre, orët e punës, kohën e orarit jashtë punës dhe kompesimin e orëve jashtë orarit të punës dhe çdo përfitim (si p.sh pushim për raste sëmundjesh, pushime shtatëzanie për prindërit ose në raste festash).

Kushtet e punës dhe termat e punësimit

Të përgjithshme

7. Projektet kërkohen të përputhen të paktën me:
 - 1 ligjet e punës, mbrojtjes sociale dhe asaj profesionale të shëndetit dhe sigurisë së atij vendi
 - 2 parimet dhe standartet të shprehura në konventën e ONP në lidhje me:
 - a) ndalimin e punës së fëmijëve;
 - b) eliminimin e punës së detyruar;
 - c) eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin;
 - d) lirianë e organizimit dhe të negociimit të grupuar

Puna e fëmijëve

8. Klienti duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e ligjeve kombëtare përkatëse në lidhje me punësimin e të vegjëlve. Në çdo rast, klienti nuk duhet të punësojë fëmijë në mënyrë që është ekonomikisht i shfrytëzueshëm, që të jetë e rrezikshme ose të ndikojë në edukimin e fëmijës, ose të rrezikojë shëndetin e fëmijës, zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Të rinjtë nën moshën 18 vjeç nuk duhet të punësohen në punë të rrezikshme dhe e gjithë puna e personave nën moshën 18 vjeç do të jetë subjekt i një vlerësimi të veçantë të riskut.

Puna e detyruar

9. Klienti nuk duhet të punësojë persona për punë të detyruar, e cila quhet çdo punë ose shërbim i kryer jo vullnetarisht nga një individ nën kërcënimin e forcës ose penalizimit. Këtu përfshihen çdo lloj pune jovullnetare ose e detyruar, si p.sh puna pa kontratë, puna e detyruar ose kombinime të ngjashme të kontraktimit të punës.

Mosdiskriminimi dhe mundësitë e barabarta

10. Projektet duhet të përputhen me kërkesat e BE mbi mosdiskriminimin në lidhje me punësimin. Në mënyrë të veçantë, klienti:
 - 1 nuk duhet të marrë vendime mbi punësimin mbi bazën e karakteristikave personale

- 2 duhet të bazojë marëdhënien e punësimit mbi parimin e mundësive të barabarta dhe trajtimit të njëjtë dhe nuk duhet të diskriminojë në asnjë aspekt të marëdhënieve të punësimit, duke përfshirë rekrutimin dhe punësimin, kompesimin (ku përfshihen pagat dhe shpërblimet), kushtet e punës dhe termat e punësimit, e drejta për trajnime, ngritja në detyrë, mbarimin e kontratës së punës ose daljen në pension dhe disiplinën në punë.

Nuk do të përcaktohen si diskriminim masat e veçanta për mbrojtjen ose ndihmën për ndreqjen e një diskriminimi në të shkuarën ose nxitjen e mundësive të punësimit të popullsisë lokale ose zgjedhjen e një pune të veçantë bazuar mbi kërkesat aktuale për atë punë, që janë në përputhje me ligjin kombëtar.

Organizatave e punonjësve

11. Klienti nuk duhet të ndalojë punonjësit të formojnë ose bashkohen në organizatat e punëtorëve sipas zgjedhjes së tyre ose në bashkime kolektive dhe nuk duhet të diskriminojë ose të ngrihet kundër punëtorëve, të cilët marrin pjesë ose kërkojnë të marrin pjesë në organizata të tilla ose mbledhje kolektive. Në përputhje me ligjin kombëtar, klienti duhet të angazhohet me këto organizata të punonjësve dhe ti sigurojë atyre informacionin e nevojshëm për negociime të kuptimita, në kohën dhe mënyrën e duhur. Atje ku ligji kombëtar e kufizon krijimin ose funksionimin e organizatave të punëtorëve, klienti duhet të mundësojë mënyrat që punëtorët të shprehin ankesat e tyre dhe të mbrojnë të drejtat e tyre në lidhje me kushtet e punës dhe termat e punësimit. Këto mjete duhet të jenë nën ndikimin ose kontrollin e klientit.

Rrogat, shpërblimet dhe kushtet e punës

12. Rrogat, shpërblimet dhe kushtet e punës të ofruara, në përgjithësi, duhet të jenë të krahasueshme me ato të ofruara nga punëdhënësit e njëjtë në rajonin përkatës të atij vendi/rajonit dhe sektori. Atje ku klienti është një palë e marrëveshjes të mbledhjes kolektive ose është i lidhur me të, kjo marrëveshje duhet të respektohet.

Shëndeti Profesional dhe Siguria (SHPS)

13. Klienti duhet të sigurojë punonjësit me një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke marrë parasysh rreziqet aktuale në sektorin e tij të veçantë dhe nivelet e veçanta të rreziqeve në zonat e punës së klientit, ku përfshihen rreziqe fizike, kimike, biologjike dhe radiologjike. Klienti duhet të ndërmarrë hapa për parandalimin e aksidenteve, plagosjeve dhe sëmundjeve që mund të vijnë nga, lidhen me ose ndodhin në kohën e punës duke:
 - duke identifikuar dhe minimizuar sa më shumë të jetë e mundur shkaqet e rreziqeve të mundshme për punonjësit;
 - ndërmarrë masa parandaluese dhe mbrojtëse ku përfshihen modifikimi, zëvendësimi ose eliminimi i kushteve ose substancave të rrezikshme;
 - vendosur pajisjet e duhura për minimizimin e risqeve dhe duke e kërkuar dhe urdhëruar përdorimin e tyre;
 - trajnimin e punonjësve; dhe ndërmarrjen e masave të duhura për ta për të përdorur dhe përmbushur procedurat e shëndetit dhe sigurisë dhe pajisjeve mbrojtëse;
 - dokumentuar dhe raportuar aksidentet në punë, sëmundjet dhe incidentet; dhe
 - parandaluar emergjencat, duke marrë masa parapërgatitore dhe veprimet reaguese
14. Projektet duhet të përputhen me kërkesat përkatëse të SHPS të BE-së, dhe atje ku këto

15. Për arritjen e kërkesave të mësipërme, klienti duhet të ketë një sistem të duhur menaxhimi të SHPS në lidhje me përmasën dhe natyrën e biznesit të tij dhe në linjë me praktikën e mira ndërkombëtare.
16. Atëherë kur klienti siguron fjetje për punonjësit, mjedisi i fjetjes duhet të jetë i përshatshëm për vendodhjen e tij dhe të jetë i pastër, i sigurt dhe plotësojë një minimum të nevojave kryesore të punonjësve. Veçanërisht, dispozitat për fjetjen duhet të përputhen me legjislacionin kombëtar dhe praktikave të mira në lidhje me të, por jo të kufizuara nga: praktika e pagesës për fjetje, dispozita për një hapësirë minimale për çdo punëtor; dispozitat për mjetet sanitare, larjes dhe gatimit dhe ujit të pijshëm; vendi i fjetjes në lidhje me vendin e punës; çdo siguri shëndetësore nga zjarri ose rreziqe të tjera, nga çrregullime dhe mjete lokale; dispozitat mbi ndihmën e shpejtë dhe mjetet mjekësore dhe ngrohjen dhe ajrosjen. Vendi i fjetjes nuk duhet të kufizojë lirinë e lëvizjes së punëtorëve drejt / prej vendit të punës.

Shkurtimet

17. Nëse klienti parashikon pushim kolektiv siç përcaktohet në Pikën 1 të Direktivave të BE 98/59, klienti duhet të zhvillojë një plan për lehtësimin e ndikimeve negative të shkurtimeve, në përputhje me ligjin kombëtar dhe praktikave të mira të industrive dhe duke u bazuar në parimet e mosdiskriminimit dhe konsultimit. Duke konsideruar dispozitat në ligjin kombëtar, një konsultim i tillë duhet të përfshijë lajmërimin e arsyeshëm të ndryshimeve në kushtet e punësimit për përfaqësuesit e punonjësve dhe atje ku duhet, rezultatet e konsultimeve duhet të reflektohen në planin përfundimtar të shkurtimit

Mekanizmi i ankesave

18. Klienti duhet të sigurojë një mekanizëm ankesash për punëtorët (dhe organizatat e tyre, ku ato egzistojnë) për të ngritur shqetësime të arsyeshme në vendin e punës. Klienti duhet të informojë punëtorët për mekanizmin e ankesave në kohën e punësimit, dhe ta bëjë atë lehtësisht të zbatueshëm prej tyre. Mekanizmi duhet të përfshijë nivelin e duhur të menaxhimit dhe të orientojë shqetësimet menjëherë, duke përdorur një proces të kuptueshëm dhe transparent që i siguron dhënien e mendimeve personave të shqetësuar, pa asnjë ndëshkim. Mekanizmi nuk duhet të ndalojë futjen e masave të tjera juridike ose administrative që mund të sigurohen nga ligjet ose nëpërmjet procedurave egzistuese të arbitrazhit ose të zëvendësojë mekanizmat e ankesave të siguruara nëpërmjet marrëveshjeve kolektive.

Punonjësit Jopunëtorë të tij

19. Në rastin e punonjësve jopunëtorë të tij, të punësuar nga klienti nëpërmjet kontraktorëve ose ndërmjetësve të tjerë për të punuar në vendet e projektit ose për të punuar direkt në funksionet kryesore të projektit, klienti duhet: (i) të sigurojë se këta kontraktorë ose ndërmjetës janë ndërmarrje që njihen ligjërisht; dhe (ii) të kërkojnë që ata të aplikojnë kërkesat e shprehura në paragrafet 6 deri në 16 dhe 18 më lart. Kur klienti kontrakton punëtorë jo-punonjës të tij, klienti duhet të zbatojë kërkesat e paragrafëve 6 deri në 16 dhe 18 më lart.

Zinxhiri i furnitorëve

20. Ndikimet negative që lidhen me zinxhirët e furnitorëve duhet të merren në konsideratë atje ku kostoja e ulët e punës është një faktor kryesor në konkurrencën e produktit të gatshëm.

Nëse klienti mëson se puna e fëmijëve dhe puna e detyruar në kundërshtim me standartet e ONP janë çështje kryesore në zinxhirin e furnitorëve të mallrave ose materialeve për funksionet kryesore të aktiviteteve të financuara nga BERZH, klienti duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për të raportuar këtë në përputhje me kërkesat në vazhdim:

(a) Në lidhje me punën e fëmijëve, klienti duhet të vazhdojë të sigurojë këto të mallra dhe materiale vetën nga furnitori, me një marrveshje ku ai angazhohet për eliminimin e këtyre praktikave brenda një kohe të arsyeshme, si dhe zbatimin e një programi sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Klienti duhet të raportojë rregullisht mbi progresin e zbatimit të një programi të tillë në BERZH.

(b) Në lidhje me punën e detyruar, klienti duhet të vazhdojë të sigurojë këto të mallra ose materiale vetën kur ka arritur një marrëveshje të kënaqshme ose ka provat që furnitori ka marrë masat e duhura për eliminimin e kushteve për punën e detyruar.

KP 3: Pakësimi dhe parandalimi i ndotjes

Hyrje

1. BERZH-i pranon se zhvillimi i qëndrueshëm është një aspekt kryesor i zërave të menaxhimit të biznesit dhe se kërkimi i rritjes ekonomike si dhe një mjedis i shëndetshëm janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Pakësimi dhe parandalimi i ndotjes janë elementët kyç të programit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe projektet e financuara të BERZH-it duhet të plotësojnë praktikën e mira ndërkombëtare në këtë vështrim. Do të ishte e domosdoshme që efektet dhe çështjet e lidhura me aktivitetet ndotëse të merren në konsideratë në të gjitha aktivitetet ekonomike, që nga derdhjet dhe emetimet në nivel të ulët, deri te efektet në nivel rajonal dhe global.

2. Si një nënshkrues i Ligjeve Europiane për Mjedisin, BERZH ka marrë përsipër të:

- mbështesë, nëpërmjet aktiviteteve që ai financon, masat paraprake, ato parandaluese, parimin se dëmet në mjedis si prioritet duhet të ndreqen në burim, dhe parimin se ndotësi duhet të paguajë
- kërkojë përmbushje të standardeve të rëndësishme të BE-së në lidhje me mjedisin, në veçanti ato që lidhen me prodhimin industrial, menaxhimin e ujit dhe mbetjeve, ndotjen e ajrit dhe tokës, sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe mbrojtjen e natyrës, ku të gjitha këto mund të gjejnë zbatim në nivel projekti (në të ardhmen: “Kërkesat e BE-së për mjedisin”).

Objektivat

3. Objektivat e Përmbushjes së kësaj Kërkese (KP) janë:

- të shmangë apo në rast se kjo nuk është e mundur, të minimizojë efektet e negative mbi shëndetin njerëzor dhe mjedisin duke shmangur apo pakësuar rritjen e drejtpërdrejtë të ndotjes nga projektet
- të mbështesë klientët në identifikimin e mundësive që lidhen me projektet për energjinë dhe përmirësimin e efektshëm të burimeve dhe reduktimin e mbetjeve
- të promovojë projektet që lidhen me reduktimin e emetimeve të gazeve që shkaktojnë efektin serë.

Qëllimi i aplikimit

4. Banka do të bjerë dakord me klientin për mënyrën se si kërkesat e rëndësishme të kësaj KP-je do të adresohen dhe menaxhohen si pjesë e planit të përgjithshëm të veprimit mjedisor dhe social (PVMS) dhe / apo sistemit të menaxhimit. Vlerësimet për mjedisin dhe ato sociale dhe kërkesat e menaxhimit janë të paraqitura në KP 1 dhe KP 10.

Kërkesat

Të përgjithshme

5. Subjekt i paragrafit 6 më poshtë, projektet duhet të hartohen në përputhje me kërkesat e rëndësishme të BE-së si dhe me ligjin ndërkombëtar të zbatueshëm dhe duhet të

funksionojnë në përputhje me këto ligje dhe kërkesa.

6. Është vërtetuar se kërkesat e BE-së për mjedisin në lidhje me parandalimin e ndotjes dhe masat për pakësimin e saj bazohen në teknikat më të mira në dispozicion, pa përmendur përdorimin e ndonjë teknike apo teknologjie specifike, por duke marrë në konsideratë karakteristikat teknike të instalimit që kanë lidhje me vendndodhjen e tij gjeografike dhe kushtet lokale të mjedisit deri në sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së plotë të mjedisit.

Masat e PVMS për të arritur përmbushjen e këtyre kërkesave duhet të llogarisin të gjitha afatet kohore ndërkombëtare të miratuara që çojnë në përputhje me legjislacionin e BE-së (për shembull, në vendet candidate për anëtarim në BE). Për projektet e vendeve jo anëtare të BE-së, vendet candidate apo ato candidate të mundshme, afati kohor i vendosur në PVMS për të arritur përmbushjen e kërkesave të BE-së për mjedisin, duhet të jetë në përputhje me çdo marrëveshje dypalëshe apo plane veprimi të miratuara mes BE-së dhe vendit përkatës, por duke marrë parasysh koston e aplikimit dhe kushtet lokale ekzistuese.

7. Atje ku kërkesat e BE-së për mjedisin nuk ekzistojnë, klienti duhet të zbatojë praktika të tjera të mira ndërkombëtare siç janë Udhëzuesit e Grupit të Bankës Botërore për Shëndetin Mjedisor dhe Sigurinë. Në raste të tilla Banka do të pranojë kërkesat e zbatueshme me klientin mbi një projekt nga projekti bazë.

8. Kur rregullat e vendit mikëpritës nuk pajtohen me nivelet dhe masat aktuale të kërkesave të BE-së për mjedisin apo kërkesat e miratuara në vijim të paragrafit 7, projektet priten të respektojnë kuadrin rregullator më të rreptë.

9. Për secilin projekt, Banka do të identifikojë dhe miratojë me klientin kërkesat e rëndësishme të mjedisit për zbatim dhe udhëzuesit.

Parandalimi i ndotjes, ruajtja e burimeve dhe prodhimi i energjisë

10. Gjatë projektimit, ndërtimit, funksionimit dhe vënies në punë të projektit (cikli jetësor i projektit) klienti duhet të marrë në konsideratë karakteristikat teknike të instalimit që kanë lidhje me vend ndodhjen gjeografike të tij dhe kushtet lokale të mjedisit dhe zbatimin e parandalimit të ndotjes dhe kontrollit të teknologjive dhe praktikave (teknikat) më të përshtatshme, të shmangë apo, kur kjo e fundit është e pa realizueshme, të minimizojë ose reduktojë efektet negative mbi shëndetin njerëzor dhe mjedisin ndërsa këto janë teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive.

11. Klienti duhet të shmangë çlirimin e ndotësve apo, kur kjo s'është e mundur, minimizojë ose kontrollojë çlirimin e tyre. Këto zbatohen për çlirimin e ndotësve për shkak të situatave të zakonshme, jo të zakonshme dhe atyre të rastësishme me efekte të mundshme lokale, rajonale, ose përtej kufijve. Veç kësaj, klienti duhet të ekzaminojë dhe përfshijë në veprimet e tij masat për prodhimin e energjisë dhe masat për ruajtjen e ujit dhe burimeve të tjera, në përputhje me parimet e prodhimit të pastër.

Mbetjet

12. Klienti duhet të shmangë apo të minimizojë prodhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme dhe të reduktojë efektin dëmtues të tyre aq sa është e mundshme. Atëherë kur prodhimi i mbetjeve nuk është shmangur por është minimizuar, klienti duhet të ripërdorë, riciklojë ose të rikuperojë mbetjet, ose t'i përdorë ato si burim energjie; kur mbetjet nuk mund të rikuperohen ose të ripërdoren, klienti duhet t'i trajtojë, shkatërrojë apo depozitojë ato në një mënyrë të shëndetshme nga ana mjedisore. Nëse prodhimi i mbetjeve konsiderohet i rrezikshëm, klienti duhet të kërkojë alternativa të arsyeshme nga ana tregtare për depozitimet e shëndetshme nga ana mjedisore duke konsideruar kufizimet e zbatimit të zhvendosjes së tyre përtej kufijve. Kur depozitimi i mbetjeve drejtohet nga palë të treta, klienti duhet të kontaktojë kontraktorë të cilët janë sipërmarrje të respektuara dhe të përligjura nga agjenci të rëndësishme rregulluese.

Përdorimi i sigurtë dhe menaxhimi i substancave dhe materialeve të rrezikshme

13. Klienti duhet të përpiqet të shmangë, reduktojë apo eliminojë përdorimin e substancave dhe materialeve të rrezikshme dhe të marrë në konsideratë përdorimin e zëvendësuesve më pak të rrezikshëm për çdo substancë dhe material, në mënyrë që të ruhet shëndeti njerëzor dhe mjedisi nga efektet dëmtuese të mundshme të tyre. Në rastet kur shmangia nuk është e mundur, klienti duhet të marrë parasysh përdorimin më të sigurtë të tyre dhe të zbatojë masat e duhura të menaxhimit të riskut me qëllim që të minimizojë apo kontrollojë çlirimin e substancave / materialeve të tilla në ajër, ujë dhe / ose tokë si pasojë e prodhimit, transportimit, trajtimit, akumulimit, përdorimit dhe depozitimit të tyre të lidhura me aktivitetet e projektit. Klienti duhet të shmangë prodhimin, tregtimin dhe përdorimin substancave dhe materialeve të rrezikshme subjekt i marrveshjeve ndërkombëtare apo jashtë fazës së përdorimit për shkak të helmueshmërisë së lartë për organizmat e gjalla, qëndrueshmërisë së tyre më mjedis, me potencial për bio-akumulim, ose mundësi për hollimin e shtresës së ozonit.

Gatishmëria dhe përgjigja në raste emergjence

14. Klienti duhet të jetë i përgatitur t'i përgjigjet në mënyrën e duhur, rregullimit të situatave të çrregullta, të rastësishme dhe urgjente, të rreziqeve ekzistuese dhe nevojës për të parandaluar pasojat e tyre negative të mundshme. Klienti duhet të zbatojë kërkesat në paragrafët 18-22 të KP 4 për të identifikuar rreziqet kryesore të rastësishme, të parandalojë aksidentet kryesore dhe të kufizojë pasojat e tyre për njerëzimin dhe mjedisin, me këndvështrimin për të garantuar nivele të larta të mbrojtjes në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

Prodhimi industrial

15. Klienti duhet të vërë në zbatim procese për të garantuar se të gjitha shkarkimet, derdhjet dhe mbetjet janë inventarizuar dhe monitoruar mbi bazën e një veprimi. Klientëve që u janë kërkuar të raportojnë projektet e lidhura me çlirimin e ndotësve në Çlirimin e Ndotësve në Europë dhe Regjistrin e Transferimit (E-PRTR) gjithashtu do t'i raportojnë këto të dhëna në BERZH.

Konsiderata për mjedisin

16. Për të drejtuar efektet negative të projektit mbi kushtet ekzistuese të mjedisit, klienti duhet: (i) të marrë parasysh një sërë faktorësh, duke përfshirë kapacitetin e caktuar asimilues të mjedisit, përdorimin aktual dhe të ardhshëm të tokës, kushtet aktuale të mjedisit, pasimin e projekteve në zonat ekologjikisht të ndjeshme ose të mbrojtura dhe efektet e mundshme grumbulluese me pasoja të ndryshueshme dhe të pakthyeshme; dhe (ii) promovimin e strategjive që shmangin ose, kur kjo nuk është e mundur, minimizojnë apo reduktojnë çlirimin e ndotësve, duke përfshirë strategji që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të mjedisit, ndërsa projekti mund të përbëjë një burim të rëndësishëm të shkarkimeve në zonën tashmë të degraduar. Këto strategji përfshijnë, por nuk kufizohen, në vlerësimin e alternativave të vendndodhjes së projektit dhe mënjanimin e shkarkimeve.

Shkarkimet e gazeve serë

17. Klienti duhet të promovojë reduktimin në projektet që kanë lidhje me shkarkimet e gazeve serë në një mënyrë të përshtatshme për natyrën dhe në shkallën e duhur të veprimeve të projektit dhe efekteve.

18. Gjatë zhvillimit të projekteve që priten apo aktualisht prodhojnë sasi të mjaftueshme të gazeve serë, klienti duhet të gjejë dhe të raportojë të dhënat e nevojshme për të mundësuar si vlerësimin bazë (para-investuese) të shkarkimeve të gazeve serë ashtu edhe vlerësimin pas-zbatimit të tyre. Udhëheqja për kërkesat e dhëna duhet kërkuar nga Banka. Vlerësimi i gazeve serë duhet të mbulojë drejtpërdrejtë shkarkimet nga objektet në pronësi apo të kontrolluara brenda kufijve të projektit fizik, së bashku me ato nga çdo operacion i jashtëm në të cilat projekti ka varësi, përfshirë shkarkimet e tërthorta lidhur me prodhimin jashtë vendit të energjisë së përdorur nga projekti.

Drejtimi për përcaktimin e kufirit të projektit gjithashtu duhet të kërkohet nga Banka. Përcaktimi i sasisë dhe monitorimi i parametrave të kërkuar për vlerësimin e shkarkimeve të gazeve serë do të administrohet çdo vit gjatë kohëzgjatjes së projektit.

19. Veç kësaj, klienti duhet të vlerësojë realizimin nga ana teknike e financiare dhe mundësitë me kosto efektive për të reduktuar intensitetin e çlirimit të karbonit gjatë hartimit dhe vënies në zbatim të projektit si dhe ushtrimin të alternativave të përshtatshme.

Përdorimi dhe menaxhimi i pesticideve

20. Klienti duhet të formulojë dhe zbatojë një menaxhim të integruar të insekteve të dëmshme dhe / ose menaxhim të integruar të agjentëve transmetues sipas aktiviteteve të menaxhimit të insekteve të dëmshme. Programe mësipërme të klientit do të detyrojnë përdorimin e koordinuar të insekteve të dëmshme dhe informacionin mjedisor bashkë me metodat e disponueshme të kontrollit të këtyre insekteve, duke përfshirë praktikën kulturore, biologjike, gjenetike, dhe si mjet të fundit, ato kimike, gjë që do të thotë parandalimin e niveleve të papranueshme të dëmit që shkaktajnë këto insekte. Në rastet kur aktivitetet e menaxhimit të insekteve të dëmshme përfshijnë përdorimin e pesticideve, klienti duhet të përpiqet të reduktojë efektet e tyre në shëndetin njerëzor dhe mjedis, dhe më në përgjithësi, për të arritur një përdorim më të qëndrueshëm të pesticideve si dhe një reduktim të ndjeshëm të përgjithshëm në rreziqet dhe përdorimin e pesticideve në përputhje me mbrojtjen e nevojshme të të korrave.

Përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve duhet të përfshijë:

- minimizimin ose, atëherë kur është e mundur, eliminimin e përdorimit të pesticideve duke ulur dëmtimin dhe rreziqet e shëndetit dhe mjedisit si pasojë e përdorimit të tyre
- reduktimin e niveleve të substancave aktive të dëmshme duke i zëvendësuar ato më të rrezikshmet me alternativa më të sigurta (përfshirë këtu ato jo kimike)
- përzgjedhjen e pesticideve më pak të helmueshme për njeriun, të njohura për efektivitetin e tyre ndaj llojeve të caktuara, dhe që kanë efekte minimale mbi lloje të tjera dhe në mjedis
- përdorimin e kulturave bujqësore pa pesticide ose me nivel të ulët të tyre
- minimizimin e dëmit nga armiqtë natyrorë dhe parandalimin e zhvillimit të rezistencës të insektet e dëmshme.

21. Klienti duhet të trajtojë, magazinojë, aplikojë dhe rregullojë përdorimin e pesticideve në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare të industrisë siç është Organizata e Ushqimit dhe Bujqësia (FAO) dhe Kodi Ndërkombëtar i Administrimit të Shpërndarjes dhe Përdorimit të Insekteve Dëmtuese.

22. Klienti nuk duhet të përdorë produkte të cilat janë rrëzuar nga Klasifikimi i Këshilluar i Pesticideve nga Organizata Botërore e Shëndetit sipas Niveleve të Rrezikut 1a (tepër i rrezikshëm) dhe 1b (rrezik i konsiderueshëm); ose Niveli II (mesatarisht i rrezikshëm), nëse projekti i vendit mikpritës ka mungesë të kufizimeve përsa i përket shpërndarjes dhe përdorimit të këtyre kimikateve, ose në qoftë se ato kanë gjasa të jenë në dispozicion të personelit të pa trajnuar siç duhet, të pajisjeve, dhe objekteve për të trajtuar, magazinuar dhe sistemuar këto produkte në mënyrën e duhur.

KP 4: Shëndeti i Komunitetit, Siguria dhe Mbrojtja

Hyrje

1. BERZH-i pranon se aktivitetet e projektit, pajisjet dhe infrastruktura shpesh sjellin përfitime për komunitetin duke përfshirë punësim, shërbime dhe mundësi për zhvillim ekonomik. Megjithatë, projektet mund të rrisin gjithashtu mundësinë e ekspozimit të komunitetit ndaj rreziqeve dhe rritjes së efekteve nga ndryshimet e përkohshme ose të vazhdueshme në popullatë; transportit të materialeve të papërpunuara dhe përfunduara; ndërtimit, operacioneve dhe çmontimit, aksidenteve, dështimeve strukturore dhe çlirimit të materialeve të rrezikshme.

2. Komunitetet mund të jenë të ndjeshme gjithashtu ndaj efekteve mbi burimet e tyre natyrore, ekspozimit ndaj sëmundjeve dhe përdorimit të personelit të sigurisë. Duke pranuar rolin e autoriteteve publike në promovimin e shëndetit, sigurisë dhe mbrojtjes së publikut, përbushja e kësaj kërkesë (“KP”) adreson përgjegjësinë e klientit për identifikimin dhe shmangien ose minimizimin e rreziqeve dhe efekteve armiqësore ndaj shëndetit të komunitetit, sigurisë dhe mbrojtjes që mund të rrjedhin nga aktivitetet e projektit.

3. Niveli i rreziqeve dhe efekteve të përshkruara në këtë KP mund të jetë edhe më i madh në projektet e vendosura në zona në konflikt dhe jo në konflikt, ose në zona subjekt i ngjarjeve të rëndësishme natyrore ose të shndërruara nga njeriu (për shembull, zona të prirura për ngjarje sizmike, përmytje).

Objektivat

4. Objektivat e kësaj KP janë:

- të shmangë ose minimizojë rreziqet dhe efektet mbi shëndetin dhe sigurinë e komunitetit lokal gjatë ciklit të kohëzgjatjes së projektit si nga rrethanat e zakonshme ashtu dhe nga ato të rastësishme
- të garantojë se mbrojtja e personelit lidhur me projektin dhe pronën është kryer në një mënyrë të ligjshme gjë që shmang ose minimizon rreziqet ndaj sigurisë dhe mbrojtjes së komunitetit.

Qëllimi i aplikimit

5. Zbatueshmëria e kësaj KP-je përcaktohet nga Banka gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Nëse është e aplikueshme, Banka do të bjerë dakord me klientin për mënyrën se si kërkesat e kësaj KP-je do të drejtohen dhe menaxhohen si pjesë e planit të përgjithshëm të veprimit mjedisor dhe social (PVMS) dhe/ose sistemit të menaxhimit. Vlerësimi mjedisor dhe social dhe kërkesat e menaxhimit janë të përshkruara në KP 1 dhe KP 10.

6. Kjo KP adreson rreziqet e mundshme dhe efektet ndaj komunitetit të ndjeshëm nga aktivitetet e projektit, duke përfshirë ndërtimin, fillimin e operacionit dhe çmontimin. Është vërejtur se efektet e mundshme mund të variojnë nga njëri stad i projektit në një tjetër. Standardet e shëndetit dhe sigurisë në punë gjenden në KP 2; kërkesat e detajuara

mbi parandalimin e efekteve në shëndetin njerëzor dhe mjedis për shkak të ndotjes gjenden në KP 3.

Kërkesat

7. Klienti duhet të identifikojë dhe vlerësoj risqet dhe ndikimet e mundshme mbi shëndetin dhe sigurinë e komunitetit të ndikuar, gjatë hartimit, ndërtimit, përpunimit dhe përfundimit të projektit dhe duhet të ndërmarrë masa parandaluese dhe plane për ti trajtuar ato sipas risqeve dhe ndikimeve të identifikuara. Këto masa duhet të favorizojnë parandalimin ose shmangjen e risqeve dhe ndikimeve si dhe minimizojnë dhe zvogëlojnë ato.

8. Kur projekti ose një fazë e projektit shkakton një rrezik material ose ka ndikim të mundshëm të pafavorshëm për shëndetin dhe sigurinë e komuniteteve të ndikuara, klienti duhet të zbulojë informacion lidhur me projektin, për të mundësuar që komunitetet e prekura dhe agjencitë përkatëse qeveritare të kuptojnë ato dhe masat emergjente të propozuara nga klienti në mënyrën e përshtatshme për parandalimin dhe zbutjen. Klienti duhet të konsultohet me komunitetet e prekura dhe agjencitë përkatëse qeveritare për masat e propozuara përpara se ato të finalizohen dhe duhet të marrë në konsideratë shqetësimet dhe komentet e tyre. Klienti duhet të rishqyrtojë masat sistematikisht, dhe të angazhojë vazhdimisht komunitetet e prekura dhe agjencitë, duke i informuar ato mbi gjëndjen e zbatimit të planeve dhe premtimeve, mbi rezultatet, dhe mbi çdo ndryshim material të planeve, përpara se këto ndryshime të kryhen. Informacioni i dhënë duhet të përmblihet (duke ruajtur një nivel të mjaftueshëm detajesh që do të lejojnë grupet e interesuara që të kuptojnë plotësisht risqet, ndikimet e mundshme si dhe masat e ndërmarra) dhe/ose redaktohet në mënyrë që të mënjanohet çdo informacion që është konfidencial.

9. Klienti duhet të raportojë mbi risqet, ndikimet e mundshme dhe përfitimet që vijnë nga projekti dhe zbatimi i çdo plan veprimi sistematikisht (p.sh. një herë në vit) tek BERZH dhe tek komuniteti/komunitetet i ndikuar/të ndikuara, në bazë të Kërkesës së Performancës nr.10 mbi raportimin tek grupet e interesuara.

Infrastruktura dhe Siguria e Pajisjeve

10. Klienti duhet të hartojë, ndërtojë, përpunojë dhe përmbushë elementët ose komponentët strukturorë të projektit në përputhje me praktikat industriale ndërkombëtare, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë ekspozimit të mundshëm në rreziqe natyrore, sidomos kur elementët strukturorë janë të arritshëm nga pjesëtarët e komunitetit të prekur ose kur mosfunksionimi i këtyre elementëve do të rezultojë në dëmtime direkte ose indirekte të komunitetit. Elementet strukturorë duhet të hartohen dhe ndërtohen nga profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë, dhe duhet të çertifikohen ose miratohen nga autoritetet ose profesionistë kompetentë.

11. Kur elementët ose komponentët strukturorë, si p.sh. diga, barriera ose depozitime hiri, janë të pozicionuar në vendndodhje me rrezik të lartë dhe mosfunksionimi mirë i tyre kërcënon sigurinë e komuniteteve, atëherë klienti duhet të angazhojë një ose më shumë ekspertë të kualifikuar dhe me përvojë në projekte të ngjashme, që duhet të punojnë të pavarur nga ata që janë përgjegjës për hartimin dhe ndërtimin, të cilët duhet të rishqyrtojnë sa më shpejt të jetë e mundur zhvillimin e projektit dhe fazat e ndryshme të hartimit, ndërtimit dhe komisionimit. Për projekte të cilët operojnë duke lëvizur pajisje në rrugë publike ose në forma të tjera infrastrukture, klienti duhet të parandalojë shkaktimin e incidenteve dhe aksidenteve lidhur me përdorimin e pajisjeve të tilla.

Siguria e materialeve të rrezikshme

12. Klienti duhet të parandalojë ose minimizojë mundësinë e ekspozimit të komunitetit ndaj materialeve të rrezikshme që mund të lëshohen gjatë projektit. Kur ka mundësi ekspozimi të komunitetit (përfshirë punonjësit dhe familjet e tyre) në rreziqe, sidomos në rreziqe që kërcënojnë jetën e tyre, klienti duhet të bëjë kujdes të veçantë për të shmangur ose minimizuar këtë ekspozim, duke modifikuar, zëvendësuar ose eliminuar lëndën ose rrethanën që shkakton rrezikun.

13. Kur materialet e rrezikshme janë pjesë e infrastrukturës ose komponentëve ekzistuese të projektit, klienti duhet të tregojë kujdes të veçantë gjatë aktiviteteve të fillimit ose dekomisionimit në mënyrë që të parandalojë ekspozimin e komunitetit. Klienti duhet të mbajë lidhje me autoritetet kompetente që të shkëmbehet informacion mbi nivelet e ekspozimit të këyre materialeve që njihet se shkaktojnë sëmundje jo ngjitëse, siç janë kanceri ose sëmundje të mushkërisë.

14. Gjithashtu, klienti duhet të bëjë përpjekje, të justifikuara nga ana tregëtare, për të kontrolluar sigurinë e transportimit të lëndës së parë dhe sigurinë e transportimit dhe hedhjes së mbeturinave, dhe duhet të ndërmarrë masa për të shmangur ose kontrolluar ekspozimin e komunitetit. Duhet të komunikohet informacion mbi riskun, ekspozimin e popullsisë, masat zbutëse dhe kontrollin tek autoritetet përkatëse dhe tek publiku.

Çështje mbi mjedisin dhe burimet natyrore

15. Klienti duhet të parandalojë dhe shmangë ose minimizojë përkeqësimin e ndikimeve të shaktuara nga rreziqet natyrore, siç janë rrëshqitjet e tokës ose përmytjet, të cilat mund të shkaktohen nga ndryshime në përdorimin e tokës si rezultat i aktiviteteve të projektit.

16. Klienti duhet të shmangë ose minimizojë edhe ndikimet e pafavorshme të shaktuara nga aktivitetet e projektit mbi ajrin, tokën, ujin, florën e faunën dhe mbi burimet e tjera natyrore që janë në përdorim nga komunitetet e prekura.

Ekspozimi i komunitetit ndaj sëmundjeve

17. Klienti duhet të identifikojë ato sëmundje ngjitëse që mund të transmetohen nga përbërësit ose nga punonjësit e projektit (duke përfshirë kontraktorët). Aty ku është e përshtatshme duhet të hartohen Plane veprimi në mënyrë që të parandalohet ose minimizohet mundësia e ekspozimit të punonjësve dhe komunitetit ndaj sëmundjeve ngjitëse që mund të rezultojnë nga aktivitetet e projektit. Kur disa sëmundje specifike janë tipike për hapësirën e prekur nga projekti, klienti nxitet që të eksplorojë mundësitë gjatë periudhës së projektit për të përmirësuar kushtet mjedisore që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e shfaqjes së tyre, ndërmjet punonjësve dhe në nivel vendor.

Gatishmëria dhe përgjigja ndaj rasteve emergjence

18. Klienti duhet të jetë i përgatitur për t'ju përgjigjur situatave shqetësuese, të papritura dhe emergjente në një mënyrë të përshtatshme për të parandaluar risqet operationale si dhe pasojat e mundshme negative të tyre.

19. Si pjesë e vlerësimit të klientit për sa i përket shëndetit publik, riskut të sigurisë dhe ndikimeve të mundshme nga aktivitetet e lidhura me projektin (shih paragrafin 7 më sipër), klienti duhet të identifikojë rreziqet për aksidentet më të rënda, dhe duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet e rënda dhe të kufizojë pasojat e tyre mbi njerëzit dhe mjedisin, me synim që të sigurojë nivele të larta mbrojtje të njerëzve dhe të mjedisit në një mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Masa të tilla duhet të identifikohen në Politikën për parandalimin e aksidenteve të rënda/përgatitje për emergjencë dhe në një sistem menaxhimi të përshtatshëm duke përfshirë strukturën e organizimit, përgjegjësitë, procedurat, komunikimin, trajnimin, burimet dhe aspektet e tjera të nevojshme për të zbatuar një politikë të tillë që ti përgjigjet në mënyrë efektive emergjencave që lidhen me rreziqe të projektit. Sistemi i menaxhimit duhet të përfshijë një plan emergjence të brendshëm dhe një të jashtëm. Planet e emergjencës së jashtme duhen të hartohen sipas objektivave të mëposhtme:

- të ndalojnë dhe kontrollojnë incidentet në mënyrë që të minimizojnë efektet, dhe të kufizojnë dëmtimet tek njerëzit, mjedisi dhe pronat,
- të zbatojnë masat e nevojshme për të mbrojtur njerëzit dhe mjedisin nga efektet e aksidenteve të rënda,
- të komunikojnë informacionin e nevojshëm tek publiku dhe tek shërbimet e emergjencës ose tek autoritetet publike të posaçme në atë hapësirë, dhe
- të ndihmojnë për rregullimin dhe pastrimin e mjedisit pas çdo aksidenti të rëndë.

20. Klienti duhet të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me komunitetin dhe agjencitë qeveritare vendase në përgatitjet e tyre për t'ju përgjigjur efektivisht situatave të emergjencës, sidomos kur pjesëmarrja dhe bashkëpunimi janë të nevojshme për t'iu përgjigjur situatave të tilla emergjence. Në qoftë se agjencitë qeveritare vendase kanë pak ose aspak kapacitet për tu përgjigjur efektivisht, klienti duhet të luajë rol aktiv për tu përgatitur dhe për tu përgjigjur ndaj situatave të emergjencës që janë të lidhura me projektin, dhe të ketë kapacitete për tu përgjigjur incidenteve që janë të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte (p.sh me ndihmën e reaguesve ndaj emergjencave, reagues të kontraktuar nga një palë e tretë, siguracione). Klienti duhet të dokumentojë gatitshmërinë ndaj emergjencave dhe aktivitetet reaguese, burimet dhe përgjegjësitë, dhe të japë informacionin e duhur në PVMS ose në ndonjë dokument tjetër të përshtatshëm tek komunitetet e prekura dhe agjencitë qeveritare përkatëse, në përputhje me kërkesën e performancës nr. 10. Si pjesë e parandalimit të emergjencës dhe planifikimit të reagimit, klienti duhet të informojë komunitetet që mund të preken për rreziqet e rëndësishme dhe të përgatisë plane reagimi, duke respektuar edhe aspektet kulturore.

21. Klienti duhet të vërë në provë planet e parandalimit dhe reagimit bazuar në një program të përshtatshëm me sektorin dhe riskun e lidhur me projektin, të paktën një herë në vit. Klienti duhet të mbajë në dijeni autoritetet lokale dhe komunitetet sistematikisht, kur planet ndryshojnë ose duhet të testohen.

22. Si pjesë e përgjigjes ndaj emergjencave, klienti duhet të ruajë komunikim të afërt me reagues emergjencash të përshtatshëm, si dhe me autoritetet, median, dhe me komunitetin vendas në mënyrë që t'i informojë ata mbi situatën dhe mbi çfarë është duke u bërë për t'ju përgjigjur asaj dhe për të parandaluar incidente në të ardhmen.

Kërkesat për sigurinë e personelit

23. Kur klienti mban punonjës ose kontraktues që të ofrojnë direkt siguri për të mbrojtur personelin dhe pronën e tij, atëherë ai duhet të vlerësojë risqet që kanosen nga marrëveshjet e sigurisë për të gjithë ata që ndodhen brenda ose jashtë vendndodhjes ose pajisjeve të projektit.

Në kryerjen e këtyre marrëveshjeve, klienti duhet të udhëhiqet nga ligjet e përpjesëtimit, nga praktikat ndërkombëtare për sa i përket punësimit, rregullat e sjelljes, trajnimit, furnizimit dhe kontrollit të personelit, si dhe ligjit të zbatueshëm. Klienti duhet të kryejë kërkime të arsyeshme për tu siguruar se personeli i sigurisë nuk ka qenë të përfshirë në abuzime në të shkuarën, duhet të sigurohet se ata janë të trajnuar mjaftueshëm në përdorimin e forcës (dhe, aty ku është e zbatueshme, në përdorimin e armëve të zjarrit), kanë sjelljen e duhur kundrejt punonjësve dhe komunitetit lokal, dhe tu kërkohet të vepronë brenda ligjit të zbatueshëm. Klienti nuk duhet të lejojë përdorimin e forcës, përveç rasteve kur bëhet fjalë për qëllime mbrojtje dhe parandalimi, dhe forca e përdorur duhet të jetë në përpjestim me natyrën dhe shtrirjen e kërcënimit. Mekanizmat e ankesave të klientit, të cilat janë bzuhen në KP 10 dhe KP 2, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të lejojnë komunitetin e prekur si dhe punonjësit të shprehin shqetësimet e tyre mbi marrëveshjet e sigurisë dhe veprimet e personelit të sigurisë; klienti duhet të informojnë komunitetet dhe punonjësit për disponueshmerinë dhe përdorimin e mekanizmave për këtë qëllim.

24. Në qoftë se qeveria ka ofruar personel sigurie për shërbime sigurie për klientin, atëherë klienti duhet të vlerësojë risqet e mundshme prej përdorimit i këtij personeli, të komunikojë tek autoritetet përkatëse publike qëllimin e tij që personeli i sigurisë të vepronë në mënyrë të pajtueshme me paragrafin 23 më sipër, dhe të nxisë autoritetet përkatëse publike të shpallin marrëveshjet e sigurisë për pajisjet e klientit tek publiku, i cili mund të jetë subjekt i shqetësimeve prej rrezikut.

25. Klienti duhet të hetojë çdo deklaratë për veprime të jashtëligjshme apo abuzive të kryera nga personeli i sigurisë, të ndërmarrë veprime (ose të nxisë personat e duhur të ndërmarrin veprime) për të parandaluar rishfaqjen e veprimeve të tilla, dhe të raportojë veprimet e paligjshme dhe abuzive tek autoritetet publike, kur është e nevojshme.

KP 5:

Blerje Toke, Strehim i Padëshiruar dhe Zhvendosje Ekonomike

Hyrje

1. Strehimi i padëshiruar nënkupton zhvendosje fizike (zhvendosje ose humbje e strehimit) dhe zhvendosje ekonomike (humbje pasurie ose të drejtën mbi pasurinë e cila çon në humbje të burimeve të të ardhurave ose mjeteve të jetesës) si rezultat i blerjes së tokës¹ për shkak të projektit ose heqjes së të drejtës mbi pasuritë natyrore².
2. Strehimi konsiderohet si i padëshiruar kur individët ose komunitetet e prekura nuk kanë të drejtë të refuzojnë blerjen e tokës, e cila rezulton në zhvendosje. Kjo ndodh në rastet që vijojnë: (i) shpronësim i ligjshëm ose kufizime në përdorimin e tokës bazuar në një pronë të shquar²; dhe (ii) në marrëveshje të negociuara ku blerësi ka mundësinë të çojë në shpronësim ose kufizime të ligjshme për përdorimin e tokës kur bisedimet me shitësin dështojnë.
3. Aplikimi i kësaj Kërkese Performance mbështetet dhe është në përputhje me respektimin universal dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe veçanërisht me të drejtën për strehimin e duhur dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës³. Në rastet kur është kryer zhvendosje si rezultat i një konflikti përpara pjesëmarrjes së BERZH, kjo kërkesë performance mbështet zbatimin e Rregullave Udhëzuese për Zhvendosje të Brendshme.⁴
4. Nëse nuk menaxhohet siç duhet, strehimi i padëshiruar mund të rezultojë në përpjekje afatgjatë dhe në varfërim të individëve dhe komuniteteve të prekura, dëmtime mjedisore, dhe efekte negative sociale-ekonomike në zonat ku është kryer zhvendosja. Në disa rrethana, një strehim i padëshiruar i kryer në mënyrë të papërshtatshme, mund të çojë klientin në çështje gjyqësore në jurisdiksione të tjera. Kjo ndodh sidomos kur projekti është i vendosur në një vend me një jurisdiksion të tillë ku njerëzit e zhvendosur nuk kanë kompensim ligjor të plotë ose nuk kanë mbrojtje nga procedurat në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për këto arsye, strehimi i padëshiruar duhet të shmanget ose të paktën të minimizohet. Megjithatë, aty ku është i pashmangshëm, duhet që të merren masa të përshtatshme për të zbutur efektet negative mbi njerëzit e zhvendosur dhe mbi komunitetet mikëpritës⁵, të cilat duhet të planifikohen dhe zbatohen me kujdes. Përvoja tregon se përfshirja direkte e klientit në aktivitetet e strehimit dhe vlerësimi i bërë në fazën më të hershme të hartimit të projektit, mund të rezultojë në zbatimin më efektiv ekonomik, dhe në kohë të këtyre aktivitetëve, dhe në nxitjen e rrugëve të reja për përmirësimin e jetes dhe standarteve të jetesës të atyre që janë të prekur nga strehimi.

¹ Blerja e Tokës përfshin blerje direkte të pasurisë dhe blerje të aksesit mbi të drejtat, sic është mënyra 'të drejta mbi'.

² Shembujt përfshijnë kufizime të aksesit për të drejtat në shfrytëzimin e mineraleve në sipërfaqen e tokës prej minatorëve artizanale, humbjen e aksesit për zonat e peshkimit në det si rezultat i aktivitetëve të projektit, kufizim të aksesit për burimet brenda zonave të përcaktuara nga shteti si të përjashtuara dhe që nuk janë kërkuara nga klienti si të tilla, rënie e demonstruar e prodhimit bujqësor, blektoral, pyllit, gjuetisë, peshkimit që shkaktohet nga shqetësimet prej aktivitetëve të projektit dhe/ose ndotjes.

³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) dhe Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1966)

⁴ Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut: Rregullat Udhëzuese për Zhvendosjen e Brendshme.

⁵ Një komunitet mikëpritës është një komunitet që pret persona të zhvendosur

5. Marrëveshjet e biseduara ndihmojnë për të shmangur shpronësimin dhe eliminojnë nevojën për të përdorur autoritetet qeveritare për të larguar njerëzit me forcë. Këto marrëveshje mund të arrihen zakonisht duke ofruar një kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm si edhe nxitës ose përfitime të tjera tek personat ose komunitetet e prekur, dhe duke zbutur rreziqet e informacioneve jo të njëjta dhe të fuqisë së negociimit për çmimin. Pra, klientët nxiten të fitojnë të drejta mbi tokat duke përdorur marrëveshje të negociuara aty ku është e mundur, edhe pse ata mund të kenë mjetet ligjore për ta fituar aksesin mbi tokën pa marrë lejen e shitësit.

Objektivat

6. Objektivat e kësaj kërkesë performance janë:
- të shmangë ose të paktën të minimizojë⁶ strehimin e padëshiruar kur është e mundur, duke eksploruar rrugë alternative për projektin;
 - të zbusë efektet negative shoqërore dhe ekonomike që vijnë nga blerja e tokës ose nga kufizimet në përdorimin e tokës nga personat e prekur duke: (i) ofruar një kompensim të barabartë me koston e zhvendosjes për humbjen e aktiveve⁷; dhe (ii) siguruar që zbatimi i aktiviteteve të strehimit/risistemimit është shoqëruar me dhënien e informacionit, konsultimin, dhe e pjesëmarrjen e informuar të atyre që janë të prekur;
 - të përmirësojë ose, minimalisht, të ruajë standartet e jetesës së personave të prekur⁸ në nivelin para fillimit të projektit, duke marrë masa lidhur me pagën dhe/ose mbi sipërmarrjen, në mënyrë që të lehtësojnë përmirësimet të qëndrueshme të statusit shoqëror-ekonomik të tyre;
 - të përmirësojë kushtet e jetesës së njerëzve të zhvendosur duke u ofruar atyre një strehim të duhur⁹ me garanci zotërimi¹⁰ në vendndodhjet e strehimit.

Kuadri i zbatimit

7. Kjo Kërkesë Performance zbatohet për zhvendosjen fizike ose ekonomike, e cila mund të jetë e plotë, e pjesëshme, e përhershme, ose e përkohshme, dhe që rezulton nga transaksione të tipeve të mëposhtëm:
- të drejta mbi tokën të fituara për një projekt nëpërmjet shpronësimit ose procedurave të detyrueshme.

⁶ Vetëm nëse për këndvështrimin e Bankës kjo rrezikon shëndetin dhe sigurinë e personave të ndikuar.

⁷ Zakonisht kjo përlllogarit si vlera në treg e aktiveve dhe kostove të transaksionit që nevojiten për kthimin e këtyre aktiveve. Përlllogaritja e koston së zhvendësimit është komplekse në varësi të llojeve të tokës, pretendimet e përdoruesve të tokës dhe nivelet e ndryshme të zhvillimit të tregut të tokës në vendet anëtare. Për këtë arsye klientët duhet të identifikojnë dhe të konsultohen me të gjithë personat dhe komunitetin që do të zhvendësohen me blerje të tokës si edhe të ftojnë popullsinë të mirëpresë personat e rivendosur, në mënyrë që të sigurohet informacioni i duhur në lidhje me pronësinë e tokës, pretendimet dhe përdoruesit. Duke zbatuar këtë mënyrë vlerësimi, zhvlerësimi i strukturave dhe pasurive nuk do të merret në konsideratë. Atje ku tregjet e trojeve janë akoma në një nivel zhvillimi, klientët duhet të kërkojnë vlerësim nga ekspertë vlerësues të pavarur të jashtëm (ose nëse nuk ka ekspertë profesionistë vlerësimi, profesionistë më një eksperiencë përkatëse e pranueshme për BERZH dhe klientin). Shihni gjithashtu Shënimin 17.

⁸ Këtu përfshihen të gjithë personat që kanë të drejta dhe pretendime ligjore për tokën, ata që kanë kërkesa për tokën, ata që nuk kanë të drejta ligjore ose pretendime për tokën, përdoruesit sezonal të burimeve si p.sh familjet e barinjve/peshkatarëve, gjahtarët ose grupe që mund të kenë marrëdhënie të pavaruara ekonomike me komunitetin në zonën e projektit.

⁹ Strehimi i duhur mund të matet nga cilësia, siguria, lejueshmëria, mundësia për të jetuar, përshtatja kulturore, lehtësitë hyrëse dhe karakteristikat e vendodhjes. Strehimi i duhur duhet të ketë mundësi punësimi, tregjet e infrastrukturën kryesore dhe shërbimet si p.sh uji, energjia elektrike, higjiena, kujdesi për shëndetin, dhe edukimi. Këto KP lejojnë strehimin e duhur dhe sigurinë e personave të zhvendosur në vendet e strehimit. Klientët duhet të përfshijnë një ose më shumë nga këto aspekte për strehimin e duhur në këtë paragraf në mënyrë që të ofrojnë kushte të përmirësuara jetese në vendin e strehimit, vecanërisht për ata që nuk kanë të drejta ligjore ose pretendime për tokën ku jetojnë.

¹⁰ Një rivendojse e vendodhjes ofron siguri për zotërim nëse mbron në shtrirjen më të madhe të mundshme, personat e rivendosur nga dëbimi me forcë.

- të drejta mbi tokën të fituara nga një projekt nëpërmjet marrëveshjeve të negociuara me pronarët e pasurisë ose me personat që kanë të drejta ligjore mbi tokën, duke përfshirë të drejta tradicionale të njohura ose që mund të njihen nga ligjet e shtetit, nëse shpronësimi ose procedura e detyrueshme nëpërmjet bisedimeve ka dështuar.¹¹
 - Imponim kufizimesh që rezultojnë në humbjen e aksesit në aktive fizike ose në burime natyrore, duke mos marrë parasysh nëse këto të drejta kufizimesh janë fituar nëpërmjet negociatave, shpronësimit, blerjes së detyrueshme, ose nëpërmjet rregullimit qeveritar.
8. Kërkesat dhe përgjegjësitë kundrejt personave të zhvendosur të cilët nuk kanë ndonjë të drejtë të njohur ligjërisht mbi tokën e zënë janë përfshirë në paragrafet 31, 36 dhe 39 më poshtë.
 9. Kjo kërkesë performance nuk zbatohet për risistemimin që rezulton nga transaksione të vullnetshme tokash (p.sh, transaksione ku shitësi nuk është i detyruar të shesë dhe blerësi nuk mund të çojë në shpronësim apo ndonjë procedurë tjetër të detyrueshme nëse negociatat dështojnë).
 10. Zbatueshmëria e kësaj Kërkesë Performance do të vendoset nga BERZH në përputhje me kriteret e paraqitura në Paragrafet 7 deri 9 më sipër gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe shoqëror. Zbatimi i veprimeve të duhura për të plotësuar këtë Kërkesë Performance menaxhohet nëpërmjet Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social të klientit (PVMS) dhe/ose nëpërmjet sistemit të menaxhimit. Aty ku kemi raste të strehimit të padëshiruar më parë përfshirjes së Bankës, duhet të tregohet kujdesi i duhur për të identifikuar a) ndonjë boshllëk dhe b) veprimet korrigjuese që mund të nevojiten për të siguruar përputhjen me këtë Kërkesë Performance. Më pas, duhet hartuar plani i veprimit. Vlerësimi dhe menaxhimi i procesit të strehimit/risistemimit janë të përcaktuar në këtë Kërkesë Performance. Vlerësimi mjedisor dhe shoqëror dhe kërkesat e menaxhimit janë paraqitur në Kërkesat e Performancës Nr 1 dhe Nr 10.

Kërkesat

Kërkesat e përgjithshme

Hartimi i projektit

11. Klienti duhet të konsiderojë alternativa të realizueshme për hartimin e projektit në mënyrë që të shmangë ose të paktën të minimizojë zhvendosjen fizike dhe/ose zhvendosjen ekonomike, duke balancuar kostot dhe përfitimet mjedisore, shoqërore dhe financiare.

Konsultimi

12. Pas dhënies së plotë të informacionit të përshtatshëm, klienti duhet të konsultohet me të gjithë individët dhe komunitetet e prekura, përfshirë komunitetet mikpritës, dhe duhet të lehtësojë pjesëmarrjen e hershme dhe informimin e tyre për proceset e vendimmarrjes mbi strehimin, në përputhje me Kërkesën e Performancës nr 10.

¹¹ Këto negociata mund të kryhen nga kompania e sektorit privat e cila blen tokën ose nga një agjent i kompanisë. Në rastin e projekteve të sektorit privat, në të cilat të drejtat mbi tokën mbahen nga qeveria, negociatat mund të kryhen nga qeveria ose nga kompania private si agjent i qeverisë.

- Personave të prekur¹² do tu jepet mundësia që të marrin pjesë në negociatat për paketat e kompensimit, për kërkesat e pranueshmërisë, për asistencën e strehimit, për përshtatshmërinë e vendndodhjeve të propozuara për strehimin si dhe për kohën e propozuar.
- Për konsultimet që përfshijnë vendasit si dhe personat që janë pjesëtarë të grupeve të cënuara¹³ duhen marrë masa të veçanta (shih Kërkesën e Performancës Nr.7).
- Konsultimi duhet të vazhdojë gjatë zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të pagesës dhe shlyerjes së kompensimit në mënyrë që të arrihen rezultate që janë në përputhje me objektivat e kësaj KP.

Mekanizmi i ankesave

13. Mekanizmi i ankesave përfshirë këtu edhe një mekanizëm mbështetjeje të hartuar për të zgjidhur konfliktet në një mënyrë të paanshme, duhet të hartohet nga klienti në përputhje me Kërkesën e Performancës Nr 10, që të zbatohet sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me këtë Kërkesë Performance, procesi që të merren dhe të shqyrtohen në kohë ankesat specifike për kompensimin dhe rivendosjen të paraqitura nga personat e zhvendosur dhe/ose nga pjesëtarët e komuniteteve mikpritës. Një përmbledhje e ankesave dhe masave të ndërmarra për ti zgjidhur ato, do të bëhet publike sistematikisht, në përputhje me Kërkesën e Performancës nr 10.

Planifikimi dhe zbatimi i strehimit/risistemimit

14. Aty ku strehimi i padëshiruar është i pashmangshëm, klienti duhet të angazhojë një specialist të kualifikuar posaçërisht për të bërë një regjistrim të përgjithshëm dhe një vlerësim të nivelit ekonomiko-shoqëror brënda zonës së prekur, si dhe për të ndihmuar në përgatitjen e Plan Veprimit të Strehimit ose Kuadrit të Regullimit të Vendstrehimit.
- regjistrimi i përgjithshëm dhe vlerësimi i nivelit ekonomiko-shoqëror duhet të identifikojë personat të cilët do të zhvendosen (plotësisht ose pjesërisht) nga projekti, duhet të përcaktojë se cili do të jetë kompensimi i pranueshëm dhe asistenca e duhur dhe përcaktojë një datë të caktuar, do të dekurajojë fluksin e njerëzve⁷ të cilët nuk ju takon të marrin këto përfitime.
 - Në mungesë të procedurave qeveritare kombëtare, data e përfundimit të regjistrimit të përgjithshëm dhe të inventarit të pasurive duhet të jetë dhe data përcaktuese për përfitueshmërinë. Informacioni që ka të bëjë me datën përcaktuese të përfitueshmërisë duhet të jetë i dokumentuar mirë dhe njoftohet në të gjithë hapësirën e projektit.

¹² Përfshirë ata që mund të mos jenë fizikisht të pranishëm, për shembull zhvendosja që rezulton nga një konflikt i mëparshëm ose aktual.

¹³ Grupe të cënuara ose “në risk” përfshijnë njerëz të cilët, për shkak të gjinisë, prejardhjes, moshës, paaftësisë fizike ose mendore, pamundësisë ekonomike ose statusit social mund të ndikohen më shumë negativisht nga zhvendosja se sa njerëzit e tjerë, si dhe ata që mund të kenë mundësi të kufizuara për të përfituar nga asistenca e strehimit dhe përfitime të tjera lidhur me zhvillimin. Grupet e cënuara në kontekstin e zhvendosjes përfshijnë gjithashtu njerëz të cilët jetojnë nën kufirin e varfërisë, ata që nuk kanë tokë, të moshuarit, familjet me kryefamiljar gra ose fëmijë, minoritetet etnike, komunitetet e varura nga burimet natyrore ose persona të tjerë të zhvendosur të cilët nuk janë të mbrojtur nëpërmjet kompensimit kombëtar për tokat ose nga legjislacioni për rregullimin e titujve të tokave. Këto grupe duhet të identifikohen nëpërmjet procesit të vlerësimit mjedisor dhe shoqëror (shih Kërkesën e Performancës Nr 1). Nevojiten masa të veçanta për konsultimin dhe ndihmën për zhvillim në mënyrë që të lejojnë këto grupe të kenë një pjesëmarrje kuptimplotë në planin e strehimit dhe të përfitojnë nga mundësitë e zhvillimit. Personat e identifikuar si të cënuar duhet të ndihmohen në mënyrë që të kuptojnë plotësisht mundësitë që u ofrohen për strehim dhe kompensim, dhe duhet të nxiten të zgjedhin mundësinë që përmban riskun më të ulët.

- Përdoruesit sezonal të burimeve mund të mos jenë të pranishëm në zonën e projektit gjatë kohës së regjistrimit të përgjithshëm dhe për këtë arsye duhet të tregohet vëmendje e veçantë për kërkesat e këtyre komuniteteve.

Plan Veprimi për Strehimin

15. Në rastin e transaksioneve të përshkruara në paragrafin 7 që përfshijnë zhvendosjen fizike të njerëzve, klienti, në bazë vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe shoqëror, duhet të zhvillojë një Plan Veprimi për Strehimin (PVS) i cili mbulon, minimalisht, kërkesat e zbatueshme të kësaj Kërkesë Performance, pavarësisht nga numri i njerëzve të prekur.

16. PVS do të:

- hartohet për të zbutur efektet e pafavorshme të zhvendosjes, për të identifikuar përfitime të mundshme të zhvillimit dhe për të krijuar emërtimet e të gjitha kategorive të personave të prekur (përfshirë komunitetet mikpritëse), me një kujdes të veçantë kundrejt nevojave të personave të varfër dhe të cënuar;
- dokumentojë të gjitha transaksionet për përfitimin e të drejtave mbi tokat, si dhe masat e kompensimit dhe aktivitetet e zhvendosjes;
- hartojë procedura për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e planeve të strehimit dhe të ndërmarrë veprime korrigjuese, nëse është e nevojshme.

17. Shtrirja dhe niveli i detajimit të PVS duhet të ndryshojë në varësi të gjerësisë së vendosjes dhe të kompleksitetit të masave të nevojshme për të zbutur efektet negative. Në të gjitha rastet, duhet të përshkruajë mënyrën se si do të përmbushen objektivat e kësaj Kërkesë Performance. Minimalisht, PVS duhet të:

- përcaktojë objektivat e strehimit;
- përshkruajë efektet e projektit, identifikojë të gjithë njerëzit që do të zhvendosen dhe të bëjë një inventar të pasurive të prekura;
- tregojë që zhvendosja është e pashmangshme dhe që është e minimizuar;
- përshkruajë strukturën ligjore për blerjen e tokës dhe kompensimin;
- përshkruajë procesin e konsultimit me personat e prekur për sa i përket alternativave të pranueshme të strehimit, dhe nivelit të pjesëmarrjes së tyre në procesin e vendim-marrjes;
- përshkruajë titullimet për të gjitha kategoritë e personave të zhvendosur;
- rendisë vlerat e kompensimit për aktivet e humbura dhe të tregojë që këto vlera janë të sakta, të paktën të barabarta me koston e zëvendësimit të aktiveve të humbura;
- përshkruajë procesin e përzgjedhjes, caktimit, përgatitjes dhe titujve të tokave që kanë të bëjnë me zhvendosjen e banesave;
- përshkruajë asistencën që do të ofrohet për zhvendosjen;
- ofrojë detaje për marrëveshjet për përmirësim ose, minimalisht, restaurim të jetës dhe të standarteve të jetesës së personave të zhvendosur;
- paraqisë përgjegjësinë institucionale/organizuese për zbatimin e PVS dhe procedurat për korrigjimin e ankesave;
- ofrojë një periudhë kohore dhe buxhet për zbatimin e PVS;
- ofrojë detaje për marrëveshjet e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit; dhe

- kur blerja e tokës nuk rezulton në humbje të jetesës apo të të ardhurave, të ofrojë një kompensim të drejtë për tokën e blerë dhe për çdo aktiv të humbur mbi këtë tokë në koston e zëvendësimit të tyre.
18. PVS duhet të marrë në konsideratë çdo individ ose grup që mund të jetë i pafavorizuar ose i prekur. Veçanërisht, PVS duhet të përfshijë masa për të siguruar se grupet e cënuara dhe “në risk”¹⁴ dhe gratë nuk janë të pafavorizuar në procesin e strehimit, janë të informuar plotësisht mbi të drejtat e tyre, dhe janë të aftë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga përfitimet e strehimit, duke siguruar veçanërisht se dokumentat e pronësisë ose përdorimit, si për shembull titujt e pronësisë apo kontratat e qerasë, dhe kompensimi (përfshirë llogaritë bankare të themeluara për pagesën e kompensimit) janë lëshuar në emër të bashkëshortëve ose grave të pamartuara në krye të familjeve, sipas rastit, dhe që çdo asistencë tjetër strehimi, si p.sh trajnimi, aksesit në kredi dhe mundësi punësimi janë të disponueshme në mënyrë të barabartë ndërmjet grave dhe të përshtatura me nevojat e tyre. Në rrethanat kur ligji kombëtar dhe sistemet e pronësisë nuk njohin të drejtat e grave për të mbajtur ose kontraktuar pasuri, duhet të merren masa për të siguruar, aq sa është e mundur, se aksesit në grave në marrjen e pronësisë është ekuivalent me atë të burrave.
 19. PVS duhet të përmbajë masa për të siguruar se njerëzve të zhvendosur u është ofruar, kur është e mundur, asistencë ligjore që i mundëson ata të përmbushin kërkesat administrative përpara blerjes së tokës dhe, nëse është e nevojshme, të kërkojnë rishqyrtim nga gjykatat.
 20. Klienti duhet të përmbledhë informacionin e përfshirë në PVS për ta paraqitur në publik në mënyrë që të sigurojë se njerëzit e prekur kuptojnë procedurat e kompensimit dhe e dinë çfarë të presin gjatë fazave të ndryshme të projektit (p.sh, kur do të bëhet një ofertë, sa kohë do të kenë në dispozicion për të dhënë një përgjigje, procedurat ligjore që duhet të ndjekin nëse negociatat dështojnë).
 21. Kontrolli i PVS duhet të bëhet në përputhje me Kërkesën e Performancës nr 1 dhe mund të përfshijë edhe pjesëmarrjen e grupeve kryesore të interesuar si p.sh. komunitetet e prekura.
 22. Strehimi do të konsiderohet i përfunduar kur efektet negative të strehimit të jenë korrigjuar në përputhje me objektivat e paraqitura në PVS si dhe objektivat e kësaj Kërkesë Performance.
 23. Në varësi të shkallës së strehimit që do të zbatohet në kuadër të projektit, mund të jetë e nevojshme për klientin që të punësojë një auditor të jashtëm për përfundimin e PVS i cili duhet të vendosë nëse masat janë përmbushur. Auditori duhet të punësohet pasi kanë përfunduar të gjitha inputet për PVS-përfshirë nismat e zhvillimit, por shumë kohë më parë se të jenë përmbushur detyrimet financiare të klientit ndaj BERZH. Koha e auditit duhet të mundësojë që klienti të përfundojë aktet korrigjuese, nëse ekzistojnë, të rekomanduara nga auditorët përpara përfundimit të projektit. Bazuar në rezultatin e auditit të përmbushjes, BERZH dhe klienti duhet të përcaktojnë së bashku nëse objektivat e kësaj Kërkesë Performance janë plotësuar. Në shumicën e rasteve, aktet korrigjuese të propozuara nga auditit i përmbushjes duhet të përmbushin përgjegjësinë e klientit për strehim, kompensim, restaurim jetese dhe përfitime zhvillimi.

Kuadri e Restaurimit të Mjeteve të Jetesës

24. Në rastin e transaksioneve të përshkruara në Paragrafin 7 që përfshijnë zhvendosjen ekonomike (por jo fizike) të njerëzve, klienti duhet të zhvillojë procedura për tu ofruar

¹⁴ Sic përcaktohet në shënimin 14

njerëzve dhe komuniteteve të prekura kompensim dhe ndihma të tjera që plotësojnë objektivat e kësaj Kërkese Performance. Këto ndihma duhet të marrin formën e Kuadrit të Restaurimit të Mjeteve të Jetesës (KRMJ).

25. KRMJ duhet të vendosë titullimet e njerëzve ose komuniteteve të prekura dhe duhet të sigurojë që këto titullime do të ofrohen në mënyrë transparente, të qëndrueshme dhe të paanshme. Klienti duhet të dokumentojë procedurat për të vendosur kompensimin në një dokument, i cili do të:
- konstatojë objektivat e KRMJ-së;
 - përshkruajë efektet e projektit, identifikojë të gjithë njerëzit e zhvendosur ekonomikisht dhe ofrojë një inventar të pasurive ose burimeve të prekura;
 - tregojë se zhvendosja është e pashmangshme dhe që është e minimizuar;
 - përshkruajë strukturën ligjore të kompensimit;
 - përshkruajë procesin e konsultimit me njerëzit e prekur për sa i përket alternativave, si dhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në procesin e vendimmarrjes;
 - përshkruajë titullimet për të gjitha kategoritë e njerëzve të zhvendosur;
 - përshkruajë metodat e zbatuara për të vlerësuar pasuritë ose burimet e prekura, ose aksesin mbi to, në një kosto të plotë zëvendësimi dhe duhet të përlllogarisë vlerat e kompensimit që duhen paguar;
 - përshkruajë masa të tjera për të përmirësuar ose, minimalisht, restauruar mjetet e jetës dhe standartet e jetesës së njerëzve të zhvendosur;
 - paraqisë një katalog për marrjen e tokës (ose një zbatim kufizimesh) dhe pagesat e kompensimit;
 - përshkruajë procesin me të cilin njerëzit e prekur mund të apelojnë kundër vlerësimeve që ata konsiderojnë si të pamjaftueshme.
 - paraqisë përgjegjësinë institucionale/organizative për zbatimin e KRMJ dhe procedurat për korrigjimin e ankesave;
 - ofrojë detaje për marrëveshjet për monitorim, vlerësim dhe raportim; dhe
 - ofrojë një periudhë kohore dhe buxhetin për zbatimin e KRMJ.
26. Klienti duhet të përmbledhë informacionin e përmbajtur në KRMJ me qëllim që ti jepet publikut, për të siguruar se njerëzit e prekur i kuptojnë procedurat e kompensimit dhe dinë se çfarë duhet të presin në çdo fazë të projektit (p.sh, kur do tu bëhet një ofertë, sa kohë kanë në dispozicion për të kthyer një përgjigje, procedurat ligjore që duhen ndjekur në rast se negociatat dështojnë).
27. Klienti duhet tu ofrojë komuniteteve të prekura mundësinë për të marrë pjesë në negociata, bazuar në procedurat e themeluara.
28. Në rastet kur njerëzit e prekur refuzojnë ofertat e kompensimit që plotësojnë kërkesat e kësaj Kërkese Performance, dhe, si rezultat, fillojnë shpronësimet apo procedura të tjera ligjore, klienti duhet të eksplorojë mundësitë për të bashkëpunuar me agjencinë përgjegjëse qeveritare, dhe nëse agjencia e lejon, klienti duhet të luajë një rol aktiv në planifikimin e strehimit, zbatimin dhe monitorimin.
29. Zbatimi i KRMJ duhet të konsiderohet i përfunduar kur efektet negative të zhvendosjes janë korrigjuar në përputhje me objektivat e konstatuara në KRMJ dhe me objektivat e kësaj Kërkese Performance.

Kompensimi dhe përfitimet për personat e zhvendosur

30. Kur zhvendosja nuk mund të shmanget, klienti do tu ofrojë njerëzve dhe komuniteteve të zhvendosura kompensim për humbjen e pasurive në kosto të plotë zëvendësimi¹⁵ dhe mbështetje të tjera për ti ndihmuar ata të përmirësojnë ose të paktën të rifitojnë standartet dhe mjetet e tyre të jetesës, ashtu siç parashikohet në këtë Kërkesë Performance. Standartet për kompensim duhet të jenë transparente dhe të qëndrueshme brenda kohës së projektit. Kur mjetet e jetesës së njerëzve të zhvendosur janë të bazuar mbi tokën, ose kur toka është në pronësi kolektive, klienti do të ofrojë kompensim të bazuar mbi tokën, aty ku është e realizueshme. Klienti duhet të bëjë çdo përpjekje për tu ofruar njerëzve dhe komuniteteve të zhvendosur mundësitë për të përfituar nga mundësitë për zhvillimin e projektit.

Zhvendosjet

31. Njerëzit e zhvendosur mund të klasifikohen si persona që: (i) kanë të drejta formale ligjore mbi tokën (duke përfshirë të drejtat tradicionale që njihen nga ligjet kombëtare); (ii) nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën në kohën e regjistrimit të përgjithshëm, por që kanë të drejtë për të kërkuar pronësinë e tokës, e cila është njohur ose mund të njihet nga ligjet kombëtare¹⁶; ose (iii) që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore që mund të njihet mbi tokën të cilën zenë¹⁷. Regjistrimi i përgjithshëm duhet të përcaktojë statusin e personave të zhvendosur. Njerëzit që lëvizin drejt zonës së projektit pas datës së përcaktimit të përfitueshmërisë (shih paragrafin 14), si p.sh. banorë të paligjshëm dhe emigrantë ekonomikë të porsa mbritur nuk janë të pranueshëm për kompensim apo ndonjë asistencë tjetër.

32. Personave që mbulohen në paragrafin 31 (i) dhe (ii), u ofrohet kompensim për tokën e humbur, dhe ndihma të tjera në përputhje me paragrafët 34 dhe 35. Personat e mbuluar nga paragrafi 31 (iii) nuk përfitojnë kompensim për tokat, por ata duhet të kompensohen për strukturat që zotërojnë dhe përdorin dhe për çdo ndryshim të bërë mbi tokat në koston e plotë të zëvendësimit. Gjithashtu, atyre duhet tu ofrohet asistencë strehimi e mjaftueshme për të rifituar standartet e tyre të jetesës në një vendndodhje alternative të përshtatshme. Alternativat e asistencës së strehimit duhet të përcaktohen nëpërmjet konsultimit me personat e zhvendosur dhe duhet të reflektojnë prioritetet dhe preferencat e këtyre të fundit.

¹⁵ Shkalla e kompensimit për asetet e humbura duhet përllogaritur mbi vlerën e plotë të kompensimit, që është vlera e tregut plus cmimin e transaksioneve. Kur zbatohet kjo metodë vlerësese, amortizimi i strukturave dhe aseteve nuk duhet marrë në konsideratë. Për humbjet që nuk mund të vlerësohen me lehtësi ose kompensohen në terma monetarë, mund të jetë më i përshtatshëm kompensimi në natyrë. Por ky kompensim duhet bërë në mallra ose burime që kanë vlerë të barabartë ose më shumë dhe që përshtaten edhe në dimensionin kulturor. Për tokat dhe strukturat, kostot e zëvendësimit janë përcaktuar si vijon:

- Tokë bujqësore – vlera e tregut për tokën në përdorim me produktivitet të barabartë ose e vendosur mundësisht pranë vendit të ndikuar, plus koston e përgatitjes në të njëjtin nivel ose më mirë se sa toka e ndikuar, dhe kostot e transaksionit të tilla si taksat e regjistrimit dhe të transferrimit.
- Toka në zonat urbane – vlera e tregut të tokës në një zonë të ngjashme për nga përdorimi, me infrastrukturë dhe shërbime të ngjashme ose të përmirësuara, e preferueshme të ndodhet pranë tokës së ndikuar dhe kostot e transaksionit të tilla si taksat e regjistrimit dhe të transferrimit.
- Banesat dhe struktura të tjera – kostoja e blerjes ose e ndërtimit të strukturës së re, me hapësirë dhe cilësi të ngjashme ose më të mirë se ato të ndikuara, ose riparimi i strukturës pjesërisht të ndikuar, përfshirë kostot e punës dhe pagesën e kontraktorëve dhe kostot e transaksionit të tilla si taksat e regjistrimit dhe të transferrimit.

¹⁶ Të drejta të tilla duhet të rrjedhin nga zotërimi i pafavorshëm ose nga ligji në fuqi ose ai tradicional.

¹⁷ Grupe të tilla banorësh vendorë, përdorues të zakonshëm, njerëz të zhvendosur apo shfrytëzues tokash të cilët pretendojnë pronësi ose që përdorin tokat pa të drejtë ligjore, dhe të tjerë, të cilët kanë të drejta përdorimi apo të drejta tradicionale mbi tokat e prekura apo burime të tjera të cilat nuk janë të njohura nga ligjet e vendit.

Këto rregulla janë të vlefshme për personat të cilët zënë plotësisht ose pjesërisht zonën e projektit përpara datës së përcaktimit të përfitueshmërisë.

33. Blerja e tokës për projektin mund të rezultojë në zhvendosjen fizike të njerëzve, si dhe në zhvendosjen ekonomike të tyre. Si rezultat, mund të zbatohen kërkesa si për zhvendosjen fizike dhe zhvendosjen ekonomike.

Zhvendosjet fizike

34. Nëse njerëzit që jetojnë në hapësirën e projektit duhet të lëvizin në një vendndodhje tjetër, atëherë klienti duhet të: (i) ofrojë njerëzve të zhvendosur mundësi për të zgjedhur ndërmjet alternativave të realizueshme strehimi, duke përfshirë këtu banesa zëvendësuese të përshtatshme ose kompensim me para në dorë, aty ku është e mundur; dhe (ii) ofrojë asistencë rivendosi të përshtatur me nevojat e secilit grup të personave të zhvendosur, duke treguar kujdes të veçantë për nevojat e njerëzve të varfër dhe të cënuar. Alternativa e strehimit apo kompensimit me para në dorë duhet të bëhet e disponueshme përpara rivendosi. Vendndodhjet e reja të strehimit duhet të ofrojnë kushte të përmirësuara të jetesës.
35. Në rastin e personave të zhvendosur fizikisht nën paragrafin 31 (i) ose (ii), klienti duhet të ofrojë zgjedhjen e një pasurie zëvendësuese në vlerë të barabartë ose më të madhe, me vlerën ekuivalente ose më shumë dhe me avantazhe pozicionimi, ose kompensim me para në dorë në vlerën e plotë të zëvendësimit, aty ku është e përshtatshme.^{18 19}
36. Në rastin e njerëzve të zhvendosur nën paragrafin 31 (iii), klienti duhet tu ofrojë atyre zgjedhje mundësish për strehim të përshtatshëm me garanci zotërimi në mënyrë që ata të mund të strehohen ligjërisht pa patur nevojën të përballen me riskun e dëbimit të imponuar.
- Kur këta njerëz të zhvendosur zotërojnë dhe zënë struktura të ndryshme, klienti duhet ti kompensojë ato për humbjen e pasurive të ndryshme nga tokat, si p.sh banesa dhe përmirësime të tokës të tjera, në kosto të plotë zëvendësimi, me kusht që këta njerëz kanë zënë zonën e projektit përpara datës së përcaktimit të përfitueshmërisë.
 - Kompensimi në të mallra, duhet të ofrohet në vend të kompensimit me para në dorë aty ku është e realizueshme, nëse kushtet e përshkruara në informacionin plotësues nr. 20 tregohet janë në nivelin e pranueshëm nga BERZH. Kjo zbatohet për ata që kanë të drejta tradicionale të njohura nga ligjet e shtetit; për pretendentët që, përpara datës së përcaktimit të përfitueshmërisë, nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokat, por kanë një pretendim pronësie mbi tokat apo aktive të tjera, si p.sh nëpërmjet zotërimit të pafavorshëm²⁰; dhe, nën përcaktimet e shënuara në paragrafin 31, për ata të cilët nuk kanë asnjë të drejtë të njohur ligjore apo pretendim pronësie për tokën të cilën kanë zënë.
 - Bazuar në konsultimin me personat të zhvendosur, klienti duhet të ofrojë asistencë rivendosi të mjaftueshme që ata të rifitojnë standartet e tyre të jetesës në një vendndodhje alternative të duhur²¹.

¹⁸ Pagesa e kompensimit me para në dorë mund të jetë e përshtatshme kur: (a) mjetet e jetesës nuk janë të bazuara mbi tokën; (b) mjetet e jetesës janë të bazuara mbi tokën, por toka e marrë për hir të projektit është një fraksion i vogël i tokës së prekur dhe toka e mbetur është ekonomikisht e "shëndetshme"; ose (c) ekzistojnë tregjet aktive për tokat, banesat dhe punësimin, njerëzit e zhvendosur i përdorin këto tregje, dhe ka ofertë të mjaftueshme për tokat dhe banesat. Niveli i kompensimit me para në dorë duhet të jetë i mjaftueshëm për të zëvendësuar tokën apo pasuritë e tjera të humbura në një kosto të plotë zëvendësimi në tregjet vendase.

²⁰ Një metodë blerje të titujve mbi një pasuri reale për një periudhë të njohur me ligje nën kushte të caktuara

²¹ Rivendosi e individëve joformal në zona urbane shpesh ka dilemma. P.sh. familjet e rivendosi mund të fitojnë garanci zotërimi, por mund të humbasin avantazhet e vendit ku vendosen.

37. Klienti nuk është i detyruar të kompensojë apo ndihmojë ata që vendosen në zonën e projektit pas datës së përcaktuar për përfitueshmërinë.
38. Kur komunitetet e vendasve zhvendosen fizikisht nga tokat tradicionalisht të zotëruara dhe përdorura prej tyre, klienti duhet të zbatojë kushtet e kësaj Kërkesë Performance si dhe ato të Kërkesës së Performancës nr 7.

Zhvendosjet ekonomike

39. Nëse një transaksion i njërit prej llojeve të përshkruara në paragrafin 7 shkakton humbje të të ardhurave ose të jetesës, p.sh nëpërmjet ndërprerjes apo eliminimit të aksesit që ka personi mbi pasuritë produktive të tij, pavarësisht nëse njerëzit e prekur janë fizikisht të zhvendosur, klienti duhet të:
- kompensojë ekonomikisht menjëherë personat e zhvendosur për humbjen e pasurive apo të aksesit mbi to me kosto të plotë zëvendësimi. Kur kompensimi është për tu paguar nga një agjenci qeveritare, klienti duhet të bashkëpunojë me agjencinë për të ndihmuar në përshpejtimin e pagesave. Kur pagesat e kompensimit nuk mund të bëhen menjëherë për shkak të politikave apo praktikave qeveritare, klienti duhet të eksplorojë mundësi të ndryshme për asistencën e strehimit në mënyrë që të ndihmojë njerëzit e zhvendosur të cilët kanë humbur përkohësisht të ardhurat e tyre.
 - kompensojë, në rastet kur blerja e tokës ndikon mbi struktura komerciale, pronarin e biznesit të prekur për (i) koston e rivendosjes së aktiviteteve tregtare diku tjetër, (ii) fitimin neto të humbur gjatë periudhës së tranzicionit, dhe (iii) kostot e transferimit dhe riinstalimit të fabrikës, makinerive apo pajisjeve të tjera, ashtu sic kërkohet.
 - ofrojë pasuri zëvendësuese (p.sh, hapësira bujqësore ose tregtare) të një vlere të barabartë ose më të madhe, ose kompensim me para në dorë në kosto të plotë zëvendësimi aty ku është më e përshtatshme, për njerëzit me të drejta ligjore ose me pretendime pronësie mbi tokat të cilat njihen prej ligjeve kombëtare (shih paragrafin 31 (i) and (ii));
 - ofrojë ndihmë që të kompensojë çdo humbje të komunitetit mbi burimet e përbashkëta të mbajtura prej tij²². Kjo ndihmë mund të marrë formën e nismave që përmirësojnë prodhueshmërinë e burimeve të mbetura mbi të cilat komuniteti ka akses, kompensim në të mallra ose në par në dorë për humbjen e aksesit ose dhënie aksesit në burime alternative të pasurisë së humbur.
 - kompensojë njerëzit e zhvendosur ekonomikisht, të cilët nuk kanë pretendime ligjore pronësie mbi tokën (shih paragrafin 31 (iii)) për pasuritë e ndryshme të humbura nga toka (si p.sh të korra, infrastrukturë ujitjesh dhe përmirësime të tjera të bëra mbi tokën), në një kosto të plotë zëvendësimi. Klienti nuk është i detyruar të kompensojë ose ndihmojë apersonat e ardhur në hapësirën e projektit pas datës së përcaktimit të përfitueshmërisë.
 - ofrojë ndihmë plotësuese (p.sh lehtësira për kredi, trajnime, ose mundësi punësimi) dhe mundësi për të përmirësuar ose të paktën për të rifituar kapacitetin për të fituar të ardhura, nivelet e prodhimit, dhe standartet e jetesës për njerëzit që janë zhvendosur ekonomikisht, jetesa e të cilëve është ndikuar negativisht. Në rastin e bizneseve që përjetojnë rënie ose që janë të detyruara të mbyllen si rezultat i zhvendosjes për shkak të projektit, pronari i biznesit dhe punonjësit që humbasin rrogat dhe punët e tyre janë përfitues të kësaj lloji asistence.

²² Shembuj për këtë mund të jenë kullotat, rezervat pyjore jo drurore (p.sh. bimët mjekësore, materialet e ndërtimit dhe artizanalet), dru për lëndë djegëse ose hapësira peshkimi.

- ofrojë mbështetje tranzitore për njerëzit e zhvendosur ekonomikisht, ashtu siç nevojitet, bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të kohës së nevojshme për të rifituar kapacitetin për të fituar të ardhura, nivelet e prodhueshmërisë, dhe standartet e jetesës;
40. Kur komunitetet vendase janë të zhvendosur ekonomikisht (por jo fizikisht) si rezultat i blerjes së tokës nga projekti, klienti duhet të plotësojë kushtet e zbatueshme të kësaj Kërkese Performance, si dhe ato të Kërkesës së Performancës nr 7.

Humbja e komoditeteve publike²³

41. Kur një projekt përfshin humbjen e komoditeteve, klienti duhet të ndërmarrë një konsultim kuptimplotë, në përputhje me Kërkesën e Performancës nr 10, me komunitetin e prekur vendas, në mënyrë që të identifikojë dhe të bjerë dakort për një alternativë të mundshme aty ku është e mundur.

Përgjegjësitë e sektorit privat lidhur me strehimin e rregulluar nga qeveria

42. Mund të ekzistojnë raste kur blerja e tokës dhe strehimi janë një përgjegjësi e qeverisë mikpritëse. Në të tilla raste, klienti duhet të bashkëpunojë me agjencinë përgjegjëse qeveritare, deri në masën e lejuar nga agjencia, për të arritur rezultate që janë në përputhje me objektivat e kësaj Kërkese Performance. Gjithashtu, aty ku kapaciteti i qeverisë është i kufizuar, klienti duhet të luajë një rol aktiv gjatë planifikimit të strehimit, zbatimit dhe monitorimit. Klienti duhet të përgatisë një plan i cili, së bashku me dokumentat e përgatitura nga agjencia përgjegjëse qeveritare, duhet të plotësojë kushtet e kësaj Kërkese Performance. Klientit mund ti duhet të përfshijë në planin e tij: (i) një përshkrim të titujve të personave të zhvendosur të përshtatur me ligjet dhe rregullat në zbatim; (ii) masat e propozuara për të mbuluar çdo boshllëk midis këtyre titujve dhe kushteve të kësaj Kërkese Performance; dhe (iii) përgjegjësiteë financiare dhe zbatuese të agjencisë përgjegjëse qeveritare dhe/ose të klientit.

²³ Shih fjalorin për përkufizimin e komoditeteve publike. Humbja e trashëgimisë kulturore mbulohet në Kërkesën e Performancës nr 8.

KP 6: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla

Hyrje:

1. BERZH njih nevojën për mbrojtjen dhe konservimin e biodiversitetit në kontekstin e projekteve në të cilat investon. Termi 'biodiversitet' (ose shumëllojshmëri biologjike) përkufizohet në Marrëveshjen mbi Diversitetin Biologjik (CBD) si *'ndryshueshmëria e organizmave të gjallë nga të gjitha burimet duke përfshirë, ndërmyjet të tjerash, atë tokësor, detar dhe ekosisteme të tjera ujore si dhe komplekset ekologjike në të cilat bëjnë pjesë; ai përfshin shumëllojshmërinë brënda llojeve, dhe ekosistemeve'*. Banka mbështet parandalimin si rrugën për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit si dhe menaxhimin e ndikimeve mbi të në përputhje me Deklaratën Rios dhe me CBD.
2. Në përpjekje për të arritur këto qëllime, Banka udhëhiqet dhe mbështet zbatimin e ligjit dhe marrëveshjeve të zbatueshme ndërkombëtare si dhe direktivat respektive të BE-së (shembuj të të cilave janë paraqitur në materialin informues në vijim)¹.

Objektivat:

3. Objektivat e kësaj Kërkese Performance janë:
 - të mbrojtë dhe të ruajë biodiversitetin;
 - të shmangë, minimizojë dhe zbusë ndikimet mbi biodiversitetin dhe të kompensojë ndikimet e rëndësishme që mbeten, aty ku është e përshtatshme, me qëllim që të mos lejojë humbje neto, por të arrijë një fitim neto të biodiversitetit;
 - të promovojë administrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
 - të sigurojë që njerëzit indigjenë dhe komunitetet vendase të marrin pjesë në procesin e vendimmartjes;
 - të ofrojë një ndarje të drejtë dhe të paanshme të përfitimeve nga zhvillimi i projektit dhe prej përdorimit të rezervave gjenetike;
 - të përforcojnë licensën e kompanive për të funksionuar, reputacionin e tyre si dhe avantazhin konkurrues nëpërmjet menaxhimit më të mirë dhe praktik të biodiversitetit, në të njëjtën kohë, si një risk biznesi dhe mundësi; dhe
 - të nxisë zhvillimin e biznesit pro-biodiversitetit, i cili ofron mjete jetese alternative në vend të shfrytëzimit të paqëndrueshëm të mjedisit natyror.

Kuadri i zbatimit

¹ Shembuj të marrëveshjeve relative dhe direktivave:

- Marrëveshja për Biodiversitetin Biologjik dhe protokollet e tij
- Marrëveshja për Hapësirat Ujore të Rëndësishme Ndërkombëtare; dhe Habitatet e Shpendëve të Ujit
- Marrëveshja për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në një Kontekst Ndërkufitar (Marrëveshja Espoo)
- Marrëveshja për Ruajtjen e Llojeve Migruese të Kafshëve të Egra
- Marrëveshja për Mbrojtjen e Detit të Zi Kundër Ndotjes
- Direktiva e Këshillit 92/43/EEC Maj 1992 për Ruajtjen e Habitatëve Natyrore dhe të Faunës së Egër dhe Florës
- Direktiva e Këshillit 79/409/EEC Prill 1979 për Ruajtjen e Shpendëve
- Direktiva e Këshillit 2004/35/EC Prill 2004 për Detyrimet Mjedisore
- Direktiva e Këshillit 85/337/EEC 27 Qershor 1985 sic rregullohet nga Direktiva 97/11/EC e 3 Mars 1997 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Direktiva e Këshillit 2001/42/EC Qershor 2001 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

4. Kjo Kërkesë Performance zbatohet për projektet në të gjitha llojet e habitateve, pavarësisht nëse ato janë shqetësuar apo degraduar në të shkuarën, nëse janë të mbrojtura ose janë apo jo pjesë të planeve të menaxhimit.
5. Zbatueshmëria e kësaj Kërkesë Performance vendoset nga Banka gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Banka duhet të hartojë kërkesat e përgjithshme, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të jenë në përputhje me këtë Kërkesë Performance, ndërsa klienti është përgjegjës për të propozuar një sërë masash specifike, të cilat do të shqyrtohen nga Banka, dhe duhen të ndërmerren për të siguruar përputhshmërinë, si pjesë e përgjithshme e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) dhe/ose e sistemit të administrimit. Kushtet e menaxhimit dhe vlerësimit mjedisor dhe shoqëror janë rreshtuar në Kërkesën e Performancës nr 1 dhe nr 10. Banka mund të punësojë specialistë të pavarur të biodiversitetit që të ndihmojnë për të kryer procesin e vlerësimit paraprak (*due diligence*).

Kërkesat

Vlerësimi i problemeve dhe ndikimeve

6. Nëpërmjet procesit të vlerësimit mjedisor, klienti duhet të identifikojë dhe karakterizojë efektet e mundshme të projektit mbi biodiversitetin. Shkalla e vlerësimit (*due diligence*) duhet të jetë e mjaftueshme për të karakterizuar plotësisht risqet dhe ndikimet e tyre, në përputhje me qasjen për të parandaluar dhe duke reflektuar shqetësimet e grupeve të interesit. Në proces, mund të shfaqet nevoja e punësimit të specialistëve që janë të trajnuar dhe të kualifikuar për këto çështje. Gjatë planifikimit dhe zbatimit të vlerësimit të ndikimeve ku problemet e biodiversitetit janë një shqetësim kryesor, klientët duhet tu referohen udhëzuesve të praktikës më të mirë për të integruar biodiversitetin në vlerësimet e ndikimeve². Vlerësimi duhet të marrë gjithashtu parasysh ndryshimet klimatike dhe problemet e përshtatjes. Kur zbatohen kërkesat e paragrafeve 13, 14 dhe 15, klienti duhet të punësojë ekspertë të jashtëm të kualifikuar dhe me përvojë, të cilët do të ndihmojnë në bërjen e vlerësimit.
7. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për natyrën, masën, kohëzgjatjen dhe intensitetin e ndikimeve; duhet të caktohet probabiliteti i shfaqjes së ndikimit si dhe rëndësia e këtyre ndikimeve.
8. Klienti duhet të identifikojë edhe masat e mundshme për të shmangur, minimizuar ose zbutur efektet negative dhe, aty ku është e përshtatshme dhe si mundësi e fundit, për të arritur fitim neto (dhe jo humbje neto) për biodiversitetin e prekur.

Hierarkia e parandalimit të zhdukjes së biodiversitetit	
Veprim	Përgjigje
1. Shmangë	Klienti duhet të përpiqet të shmang efektet negative mbi biodiversitetin.
2. Minimizojë	Kur ka efekte të rëndësishme mbi biodiversitetin që nuk mund të shmangen, klienti duhet të gjejë mënyra për të modifikuar projektin që të minimizohen efektet mbi biodiversitetin.
3. Zbusë	Kur ka efekte të rëndësishme mbi biodiversitetin që nuk shmangen

² Udhëzuesit më të mirë praktikë për të integruar biodiversitetin në vlerësimin e ndikimeve përfshijnë:

- ‘Udhëzues Vullnetar për Biodiversitetin-përfshirë dhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (i gjendur në vendimin e CBD VIII/28 nga COP8 në 2006)
- *Biodiversiteti në Vlerësimin e Ndikimeve* (IAIA Publikim Special Seria Nr. 3)
- Produkte të ndryshme të *Nisma e Energjisë dhe Biodiversitetit*

	dhe nuk minimizohen dot, atëherë klienti duhet të ndërmarrë masa për ti zbutur këto efekte.
4.Kompensojë	Kur mbeten efekte të rëndësishme mbi biodiversitetin, në vend të përpjekjeve për të shmangur, minimizuar dhe zbutur këto efekte, klienti duhet të identifikojë veprimet ose projektet për ti kompensuar ato. Të gjitha projektet e kompensimit duhet të strukturohen në marrëveshje me BERZH.

Mbrojtja dhe konservimi i habitateve

E përgjithshme

9. Të gjitha habitatet (qofshin të modifikuara, natyrale apo me vlerë kritike për konservimin) mbështesin tërësinë e organizmave të gjallë, të cilët ndryshojnë në bazë të dendësisë së llojeve, dominancës, ekosistemeve dhe vlerës së tyre ekonomike. Për këtë arsye, klienti duhet të tregojë kujdes jo vetëm për habitatet natyrore të paprekura, përfshirë ato që kanë një rëndësi kritike për konservimin, të cilat mund të preken nga projekti, por gjithashtu edhe për habitatet të cilat janë prekur ose degraduar nga aktiviteti njerëzor, dhe për habitatet e reja të krijuara nga njeriu si p.sh rezervaret dhe kullotat. Një proces i tillë vlerësimi (*due diligence*) duhet të përfshijë një vlerësim të masave të mundshme zbutëse, të cilat mund të aplikohen në zhvillimin e propozuar.
10. Masat zbutëse mund të përfshijnë shmangjen e territoreve të ndjeshëm ose punime me ndërprerje në kohë të ndjeshme (p.sh në sezonet e mbarështimit), transportimin e disa llojeve në territore alternative të përkohshme ose për një kohë më të gjatë, restaurimin dhe ri-kolonizimin e territorit në periudhën pas projektit dhe krijimin e habitateve të ngjashëm (për të kompensuar) ndikimet e mbetura. Individët dhe komunitetet që janë të prekur në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga humbja e biodiversitetit duhet të kompensohen në një mënyrë të përshtatshme, duke marrë në konsideratë edhe aspektet shoqërore dhe kulturore.

Habitatet e modifikuara

11. Habitatet e modifikuara janë ato ku ka ndodhur një modifikim i dukshëm i habitatit natyror, shpeshherë me vendosjen e llojeve të huaja bimore dhe shtazore, si p.sh zonat bujqësore. Kur habitatet e modifikuara ose ato të porsa krijuara mund të ndikohen nga projekti, klienti duhet të ketë si qëllim të minimizojë çdo degradim ose shndërrim të mëtejshëm të habitatit. Kur ato kanë vlerë konservimi, në varësi të natyrës dhe shkallës së projektit, klienti duhet të identifikojë mundësitë për të përmirësuar habitatet, për të mbrojtur dhe konservuar biodiversitetin ose për të nxitur menaxhimin e qëndrueshëm të hapësirës në fjalë. Kjo mund të përfshijë kullotjen, rritjen e bletëve, vëzhgimin e zogjve, etj.

Habitatet natyrore

12. Habitatet natyrore janë hapësira toke dhe uji ku komunitetet biologjike janë të përbëra në pjesën më të madhe të tyre nga lloje vendase bimore dhe shtazore, dhe ku aktiviteti njerëzor nuk ka modifikuar në mënyrë të ndjeshme funksionet ekologjike. Në zonat e habitative natyrore, nuk duhet të ketë degradim të ndjeshëm apo shndërrim të habitatit në atë masë sa (i) të kompromentohet integriteti ekologjik dhe funksionimi i ekosistemit

- nuk ekzistojnë alternativa të tjera teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme; dhe
- përfitimet e përgjithshme nga projekti nuk tejkalojnë kostot, duke përfshirë ato mbi mjedisin dhe biodiversitetin; dhe
- masa të përshtatshme zbutëse nuk janë vënë në zbatim për të parandaluar një humbje neto dhe për të siguruar mundësisht një fitim neto të vlerës së biodiversitetit në habitatin në fjalë, ose, aty ku është e përshtatshme, të një habitatit me një vlerë më të madhe konservuese.

Habitati kritike

13. Pavarësisht nëse është natyror apo i modifikuar, një habitat mund të konsiderohet me vlerë kritike për shkak të (i) vlerës së lartë të biodiversitetit të tij, (ii) rëndësisë së tij për mbijetesën e disa llojeve në rrezik, (iii) rëndësisë së tij për llojet dhe nën-llojet endemike ose gjeografikisht të kufizuara, (iv) rëndësisë së tij për llojet migruese ose ato që formojnë grupime, (v) rolit të tij në mbështetjen e llojeve që janë të lidhura me procese kyçe të evolucionit, (vi) rolit të tij në mbështetjen e biodiversitetit me rëndësi shoqërore, ekonomike ose kulturore për komunitetet vendase, ose (vii) rëndësisë së tij për llojet që janë jetësore për ekosistemin në tërësi (llojet kyçe).
14. Habitatit kritik nuk duhet të shndërrohet ose degradohet. Si rezultat, në hapësirat e habitatit kritik, klienti nuk duhet të zbatojë asnjë aktivitet për projektin nëse nuk plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - të jenë kryer të gjitha proceset e kërkuara nga detyrimet ndërkombëtare ose ligji i vendit, të cilat janë kushte paraprake për dhënien e miratimit nga shteti për realizimin e aktiviteteve të projektit brenda ose pranë një habitatit kritik.³
 - nuk ka ndikime negative të matshëm, ose nuk ekziston asnjë mundësi e ndodhjes së tyre, në habitatin kritik, që mund të shkatërrojë aftësinë e habitatit për të funksionuar sikundëse është paraqitur në paragrafin 13.
 - duke marrë një qëndrim parandalues, nuk parashikohet që projekti të çojë në zvogëlimin e ndonjë popullate të ndonjë lloji në rrezik (ose në rrezik kritik për zhdukje) ose në humbjen e ndonjë hapësire të habitatit në fjalë, duke kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemit përfaqësues mikpritës.
 - Pavarësisht nga sa më sipër, të gjitha efektet e tjera duhet të zbuten në përputhje me hierarkinë e masave zbutëse.

Zonat e mbrojtura

15. Zonat mund të shpallen të mbrojtura nga agjencitë qeveritare për një sërë synimesh, për të përmbushur detyrimet e vendit siç parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare. Brenda kritereve të përcaktuara, legjislacioni mund të lejojë zhvillimin brenda ose afër zonave të mbrojtura. Përveç kërkesave të zbatueshme të paragrafit 14 më sipër, klienti duhet të:
 - konsultohet me mbështetësit dhe administruesit e zones së mbrojtur, me komunitetet vendase dhe grupe të tjera të interesuara mbi projektin e propozuar në përputhje me Kërkesën e Performancës nr 10;

³Për shembull, shteteve mund t'u duhet të demonstrojnë se nuk ekzistojnë alternativa të tjera të realizueshme ose që projekti është në interes të vendit.

- tregojë se çdo zhvillim i propozuar në zona të tilla është i lejuar ligjërisht dhe që shteti mikpritës (dhe klienti, aty ku është e zbatueshme) ka kryer proceset e duhura për të marrë këtë leje dhe se zhvillimi ka ndjekur hierarkinë e masave zbutëse (shmangë, minimizojë, zbusë, kompensojë) në mënyrën e përshtatshme;
- zbatojë programe shtesë të përshtatshme për të nxitur dhe përmirësuar qëllimet e konservimit të zonës së mbrojtur.

Lloje të huaja pushtuese

16. Lëshimi aksidental ose i qëllimshëm i llojeve të huaja në habitatet vendase mund të ketë ndikime të rëndësishme negative mbi biodiversitetin.
 - klientët nuk duhet të lëshojnë me qëllim lloje të huaja ose jo-vendase në hapësirat ku ato nuk gjenden normalisht, përveç rastit kur ky veprim kryhet në përputhje me kuadrin rregullator për futjen e llojeve të huaja. Në asnjë rrethanë, nuk duhet të lëshohen në mjedise të reja lloje të cilat njihen se janë pushtuese.
 - Gjatë procesit të vlerësimit (*due diligence*), klientët duhet të vlerësojnë edhe probabilitetin e një transferimi apo lëshimi aksidental të llojeve të huaja (psh nëpërmjet analizës së riskut) dhe duhet të identifikojnë masat për të minimizuar këtë lëshim të mundshëm, nëse ai ndodh.
 - Për sa i përket transportit të mallrave dhe shërbimeve, Banka bazohet në *Marrëveshjen Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Administrimin e Ujit të fundit të anijes dhe Sedimenteve të saj*. Pritet që klientët të përmbushin detyrimet e tyre të përcaktuara në kontekstin e kësaj marrëveshje.

Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ)

17. Ekzistojnë një sërë direktivash të BE, të cilat trajtojnë lëshimin e qëllimshëm të OMGJ në mjedis (Direktiva e BE 2001/18/EC), hedhjen në treg të ushqimeve ose produkteve ushqimore që përmbajnë ose janë të përbëra nga OMGJ (Rregulli i BE 1829/2003), eksportimin e OMGJve ose transportin ndërkufitar jo të qëllimshëm të OMGJve, përdorimin e OMGJve për kërkime shkencore (Direktiva 98/81/EC), si dhe etiketimin (psh Rregulli 1829/2003, 1830/2003). Brenda Shteteve që bëjnë pjesë në BE dhe shteteve kandidat, klientëve u kërkohet që ti binden politikave dhe kërkesave të zbatueshme kombëtare dhe vendore. Pra, OMGJ nuk duhet të përdoren ose të lëshohen në mjedis pa pasur miratimin e dhënë nga autoritetet kompetente, përveç rastit kur autoriteti lokal në fjalë ka deklaruar lirinë e përdorimit të OMGJve. Në shtetet e tjera ku operon BERZH, klientët duhet të adoptojnë metodën parandaluese dhe të kryejnë një vlerësim të riskut në përputhje me kërkesat e BE dhe të kësaj Kërkese Performance. Banka gjithashtu do të konsiderojë këto elemente gjatë procesit të vlerësimit paraprak (*due diligence*).

Menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorim i burimeve jetësore

18. Klientët duhet të administrojnë burimet jetësore në mënyrë të qëndrueshme. Klientët të cilët kërkojnë financim për projekte të cilët përfshijnë përdorimin e burimeve jetësore, duhet të tregojnë një kujdes të veçantë në vlerësimin e qëndrueshmërisë së burimeve të përdorur, duke marrë parasysh rregullat e mëposhtme:
 - përdorimi i çdo burimi duhet të konsiderohet në përputhje me funksionet që ai kryen brenda ekosistemit. Për shembull, prerja e pyjeve mund të ketë efekte

- duhet ndjekur qasja parandaluese, dhe duhet të konsiderohen efektet e agregur dhe dhe ata shtues (kumulativë).
 - përdoruesit e burimeve jetësore duhet të kërkojnë minimizimin e humbjeve dhe të efekteve negative mjedisore dhe optimizimin e përfitimeve.
 - plantacionet ose fermat e prodhimit të llojeve ose popullatave të cilat nuk janë natyrale për një hapësirë të caktuar dhe nuk janë të testuara për sa i përket pushtueshmërisë së tyre, ose mbi dominimin mbi llojet vendase, duhet të kufizohen ose bëhen subjekt studimi dhe miratimi përpara përdorimit të tyre.
 - Nevojat dhe roli i mundshëm pozitiv në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemit, i komuniteteve indigjene dhe vendas që jetojnë brenda ose përreth hapësirës në zhvillim dhe që përdorin burimet jetësore, duhet të konsiderohen nga projekti.
19. Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e përdorimit të burimeve nga projekti, Banka mbështetet në *Rregullat dhe Udhëzuesit e Addis Ababa mbi Përdorimin e Qëndrueshëm të Biodiversitetit*, të cilat sigurojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të biodiversitetit⁴. Banka nxit projektet, qeveritë relative dhe agjenci të tjera përgjegjëse që që bëjnë pjesë të kostove të projektit edhe ato të menaxhimit të ekosistemit në mënyrë të qëndrueshme. Klientët në sektorët e pylltarisë dhe të peshkimit duhet të zbatojnë rregullat respektive të paraqitura më poshtë.

Pyjet natyrore dhe të kultivuar

20. Shndërrimi i tokës së prekur ose habitateve natyrore në pylltari duhet të jetë subjekt i një procesi vlerësimi të veçantë (*due diligence*) siç përshkruhet më sipër. Habitatet kritike nuk duhet të shndërrohen ose degradohen. Klientët në sektorin e pylltarisë duhet të sigurojnë se të gjitha pyjet natyrore dhe të kultivuar mbi të cilët kanë kontroll administrativ, janë të certifikuar nga rregullat të pranuar në nivel ndërkombëtar si p.sh ato të Këshillit të Administrimit të Pyjeve. Kur procesi i vlerësimit (*due diligence*) zbulon se praktika e administrimit të pyjeve nuk i plotëson këto standarte, atëherë klientët duhet të hartojnë një plan administrimi, i cili duhet të lejojë plotësimin e standarteve brenda një periudhe kohe të konsideruar si e arsyeshme nga Banka. Shfrytëzimi i produkteve pyjore duhet bërë në mënyrë të përshtatshme.

Peshkimi

21. Klientët që janë të përfshirë në shfrytëzimin e peshqve ose llojeve të tjera ujore duhet të jenë të aftë ti tregojnë Bankës se të gjitha aktivitetet e tyre (nga shfrytëzimi deri tek përpunimi) kryhen në mënyrë të qëndrueshme. Kjo mund të arrihet me realizimin e certifikimit të pavarur⁵ (aty ku ekziston një i tillë) ose nëpërmjet studimeve të kryera si pjesë e procesit të vlerësimit (*due diligence*). Aktivitetet e peshkimit nuk është e thënë që të kufizohen vetëm tek shfrytëzimi. Ri-popullimi ose futja i llojeve ose popullatave

⁴ Përdorimi ose menaxhimi i qëndrueshëm përkufizohet si shfrytëzimi i burimeve në një shkallë ose mënyrë e cila mundëson njerëzit dhe komunitetet të përmirësojnë mirëqënien ekzistuese shoqërore, kulturore dhe ekonomike, duke ruajtur ndërkohë potencialin e këtyre burimeve për të plotësuar nevojat e parashikuara të brezave të ardhshëm duke ruajtur kapacitetin jetësor të ekosistemeve të ajrit, ujit dhe tokës si dhe integritetin afatgjatë të habitateve kritike.

⁵ Si p.sh *Rregullat dhe Kriteret për Peshkimin e Qëndrueshëm* të Këshillit për Administrimin e Marinës

të ndryshme (sidomos në mjedisë të mbyllura siç janë liqenet) duhet të garantojë se këto popullata të reja nuk dëmtojnë ose zëvendësojnë llojet ekzistuese të peshqve.

Zinxhiri i furnizimit

22. Kur projekti përdor furnizues të jashtëm të burimeve jetësore (këtej e tutje: “burime”) mbi të cilat klienti nuk ka kontroll administrimi dhe këto burime janë kryesore për funksionet thelbësore të projektit, klienti duhet të adoptojë dhe zbatojë një politikë sigurimi, procedura dhe plane veprimi për qëndrueshmërinë e burimeve, në mënyrë që të sigurojë se:

- janë blerë vetëm burime të ligjshme dhe me një origjinë të njohur;
- monitorohet origjina e burimeve;
- burimet nuk e kanë origjinën prej zonave të mbrojtura ose prej zonave që janë përcaktuar me vlera të larta ekologjike, dhe që biodiversiteti dhe funksionet e ekosistemeve të ndikuar janë ruajtur në përputhje me rregullat e pranuar ndërkombëtare dhe kombëtare.

Klientët duhet ti japin preferencë blerjes së burimeve të çertifikuara me rregullat ndërkombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm, kur këto janë të disponueshme.

Biodiversiteti dhe turizmi

23. Vlerësimet e ndikimit në mjedis dhe shoqëri të aktiviteteve turistike të reja ose ato të zgjeruara, dhe të infrastrukturës turistike duhet të jenë në përputhje me *Udhëzuesin mbi Biodiversitetin dhe Zhvillimin e Turizmit*⁶. Ai paraqet natyrën e informacionit bazë të duhur, problemet të cilat duhet të merren në konsideratë, si dhe natyrën e zbutjes së ndikimit, monitorimin dhe raportimin e përshtatshëm që duhet të përfshihet në planin e veprimit për projektin.

⁶ Gjenden në Vendimet e COP 7 të CBD dhe të disponueshme në faqen e internetit të BERZH.

KP 7: Popullsia Vendase

Hyrje

1. Projektet e sektorit privat mund të krijojnë mundësi për Popullësitë Vendase të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga aktivitetet e lidhura me projektin, të cilat mund ti ndihmojnë të përmbushin aspiratat e tyre për zhvillim ekonomik dhe social. Kjo Kërkesë Performance (“KP”) konstaton se Popullësitë Vendase mund të luajnë rol në procesin e tranzicionit drejt ekonomisë së tregjeve të hapura, duke nxitur dhe administruar aktivitete dhe sipërmarrje si partnerë në zhvillim, së bashku me sektorin privat dhe me përfaqësuesit e tyre qeveritarë.
2. *Një Ortakëri.* Kjo KP i njeh Popullësitë Vendase si partner, duke i respektuar ata si njerëz dhe si kombe, vlerat e të cilëve mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të tyre dhe të kombit. Megjithatë, kjo KP njeh se Popullësitë Vendase, si grupe sociale që kanë identitete të ndryshme nga grupet dominante në shoqëritë e vendit, janë segmentet e popullësisë më të prekshme dhe lënë jashtë vëmendjes. Statusi i tyre ekonomik, shoqëror dhe ligjor shpeshherë e kufizon kapacitetin e tyre për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre mbi tokat, burimet natyrore dhe kulturore, dhe mund të kufizojë edhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë dhe përfituar nga zhvillimi. Ata janë veçanërisht të cënuar nëse tokat dhe burimet e tyre transformohen, pushtohen nga njerëz që s’janë pjesëtarë të komunitetit, ose degradohen në mënyrë të dukshme.
3. *Nevoja për Masa të Veçanta.* Kjo KP njeh se identitetet, kulturat, tokat dhe burimet e Popullësive Vendase janë të ndërthurura në mënyrë unike dhe janë tepër të cënueshme nga ndryshimet e shkaktuara prej disa lloje investimesh dhe si rezultat mund të kërcënohen edhe gjuha, kulturat, fetë, besimet shpirtërore dhe institucionet e tyre. Këto karakteristika i ekspozojnë Popullësitë Vendase në rreziqeve të ndryshme dhe ndaj pasoja të rënda, përfshirë humbjen e identitetit, kulturës, dhe mjeteve të jetës të bazuara në burimet, e për rrjedhojë varfërimin të mëtejshëm dhe sëmundjeve. Njihet se rolet e burrave dhe grave në kulturat vendase janë shpeshherë të ndryshme nga ato në grupet dominante. Shpeshherë, edhe si rezultat i zhvillimeve të jashtme, gratë dhe fëmijët e tyre janë të dobët brenda komuniteteve të tyre. Për shkak të këtyre fakteve, problemet e lidhura me Popullësitë Vendase janë shpeshherë të ndërlikuara. Ndaj duhen masa të veçanta për të siguruar se burrat dhe gratë vendase nuk mbeten në disavantazh, por përfshihen dhe përfitojnë nga projektet e mbështetura nga Banka në mënyrën e përshtatshme.
4. *Nevoja për pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar.* Kjo KP vlerëson parimin për të drejtat e Popullësive Vendase¹, të paraqitur në Deklaratën e OKB, se duhet pëlqimi paraprak dhe i informuar i Popullësive Vendase të ndikuar nga aktivitetet e projektit dhe që përshkruhen në paragrafët 31-37 më poshtë, duke marrë në konsideratë cënueshmërinë e veçantë të Popullësive Vendase nga ndikimet negative të projekteve të tilla.
5. *Vendet ku vepron BERZH:* Kjo KP vlerëson se rrethanat e Popullësitë Vendase në vendet ku vepron BERZH janë unike për shkak të historisë së tyre të veçantë. Popullësitë Vendase nuk janë më të lidhur vetëm me mjetet e tyre zakonshme të jetesës, sikundërse edhe identiteti i tyre nuk varet as prej ofrimit të këtyre mjeteve dhe stileve të

¹ Deklarata e OKB për të drejtat e Popullësive Vendase e miratuar në 13 Shtator 2007

jetesës tradicionale. Për më tepër, njihet se Popullësitë Vendase shpeshherë jetojnë në vendbanime ku ka një numër kombësisht. Ekzistenca e vazhdueshme e nomadizmit ose transhumancës dhe historiku i ri-strehimeve të pavullnetshme tregojnë se nevoja për të patur lidhje të përheshme me territore të caktuara, nuk është gjithmonë e përshtatshme.

Objektivat

6. Objektivat e veçanta janë si më poshtë:

- të sigurojë se procesi i tranzicionit nxit respektimin e plotë për dinjitetin, të drejtat, aspiratat, kulturat dhe mjetet të jetesës të bazuara në burime, të Popullësive Vendase;
- të shmangë ndikimet negative të projekteve mbi jetën dhe mjetet e jetesës së komuniteteve të Popullësive Vendase; kur shmangja nuk është e mundur, të minimizojë, zbusë ose kompensojë për këto efekte;
- të mundësojë që Popullësitë Vendase të përfitojnë nga projektet një mënyrë të përshtatshme duke respektuar edhe aspektet kulturore;
- të mbështesë klientin që të vendosë dhe ruajë lidhje të vazhdueshme me Popullësitë Vendase të prekur nga projekti, gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të projektit;
- të nxisë negociata mirëbesuese midis klientit dhe Popullësive Vendase, si dhe pjesëmarrjen e mirë-informuar të këtyre të fundit, kur projektet vendosen mbi tokat e përdorura tradicionalisht nga Popullësitë Vendase, kur mjetet tradicionale ose jo të jetesës ndikohen nga projekti, ose në rastin e shfrytëzimit tregtar të burimeve kulturore të Popullësive Vendase;
- të njohë dhe të respektojë ligjet dhe zakonet tradicionale të Popullësive Vendase dhe të marrë ato në konsideratë të plotë;
- të respektojë dhe të ruajë kulturën, njohuritë dhe praktikën e Popullësive Vendase në përputhje me dëshirat e tyre.

Kuadri i zbatimit

7. Kjo Kërkesë Performance duhet të zbatohet kur ekziston mundësia që një projekt të ndikojë mbi Popullësitë Vendase
8. Zbatueshmëria e kësaj Kërkesë Performance duhet të përcaktohet nga Banka gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social në përputhje me kriteret e paraqitura në paragrafet 9-12 më poshtë. Zbatimi i veprimeve të duhura për të përmbushur këto kërkesa duhet të administrohet në përputhje me këtë Kërkesë Performance dhe me ato nr 1, 5, 8 dhe 10 në mënyrën e përshtatshme.
9. Nuk ekziston asnjë përkufizim për “Popullësitë Vendase” i pranuar universalisht. Në shtete të ndryshme mund të përdoren terma të ndryshëm për t’ju referuar Popullësive Vendase.
10. Në Politikë e Bankës dhe në këtë Kërkesë Performance, termi “Popullësi Vendase” përdoret në kuptimin teknik për t’ju referuar një grupi minoritar shoqëror dhe kulturor, i cili dallon nga grupet dominante brenda shoqërive kombëtare, duke zotëruar karakteristikat e mëposhtme në përmasa të ndryshme:
 - identifikim i vetvetes si pjesëtar i një grupi të veçantë vendas etnik ose kulturor dhe njohja e këtij identiteti nga të tjerët;

- zënie kolektive e habitateve të dallueshme gjeografikisht, në toka tradicionale ose në territore të trashëguara brenda hapësirën së projektit dhe përdor burimet natyrore që ndodhen në këto habitate dhe territore ²;
 - prejardhje nga popullata të cilat tradicionalisht nuk janë mbështetur në strategji për ekzistencë të bazuara mbi pagën³ (shpeshherë kanë qenë nomadë); statusi i të cilëve rregullohej nga zakonet ose traditat e veta ose nga ligje/rregulla të veçanta;
 - institucione zakonore kulturore, ekonomike, sociale ose politike të cilat janë të ndara nga ato të shoqërisë ose kulturës dominante;
 - gjuhë ose dialekt të dallueshëm, shpeshherë të ndryshëm nga gjuha zyrtare e shtetit ose krahinës.
11. Fakti që një grup, ose pjesëtarët e një grupi, kanë mënyrë jetese nomade ose transhumante, jetojnë në komunitete mikse ose urbane dhe/ose vizitojnë tokat e tyre tradicionale në një bazë sezonale, dhe që kanë përjetuar ndarje të detyruar, nuk përbën pengesë për zbatimin e kësaj Kërkese Performance.
12. Gjatë procesit të sigurimit nëse një grup konsiderohet ose jo Popullësi Vendase për hir të kësaj Kërkese Performance, Banka mund të kërkojë këshilla nga ekspertët.

Kërkesat

13. Në projektet ku Popullësitë Vendase mund të ndikohen⁴, klientit i kërkohet të bëjë një vlerësim (shih më poshtë) të ndikimeve mbi Popullësinë Vendase. Në varësi të rezultatit të nxjerrë, klienti duhet fillimisht të shmangë efektet negative dhe kur kjo nuk është e mundur, ai duhet të përgatisë një Plan Zhvillimi të Popullësisë Vendase (paragrafi 21 më poshtë) në mënyrë që të minimizojë dhe/ose zbusë çdo efekt negativ të mundshëm dhe të identifikojë përfitimet. Pritet gjithashtu që klienti të angazhohet në konsultime dhe pjesëmarrje të mirë-informuar me komunitetet vendase të prekura, të zbatojë një mekanizëm të caktuar për ankesat si dhe të identifikojë dhe të përcaktojë mënyra të përshtatshme për kompensimin dhe ndarjen e përfitimeve.
14. Kur klienti mund të ketë filluar aktivitete të projektit, të cilat mund të kenë prekur dhe/ose mund të prekin Popullësitë Vendase, përpara përfshirjes së Bankës, duhet të tregohet kujdes i veçantë për të identifikuar a) boshllëqet e mundshme dhe b) veprimet korrigjuese që mund të nevojiten për të siguruar përputhjen me këtë Kërkesë Performance. Gjithashtu, duhet të bihet dakord për një plan veprimi.
15. Kur brenda në organizatën e klientit nuk ka burime të disponueshme, duhet të kërkohen këshillat e specialistëve të pavarur dhe të specializuar gjatë procesit të zhvillimit dhe zbatimit të Projektit.

² Një grup që ka humbur “lidhjen kolektive me një habitat të dallueshëm gjeografikisht ose me territore të trashëguara në hapësirën e projektit” për shkak të një ndarje të detyruar, mbetet i pranueshëm për tu mbuluar nga kjo Kërkesë Performance, nëse pritët që të ndikohet nga projekti. “Ndarje e Detyruar” i referohet humbjes së lidhjes kolektive me habitate të dallueshëm gjeografikisht ose me territore të trashëguara, e cila ndodh gjatë jetës së pjesëtarëve të grupit në fjalë për shkak të një konflikti, të programeve qeveritare për strehim, të shpronësimeve nga tokat e tyre, të fatkeqësive natyrore, ose të përfshirjes së territoreve të tilla në hapësira urbane. Për qëllimet e kësaj Kërkese Performance, “hapësirë urbane” normalisht nënkupton një qytet ose një qytezë të madhe, dhe merr në konsideratë të gjitha karakteristikat e mëposhtme, nga të cilat asnjëra nuk është përcaktuese: ^(a) emërtimi ligjor i hapësirës si urbane nga ligji i vendit; ^(b) densiteti i madh i popullsisë dhe ^(c) përqëndrimi i madh i aktiviteteve ekonomike jo bujqësore të lidhura me aktivitetet bujqësore.

³ Kjo zbatohet edhe kur grupi nuk ekziston, sikundërse paraqitet në shënimin e mëparshëm

⁴ Projekte që ndikojnë mbi Popullësitë Vendase janë ato të cilat çënojnë gjendjen ekonomike-sociale dhe/ose kulturën tradicionale e mënyrën e jetesës

Vlerësimi

16. Kur ka kërkesa ligjore të vendit për lloje të caktuara vlerësimi social, klienti duhet ta bëjë atë, të ndajë vlerësimin me BERZH, dhe të kryejë çdo lloj vlerësimi social shtesë të kërkuar nga Banka.
17. Në rastet kur projekti nuk ka filluar ende, klienti duhet të identifikojë nëpërmjet një procesi vlerësimi social, të gjitha komunitetet e Popullësive Vendase që mund të ndikohen, pozitivisht ose negativisht, nga projekti dhe brenda hapësirës së ndikimit të projektit, natyrën dhe masën e efekteve të pritura sociale, kulturore (përfshirë trashëgiminë kulturore), dhe mjedisore, dhe masat e planifikuara për të (i) shmangur ose zbutur efektet negative dhe (ii) ndarë çdo përfitim të lidhur me projektin.
18. Në rastet kur ndërtimet, aktivitetet ose operacionet e lidhura me projektin e propozuar kanë filluar, klienti duhet ti paraqesë Bankës dokumenta dhe informacione (përfshirë ato që kanë të bëjnë me performancën e kompanisë në të shkuarën) si dhe dokumentat e paraqitura më parë tek autoritetet, të cilat tregojnë se ai ka vepruar në bazë të mendimeve të Popullësive Vendase që janë ndikuar nga projekti, dhe që ka ndjekur, në masën e mundur, procesin e paraqitur në këtë Kërkesë Performance.
19. Nëse kërkesat e paragrafit 18 janë përmbushur, Banka do të kërkojë që klienti të vendosë një objektiv dhe ndërmarrë një studim të pavarur të efekteve të projektit mbi Popujt Vendas dhe të pikëpamjeve të tyre lidhur me projektin. Ky studim, i cili duhet të zhvillohet në mënyrën e duhur duke respektuar aspektet kulturore, duhet të rishikojë efektet e deritanishme mbi jetën dhe mjetet e jetesës së Popullësive Vendase, përpjekjet e klientit për të zbutur efektet negative dhe për të identifikuar dhe ndarë përfitimet e projektit, si dhe nivelin e pjesëmarrjes së Popullësive Vendase në planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Shmangja e efekteve negative

20. Të gjitha përpjekjet duhet fillimisht të drejtohen drejt shmangjes së çdo efekti negativ të projektit mbi Popullësitë Vendase. Kur shmangja e efekteve negative nuk është e realizueshme, klienti duhet të minimizojë, zbusë ose kompensojë për këto efekte në një mënyrë të përshtatshme dhe të drejtë.

Përgatitja e një Plani Zhvillimi për Popullësi Vendase (PZhPV)

21. Veprimet e propozuara të klientit për të minimizuar, zbutur dhe kompensuar efektet negative dhe për të identifikuar e ndarë përfitimet duhet të zhvillohen me pjesëmarrjen e mirë-informuar të Popullësive Vendase të prekura. Ato duhet të përfshihen në një plan me kufij kohor të qartë, siç është Plani i Zhvillimit të Popullësive Vendase (PZhPV), ose një plan më të gjerë zhvillimi të komunitetit me komponente të ndarë për Popullësitë Vendase. Klienti duhet të mbajë studiues të kualifikuar dhe ekspertizë teknike për të përgatitur këtë Plan.

Niveli i hollësive dhe shtrirja e një PZhPV duhet të variojë në përputhje me projektin specifik, dhe me natyrën e shtrirjen e aktiviteteve të projektit. Në përgjithësi një PZhPV duhet të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

Seksion I- Përmbledhje e Vlerësimit Social

- Informacioni Bazë

- Konkluzionet kyçe: analiza e efekteve, risqeve dhe mundësive
- Seksion II-Konsultimi dhe Pjesëmarrja*

- Rezultati i konsultimeve dhe plani për përfshirjen në të ardhmen

Plani i zbatimit

- Masa për të shmangur, minimizuar dhe zbutur efektet negative dhe për të përmirësuar efektet pozitive.
- Masa për të siguruar vazhdueshmërinë e komunitetit bazuar në menaxhimin e burimeve natyrore
- Masa për të ndarë përfitimet dhe/ose mundësitë e zhvillimit
- Mekanizmi i ankesave
- Kostot, buxheti, programi dhe përgjegjësitë organizative
- Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi.

Dhënia e informacionit, konsultimi kuptimplotë dhe pjesëmarrje e mirëinformuar

22. Klienti duhet të vendosë një lidhje të vazhdueshme me komunitetet e prekura të Popullësive Vendase sa më shpejt të jetë e mundur gjatë procesit të planifikimit të projektit dhe gjatë gjithë projektit. Proçesi i përfshirjes duhet të sigurojë konsultimin e tyre kuptimplotë në mënyrë që të lehtësojë pjesëmarrjen e tyre të mirë-informuar mbi çështjet që ndikojnë në mënyrë direkte mbi ta, mbi masat zbutëse të propozuara, mbi ndarjen e përfitimeve dhe mundësive të zhvillimit, dhe mbi çështjet e zbatimit.
23. Klienti duhet të garantojë që Popullësitë Vendase të ndikuara nga projekti janë të informuar siç duhet, në mënyrën e duhur për nga aspektet kulturore, mbi Kërkesat e Performancës së BERZH dhe mbi planet e projektit që ndikon mbi ta.
24. Proçesi i përfshirjes të komunitetit duhet të jetë i përshtatshëm nga ana kulturore, duhet të respektojë procesin e vendimmarrjes kolektive të Popullësive Vendase, dhe duhet të jetë konform me risqet dhe efektet e mundshme mbi Popullësitë Vendase. I takon klientit t'i tregoj BERZH se ky proçes është kryer në mënyrën e duhur.
25. Në veçanti, proçesi i përfshirjes duhet të përfshijë çështjet e mëposhtme:
 - përfshirjen e organizmave përfaqësues të Popullësive Vendase (për shembull, ndër të tjera, këshilli i të moshuarve ose këshilli i fshatit.), organizatat të Popullësive Vendase si dhe njerëzit vendas që preken në mënyrë individuale;
 - mirëkuptim dhe respekt për ligjet tradicionale respektive;
 - vënien në dispozicion të një kohe të mjaftueshme për procesin e vendimmarrjes kolektive të Popullësive Vendase;
 - lehtësira për Popullësitë Vendase që të shprehin pikëpamjet e tyre, shqetësimet dhe propozimet në gjuhën që zgjedhin ata, dhe pa asnjë manipulim të jashtëm, ndërhyrje ose kërcënim dhe në mënyrë të përshtatshme në aspektin kulturor;
 - paraqitja për Popullësitë Vendase e të gjitha planeve dhe informacioneve që kanë të bëjnë me efekte të mundshme sociale dhe ekologjike që mund të ndikojnë mbi komunitetet vendas, në mënyrën dhe gjuhën e përshtatshme sipas aspektit kulturor, dhe pa zhargon;
 - njohje e heterogjenitetit të komunitetit, duke marrë parasysh si vijon më poshtë:
 - Popullësitë Vendase jetojnë në komunitete mikse me Popullësi jo-Vendase;
 - komunitetet vendas janë të shumëllojshmëm; konsultimet dhe pjesëmarrja duhet të përfshijnë grupet gjinore, brezat e ndryshëm dhe grupet e përjashtuar;
 - dhënia e informacionit të duhur tek BERZH, dhe përfshirjen e Bankës në procesin e konsultimit, aty ku është mundur;

- dokumentacion i plotë⁵ i procesit të konsultimit.

Mekanizmi i ankesave dhe parandalimi i diskriminimit të bazuar në prejardhjen etnike

26. Klienti duhet të sigurojë se mekanizmi i ankesave që është ngritur për projektin, siç përshkruhet në Kërkesën e Performancës 10, është i përshtatshëm nga aspekti kulturor dhe i arritshëm nga Popullësitë Vendase; kjo mund të çojë në më pak besim në procedurat e shkruara dhe më shumë përdorim të stacioneve të raportimit gojor.
27. Banka nuk do të financojë projekte ku klienti i përjashton Popullësitë Vendase në bazë të prejardhjes etnike. Në projektet e financuara nga Banka ku ekzistojnë faktorë të nënkuptuar të cilët përjashtojnë Popullësitë Vendase dhe individët nga përfitimet e projektit, siç janë mundësitë e punësimit, për shkak të prejardhjes etnike, aktivitetet e projektit duhet të përfshijnë masa korrigjuese si: (i) informim i organizatave të Popullësive Vendase dhe individëve, mbi të drejtat e tyre në legjislacionin e punës, social, financiar dhe të biznesit, si dhe mbi mekanizmat në dispozicion për mbështetje ; (ii) përhapje e duhur dhe efektive e informacionit, trajnim dhe masa për të eliminuar pengesat drejt përfitimeve dhe burimeve siç janë kreditimi, punësimi, shërbimet e biznesit, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet e edukimit, e të tjera përfitime të lindura ose të lehtësuara nga projektet; dhe (iii) dhënie e një shkalle të njëjtë mbrojtje për punëtorët vendas, sipërmarrësit dhe ata që kanë përfitime, sipas legjislacionit kombëtar sikundërse për individët e tjerë në sektorët dhe kategoritë e ngjashme, duke marrë parasysh çështjet e gjinisë dhe segmentimin etnik në tregjet e mallrave e të punës, dhe faktorët gjuhësorë.

Kompensimi dhe ndarja e përfitimeve

28. Metoda pjesëmarrjese duhet të jetë baza për përcaktimin e masave zbutëse, ndarjen e përfitimeve dhe masat e tjera mbështetëse për jetën. Banka do të kërkojë që klienti të kompensojë Popullësitë Vendase në mënyrë direkte për humbjet e mjeteve të jetesës (siç janë përlllogaritur në përputhje me këtë Kërkesë Performance) që rezultojnë nga aktivitetet e lidhura me projektin dhe të rikthejë çdo sipërfaqe toke të përdorur në gjendjen e saj të mëparshme. Pranueshmëria për kompensim mund të jetë në bazë individuale ose kolektive, ose një kombinim i të dyjave. Kompensimi duhet të bëhet për efektet negative mbi mjetet e jetesës dhe për ndikimet negative mbi pagë ose mbi nismat ekonomike me qëllim fitimi. Natyra e “mjeteve të jetesës” duhet të interpretohet në mënyrë elastike (në mënyrë që të përfshijë adaptime bashkëkohore siç janë etnoturizmi dhe përpunimi i ushqimit). Kur të përlllogaritet kompensimi, klientët duhet të marrin në konsideratë efektet negative sociale të projektit mbi jetën tradicionale dhe familjet të Popullësive Vendase. Kjo përlllogaritje duhet të bëhet në bashkëpunim me përfaqësuesit e Popullësive Vendase dhe ekspertët. Masat e këtij paragrafi zbatohen edhe në rastet kur klienti duhet të paguajë kompensim në organizmat e qeverisë vendore ose rajonale.
29. Mënyrat e pranueshme dhe ligjërish të realizueshme për kompensimin dhe zbatimin e PZhPV duhet të diskutohen gjatë konsultimeve me Popullësitë Vendase. Bazuar në këto konsultime, duhet të zhvillohet dhe të bihet dakord për mekanizmin e transferimit të kompensimit dhe/ose të burimeve. Nëse është e nevojshme, klienti duhet të ofrojë ndihmë/mbështetje në mënyrë që të mundësojë ngritjen e sistemeve të përshtatshme për administrimin dhe qeverisjen.

⁵ Këto mund të përfshijnë kopje të shkruara dhe disqe dhe/ose regjistrime audio

30. Nëpërmjet procesit të konsultimit kuptimplotë me komunitetet e prekura të Popullësive Vendase⁶ si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes së mirë-informuar të këtyre të fundit, klienti duhet të ofrojë mundësi për përfitime zhvillimi që janë të përshtatshme nga pikëpamja kulturore. Këto mundësi duhet të jenë proporcionale me masën e efekteve të projektit, me qëllim që të përmirësojnë standartin e tyre të jetesës dhe mjetet e jetesës në një mënyrë të përshtatshme dhe të nxisin qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve natyrore nga të cilat mund të varen. Klienti duhet të dokumentojë përfitimet e identifikuara nga zhvillimi, të cilat janë në përputhje me kushtet e kësaj Kërkese Performance, dhe do t'i paraqisë ato në kohë. Një mbështetje e veçantë duhet tu jepet aktiviteteve të përditshme për jetesë, që përfshijnë aktivitetet tradicionale ekonomike dhe derivatet e tyre moderne siç janë anijet dhe etno-turizmi.

Kërkesa të veçanta

31. Meqënëse Popullësitë Vendase mund të jenë veçanërisht të cënuara në rrethanat e projektit që përshkruhen më poshtë, përveç Kërkesave të Përgjithshme më sipër, duhet të zbatohen edhe kërkesat e veçanta në vijim. Këto kërkesa kanë të përbashkët nevojën e klientit për të:

- hyrë në negociata mirëbesimi me Popullësitë Vendase;
- siguruar pjesëmarrjen e informuar të Popullësive Vendase; dhe
- fituar miratimin e lirë, paraprak dhe të informuar të Popullësive Vendase përpara se të fillojë njëri prej aktiviteteve të përshkruara më poshtë.

Në rastin e ndonjëres prej rrethanave të mëposhtme, klienti duhet të mbajë studiues social të kualifikuar dhe të pavarur që të ndihmojnë për të kryer dhe dokumentuar aktivitetet e përshkruara në paragrafët 32-37.

Efektet mbi tokat tradicionale ose ato në përdorim

32. Popullësitë Vendase janë shpeshherë të lidhur ngushtë me tokat e tyre të trashëguara, me pyjet, ujin, kafshët e egra, dhe me burimet e tjera natyrore, ndaj duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë kur projekti ndikon mbi këto lidhje. Edhe pse këto toka mund të mos jenë nën zotërimin ligjor sipas ligjit të vendit, përdorimi i këtyre tokave, përfshirë përdorimin sezonal ose ciklik, nga komunitetet e Popullësive Vendase për jetesën e tyre ose për qëllime kulturore, ceremoniale ose shpirtërore që përcaktojnë identitetin dhe komunitetin e tyre, mundet shpeshherë të provohet dhe dokumentohet.

33. Nëse klienti propozon të vendosë projektin ose të prodhojë burime natyrore për qëllime tregëtimi, brenda tokave në përdorim, dhe nëse priten efekte negative⁷ mbi mjetet e jetesës, ose mbi përdorimin për arsye kulturore, ceremoniale, ose shpirtërore që përcaktojnë identitetin dhe komunitetin e Popullësive Vendase, klienti duhet të respektojë përdorimin e tyre si më poshtë:

- Klienti duhet të hyjë në negociata mirëbesimi me komunitetet e prekura të Popullësive Vendase, dhe duhet të dokumentojë pjesëmarrjen e tyre të informuar si dhe miratimin e tyre, si rezultat i negociatave.
- Klienti duhet të dokumentojë përpjekjet e tij për të shmangur ose të paktën për të minimizuar madhësinë e tokës së përdorur të propozuar për projektin, zënë dhe/ose zotëruar nga Popullësitë Vendase.

⁶ Sic përshkruhet në sesionet 22-25

⁷ Konsensusi i referohet procesit të përfshirjes në projekt të komuniteteve të Popullësive Vendase për të arritur një vendim, në përputhje me traditat, zakonet dhe praktikatat e tyre,

- Përdorimi i tokës së Popullësive Vendase duhet të dokumentohet nga ekspertët në bashkëpunim me komunitetet e prekura të Popullësive Vendase pa çënuar pretendimet për tokën të Popullësive të tjerë Vendase.
 - Komunitetet e prekura të Popullësive Vendase duhet të informohen mbi të drejtat e tyre në lidhje me këto toka sipas ligjit të vendit, duke përfshirë çdo ligj kombëtar i cili njih të drejtat ose përdorimin.
 - Klienti duhet tu ofrojë komuniteteve të prekura të Popullësive Vendase kompensim minimal dhe procesim të rregullt për të gjithë ata që kanë tituj të rregullt ligjor mbi pronësinë e tokës në rastin e zhvillimit tregtar të tokës së tyre sipas ligjit të vendit, si dhe mundësi zhvillimi të përshtatshëm në aspektin kulturor; kompensim i bazuar në tokë ose kompensim në natyrë duhet të ofrohet në vend të kompensimit me para në dorë, aty ku është e mundur.
 - Klienti duhet tu ofrojë kohë të mjaftueshme komuniteteve vendase të prekura që të arrijnë një marrëveshje të brendshme, pa imponuar dëshirat e tij në mënyrë direkte ose indirekte.
 - Klienti mund të përdorë funksione siç janë Avokati i Popullit dhe/ose të tjera institucione të tilla publike brenda sistemit kombëtar respektiv, në mënyrë që të lehtësojë miratimin e komunitetit për projektin, përdorimin e tokës të propozuar nga klienti dhe paketën e masave zbutëse.
34. Gjatë zbatimit të projektit, klienti duhet të sjellë menjëherë në vëmendjen e BERZH çdo konflikt ndërmjet Popullësive Vendase dhe çdo klienti, i mbetur i pakënaqur edhe pas përdorimit të mekanizmit të ankesave të projektit. Banka duhet të vlerësojë situatën dhe do të vendosë mbi metodën e përshtatshme për të zgjidhur çështjen.

Rivendosja e Popullësive Vendase nga tokat tradicionale ose në përdorim

35. Klienti duhet të eksplorojë projekte alternative të realizueshme për projektin, në mënyrë që të shmangë rivendosjen e Popullësive Vendase nga tokat tradicionale ose të përdorura prej tyre në mënyrë të përbashkët. Kur rivendosja është e pashmangshme, klienti nuk duhet të kryejë rivendosjen pa marrë miratimin e lirë, paraprak dhe të informuar të komuniteteve të Popullësive Vendase të prekura, si rezultat i negociatave. Këto negociata duhet të marrin në konsideratë ligjet e Popullësive Vendase, traditat, zakonet dhe zotërimin e tokës dhe duhet të përfshijnë pjesëmarrjen e plotë të tyre. Çdo rivendosje e Popullësive Vendase duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Planifikimit dhe Zbatimit të Strehimit të përcaktuara në Kërkesën e Performancës 5. Popullësitë Vendase duhet të marrin një kompensim të drejtë dhe të barabartë për tokat, territoret dhe burimet që kanë zotëruar tradicionalisht, që kanë zënë ose kanë përdorur, të cilat janë konfiskuar, marrë, zënë, përdorur ose dëmtuar si rezultat i projektit pa marrë miratimin e tyre të lirë, paraprak dhe të informuar.
36. Kur është e mundur, Popullësitë Vendase të rivendosur duhet të kenë mundësinë për tu kthyer në tokat e tyre tradicionale ose në përdorim, nëse arsyeja e rivendosjes së tyre nuk ekziston më, dhe toka duhet të kthehet plotësisht në gjendjen e mëparshme.

Burimet kulturore

37. Kur një projekt propozon përdorimin e burimeve kulturore, njohurive, risive, ose praktikave të Popullësive Vendase për qëllime tregtare, klienti duhet të informojë Popullësitë Vendase për: (i) të drejtat e tyre sipas ligjit të vendit; (ii) shtrirjen dhe natyrën e zhvillimit tregtar të propozuar; dhe (iii) pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë. Klienti nuk duhet të vijojë me një komercializim të tillë nëse: (i) nuk hyn në negociata mirëbesimi me komunitetet e prekura të Popullësive Vendase; (ii) nuk dokumenton pjesëmarrjen e informuar të këtyre të fundit dhe miratimin e lirë, paraprak,

KP 8: Trashëgimia kulturore

Hyrje

1. BERZH njih rëndësinë e trashëgimisë kulturore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Në përputhje me Marrëveshjen në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore në Botë, si dhe me Marrëveshjen për Mbrojtjen e Trashëgimisë së Paprekshme, kjo Kërkesë Performance ka si synim të mbrojë trashëgiminë kulturore të pazëvendësueshme dhe të udhëzojë klientët të shmangin ose të zbusin efektet negative mbi trashëgiminë kulturore gjatë punimeve të biznesit të tyre. Për më tepër, kërkesat e kësaj Kërkesë Performance që janë të lidhura me përdorimin nga projekti të trashëgimisë kulturore, janë të bazuara pjesërisht në standartet e vendosura nga Marrëveshja mbi Shumëllojshmërinë Biologjike. Banka mbështet metodën parandaluese për menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore në përputhje me Deklaratën Rio.
2. Trashëgimia kulturore është e rëndësishme si një burim informacioni të çmuar historik dhe shkencor, si një pasuri për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, dhe si një pjesë e plotë e identitetit kulturor, praktikave, dhe vazhdimësisë së njerëzve.
3. Në ndjekjen e këtyre synimeve për mbrojtje dhe konservim, Banka udhëhiqet dhe mbështet zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme dhe të instrumentave të tjerë¹. BERZH gjithashtu njih nevojën që të gjithë pjesëmarrësit të respektojnë ligjet dhe rregullat që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në hapësirën e ndikimit të një projekti, si dhe detyrimet e vendit ku zhvillohen punimet konform traktateve dhe marrëveshjeve të përshtatshme ndërkombëtare. Këto ligje mund të jenë trashëgimi kulturore ose ligje të antikitetit, ligje miratuese për planifikim ose ndërtim, rregulla për hapësirat e konservuara ose në mbrojtje, si dhe ligje dhe rregulla të tjera që drejtojnë mjedisin e ndërtuar historik, ose ligje që janë të lidhur me mbrojtjen e Popullësive Vendase.

Objektivat

4. Objektivat e kësaj Kërkesë Performance (“KP”) janë:
 1. të mbështesë konservimin e trashëgimisë kulturore në kontekstin e projekteve të financuar nga BERZH;
 2. të mbrojë trashëgiminë kulturore nga efektet negative të aktiviteteve të projekteve;
 3. të përkrahë ndarjen e drejtë të përfitimeve nga përdorimi i trashëgimisë kulturore në aktivitetet e biznesit;
 4. të përkrahë vlerësimin e trashëgimisë kulturore dhe të qenit të informuar mbi të, aty ku është e mundur.
5. Kjo Kërkesë Performance vendos një kuadër veprimi në mënyrë që klientët të mbrojnë trashëgiminë kulturore nëpërmjet shmangjes, dhe kur shmangja nuk është e realizueshme, nëpërmjet zvogëlimit dhe zbutjes së efekteve të mundshme negative që shkaktohen nga aktivitetet e financuara nga BERZH, në një mënyrë të përshtatshme dhe proporcionale.

Kuadri i zbatimit

¹ Të tilla si vijon:

- Konventa lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës, 1972 (Konventa e Trashëgimisë Botërore të UNESCOs)
- Konventa e Ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore të Pazëvendësueshme 2003 (Konventa e Trashëgimisë së Pazëvendësueshme e UNESCOs)
- Konventa e Mbrojtjes së Trashëgimisë Nënujore 2001 (Konventa e Trashëgimisë Nënujore e UNESCOs)
- Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore të Shoqërisë 2005
- Traktati ICOMOS i Australisë për Ruajtjen e Vendeve të Rëndësishme të Vecantë Kulturore (Traktati *Burra*) (ICOMOS Australi)

6. Kjo Politikë duhet të zbatohet kur një projekt mendohet se do të prekë trashëgiminë kulturore të pazëvendësueshme. Masat e kësaj Kërkese Performance zbatohen pavarësisht nëse trashëgimia kulturore ka qenë e mbrojtur ligjërisht ose e shqetësuar më parë.
7. Për qëllimet e kësaj Kërkese Performance, termi trashëgimi kulturore përkufizohet si një grup burimesh të trashëguara nga e kaluara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht se kush i zotëron, si një reflektim dhe shprehje e vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave të tyre që janë në një evolucion konstant. Ajo përfshijnë trashëgimi të prekshme (fizike) dhe të paprekshme, kufijtë e të cilave janë subjekt i një debati të madh ndërmjet ekspertëve të trashëgimisë. Trashëgimia kulturore mund të vlerësohet në nivelin lokal, rajonal, ose kombëtar, ose brenda komunitetit ndërkombëtar².
 - Trashëgimia kulturore fizike ka të bëjë me objekte, vendndodhje, grupe strukturash të lëvizshme ose të palëvizshme, si dhe me veçori natyrore dhe pejzazhe që kanë një rëndësi arkeologjike, paleontologjike, historike, arkitekturore, fetare, estetike ose një rëndësi tjetër kulturore.
 - Trashëgimia kulturore e paprekshme nënkupton praktikën, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, mjeshtritë-si dhe instrumentet, objektet, artikujt dhe hapësirat kulturore të lidhura me to, që njihen nga komunitetet, grupet dhe, në disa raste, nga individët, si pjesë e trashëgimisë së tyre kulturore dhe të cilat transmetohen nga gjenerata në gjeneratë³.
8. BERZH arsyeton se vendndodhja ose objektet që kanë vlerë ose rëndësinë e një trashëgimie kulturore mund të zbulohen në pozicione të papritura, gjatë zbatimit aktual të një projekti të miratuar. Si rezultat, thuhet se një projekt është subjekt i masave të kësaj Kërkese Performance nëse ai
 - përfshin gërmime, shkatërrime, zhvendosje toke, përmbytje ose ndryshime të tjera të rëndësishme në mjedisin fizik,
 - ndodhet mbi, ose në afërsi të, një vendndodhje trashëgimie kulturore të njohur nga vendi i punimeve, ose
 - mund të ketë efekt negativ mbi kulturën, njohuritë dhe praktikën e Popullësive Vendase.
9. Zbatueshmëria e kësaj Kërkese Performance në raste të tjera do të përcaktohet nga Banka gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social (shih paragrafin 10 më poshtë). Projektet që janë hartuar specifikisht për të mbështetur konservimin ose administrimin e trashëgimisë kulturore rishikohen individualisht nga Banka. Nëse është e zbatueshme, Banka do të kryejë marrëveshje me klientin se si kërkesat e kësaj Kërkese Performance do të trajtohen dhe administrohen si pjesë e planit të përgjithshëm të veprimit mjedisor dhe social (PVMS) të klientit dhe/ose e sistemit të administrimit. Kërkesat e vlerësimit mjedisor dhe social dhe të administrimit janë të rreshtuara në Kërkesat e Performancës 1 dhe 10.

Kërkesat

Vlerësimi

Kontrulli për rreziqet ose ndikimet mbi trashëgiminë kulturore

² Ky përkufizim është në përputhje me Konventën Kuadër e Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore të Shoqërisë. Trashëgimi kulturore njihet edhe pasuri kulturore, vlera kulturore, burime kulturore ose pronë kulturore

³ Sic tregohet në Konventën e Ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore të Pazëvendësueshme

10. Që në një fazë të hershme të vlerësimit mjedisor dhe social (shih Kërkesën e Performancës 1), klienti duhet të identifikojë nëse ndonjë trashëgimi kulturore mund të preket negativisht nga projekti, dhe duhet të vlerësojë probabilitetin e gjetjes të rastësishme (shih paragrafin 16). Duke e bërë këtë, klienti duhet të konsultohet me ministrinë e duhura, me ekspertët dhe me komunitetet lokale në mënyrën e duhur⁴. Intensiteti i studimit të burimeve kulturore duhet të jetë i mjaftueshëm që të karakterizojë plotësisht risqet dhe ndikimet, në pajtim me metodën parandaluese, duke reflektuar njëkohësisht shqetësimet e grupeve të interesuar.

Efektet mbi trashëgiminë e paprekshme

11. Megjithëse efektet e mundshme mbi trashëgiminë kulturore të paprekshme mund të jenë më pak të dukshme sesa efektet mbi trashëgiminë kulturore të prekshme, ato mund të jenë të një rendësie të barabartë. Nëse mjedisi është thelbësor për të ruajtur mjeshtëritë, njohuritë dhe besimet tradicionale, çdo rivendosje ose shkëputje do të shkaktonte humbjen e gjuhës tradicionale, besimeve dhe/ose humbjen e dialekteve dhe gjuhëve më pak të rëndësishme dhe mund të conte në shpërbërjen përfundimtare të komunitetit.

Shmangja e efekteve

12. Klienti është përgjegjës për vendosjen dhe hartimin e projektit në mënyrë që të shmangë dëme të mëdha mbi trashëgiminë kulturore. Nëse identifikohen efekte të mundshme që në fazat e hershme të zhvillimit të projektit, duhet t'i jepet përparësi shmangjes së efekteve negative gjatë fazave të hartimit dhe të zgjedhjes së vendndodhjes.

Vlerësim i efekteve që nuk mund të shmangen

13. Kur efektet nuk mund të shmangen, klienti, bazuar në rezultatet e kontrollit paraprak, duhet të ndërmarrë studimet e duhura për të vlerësuar efektet e mundshme dhe, nëse është e nevojshme, duhet të kryejë ndryshimet e duhura në hartimin e projektit. Shtrirja e këtyre studimeve duhet të vendoset në marrëveshje me BERZH rast pas rasti. Studimet duhet të kryhen nga specialistë të kualifikuar dhe me përvojë mbi trashëgiminë kulturore, qoftë si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm mjedisor dhe social në pajtim me Kërkesën e Performancës 1, ose më vete. BERZH mund të kërkojë përfshirjen e ekspertëve të jashtëm.
14. Vlerësimi dhe zbutja e efekteve mbi trashëgiminë kulturore duhet të kryhet në pajtim me masat respektive të ligjeve, rregullave dhe planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura, kombëtare dhe/ose lokale, sipas ligjet ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të pranuar në nivel ndërkombëtar. Në shumicën e vendeve të funksionimit të BERZH, ligjet ndalojnë zhvendosjen e objekteve dhe shkatërrimin e vendndodhjeve që kanë një trashëgimi kulturore fizike. Praktika e mirë e pranuar në nivel ndërkombëtar përfshijnë, por nuk është e kufizuar në: studime fushore arkeologjike ose paleontologjike, ekzaminim laboratorik i objekteve të gjetura, ekspozita që përmbajnë gjetje të reja, dhe dokumentacion.

Menaxhimi i efekteve mbi trashëgiminë kulturore

15. Bazuar në rezultatet e studimeve fushore, të vlerësimit të rëndësisë prej ekspertëve të trashëgimisë kulturore, të kërkesave të legjisllacionit kombëtar dhe të marrëveshjeve respektive ndërkombëtare, si dhe në bazë të rezultateve të konsultimeve me komunitetet e prekura (shih paragrafin 17), klientit do t'i kërkohet të zhvillojë masat e duhura zbutëse që të zvogëlojë dhe zbusë efektet negative mbi trashëgiminë kulturore, së bashku me zbatimin e programit dhe buxhetit të duhur për këto masa. Këto masa zbutëse mund të përfshihen në Plan Veprimin Mjedisor dhe Social për projektin ose në një Plan të veçantë për Administrimin e Trashëgimisë Kulturore. Klienti gjithashtu duhet të sigurojë se ka vënë në dispozicion një staf të kualifikuar për të mbikqyrur zbatimin e masave zbutëse, dhe se të

⁴ Shih KP 1 dhe 10. Në rastin e projekteve të kategorisë A, kjo duhet të diskutohet gjatë fazës së hartimit. Shih sesionin 10 të KP 10.

gjithë kontraktorët që punojnë për projektin kanë aftësitë dhe ekspertizën e duhur dhe që janë të administruar dhe kontrolluar në pajtueshmëri me paragrafin 19 të Kërkesës së Performancës 1.

Procedurat e gjetjeve rastësore

16. Klienti duhet të sigurojë se janë marrë masat për të administruar gjetjet rastësore, të përkufizuara si trashëgimi kulturore fizike të gjetura në mënyrë të papritur gjatë zbatimit të projektit. Këto masa duhet të përfshijnë njoftimin e organeve kompetente për objektet ose vendndodhjet e gjetura; njoftimin e personelit të projektit për mundësinë e gjetjeve rastësore që mund të zbulohen; dhe rrethimin e hapësirës së gjetjeve në mënyrë që të shmangët çdo shqetësim ose shkatërrim i mëtejshëm. Klienti nuk duhet të prekë asnjë nga gjetjet rastësore derisa të bëhet një vlerësim nga një specialist i posaçëm dhe i kualifikuar, dhe derisa të identifikohen veprime pasuese sipas legjislacionit të vendit dhe kësaj Kërkesë Performance.

Konsultimi me komunitetet e prekura

17. Kur një projekt mund të prekë trashëgiminë kulturore, klienti duhet të konsultohet me komunitetet e prekura brenda vendit mikëpritës, të cilët përdorin ose kanë përdorur këtë trashëgimi kulturore për të mbajtur gjallë kujtimet për qëllime kulturore të vjetra, në mënyrë që të identifikojë trashëgiminë kulturore të rëndësishme, dhe duhet të përfshijë në procesin e tij të vendimmarrjes, pikëpamjet e komuniteteve të prekura mbi këto trashëgimi kulturore. Klienti duhet të ofrojë informacion tek komunitetet e prekura, në një gjuhë transparente dhe të përshtatshme, për sa i përket shtrirjes, pozicionit, kohëzgjatjes së projektit, si dhe aktiviteteve që mund të kenë efekte mbi trashëgiminë kulturore. Ky lloj konsultimi duhet të përmbushë kërkesat e Kërkesës së Performancës 10 dhe mund të jetë pjesë e një procesi konsultimi më të gjerë për sa i përket efekteve mjedisore dhe sociale të projektit, në pajtueshmëri me Kërkesën e Performancës 10. Konsultimi gjithashtu duhet të përfshijë autoritetet respektive kombëtare ose lokale, të cilët mbajnë përgjegjësi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ndikimet mbi trashëgiminë kulturore duhet të zbuten në mënyrën e duhur me pjesëmarrjen e informuar të komuniteteve të prekura.
18. Kur një projekt mund të dëmtojë seriozisht një trashëgimi kulturore, dhe dëmtimi ose humbja e kësaj të fundit mund të vërë në rrezik mbijetesën kulturore ose ekonomike të komuniteteve brenda vendit të punimeve, të cilët përdorin këtë trashëgimi kulturore për qëllime të vjetra kulturore, klienti duhet të zbatojë kërkesat e paragrafit 17 dhe nuk duhet të vijojë, përveç rasteve kur: (i) hyn në negociatë mirëbesimi me komunitetet e prekura; dhe (ii) dokumenton/tregon pjesëmarrjen e informuar të këtyre të fundit si dhe rezultatin e suksesshëm të negociatave.

Përdorimi i trashëgimisë kulturore nga projekti

19. Kur një projekt propozon përdorimin e burimeve kulturore, njohurive, risive, ose praktikave të komuniteteve lokale, duke materializuar jetesën tradicionale për qëllime tregtare, klienti duhet të informojë këto komunitete për: (i) të drejtat e tyre sipas ligjit të vendit; (ii) shtrirjen dhe natyrën e zhvillimit të propozuar tregtar; dhe (iii) pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë. Klienti duhet të kryejë një komercializim të tillë vetëm kur ai: (i) hyn në negociatë mirëbesimi me komunitetet lokale të prekura duke materializuar jetesën tradicionale; (ii) dokumenton pjesëmarrjen e informuar të këtyre të fundit dhe rezultatin e suksesshëm të negociatave; dhe (iii) siguron një ndarje të drejtë dhe të paanshme të përfitimeve që rrjedhin nga komercializimi i njohurive, risive, ose praktikave, në pajtueshmëri me zakonet dhe traditat e tyre. Kur një projekt propozon përdorimin e

KP 9: Ndërmjetësit Financiarë

Hyrje

1. Ndërmjetësit financiar (FI) janë një instrument kyç për BERZH për të promovuar tregje të qëndrueshme financiare dhe për të ofruar një mjet për të kanalizuar financimet e BERZH tek sektori i mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME). Njëpërmjet rrjetit të saj të ndërmjetësve financiarë partnerë, BERZH mund të mbështesë zhvillimin ekonomik në nivel sipërmarrje që është më e vogël se sa do të ishte njëpërmjet investimit direkt nga BERZH. BERZH mbështet një larmshmëri institucionesh që ofrojnë shërbim financiar, si për shembull fonde private kapitali, banka, kompani që merren me qeramarrje dhe qeradhënie, kompani sigurimi dhe fonde pensioni. Ndërmjetësit financiarë angazhohen në një larmi aktivitete, siç është mikro-financimi, dhënia e huasë tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, financim tregtar, financim korporatash ose projektesh me afat të mesëm, si dhe afatgjatë, dhe financim strehe.
2. Vetë natyra e financimit të ndërmjetëm nënkupton se BERZH do të ngarkojë Ndërmjetësit Financiarë me përgjegjësinë për vlerësimin dhe monitorimin e transaksioneve si dhe me administrimin e përgjithshëm të aksioneve. Administrimi i riskut mjedisor dhe social është pjesë e përgjegjësisë të ngarkuara mbi Ndërmjetësit Financiarë. Megjithatë, për shkak të marrëdhënies me Ndërmjetësit financiarë, BERZH vazhdon të jetë e interesuar për të vlerësuar dhe monitoruar nëse Ndërmjetësit financiarë kanë trajtuar në mënyrën e duhur risqet mjedisore dhe shoqërore të lidhura me aktivitetet e biznesit të tyre. Mënyrat e përpikta të delegimit dhe të kontrollit të BERZH do të varen nga një numër faktorësh, duke përfshirë natyrën e Ndërmjetësit Financiar dhe aktivitetet e biznesit të tij, llojin e financimit të ofruar dhe mjedisin e biznesit në vend.

Objektivat

3. Objektivat e kësaj Kërkese Performance janë:
 - të përcaktojë një mënyrë praktike me të cilën urdhri i Bankës për të promovuar zhvillim të qëndrueshëm, të mund të zbatohet në investimet e Ndërmjetësve të saj financiarë, në pajtueshmëri me praktikën më të mirë ndërkombëtare në sektorin financiar komercial;
 - të mundësojë Ndërmjetësit Financiarë të administrojnë risqet mjedisore dhe sociale të lidhura me aktivitetet e bizneseve të tyre dhe të promovojë praktika të mira mjedisore dhe sociale për biznesin tek klientët e tyre;
 - të promovojë administrimin e mirë të mjedisit dhe të burimeve njerëzore brenda Ndërmjetësve Financiarë.

Qëllimi i Aplikimit

4. Kjo Kërkese Performance zbatohet tek të gjitha projektet e klasifikuara si “Ndërmjetës Financiar” në vijim të paragrafit 24 të Politikës.
5. Për qëllimet e kësaj Kërkese Performance, fjala “projekt” përdoret për t’ju referuar transaksionit të BERZH me Ndërmjetësit Financiar, ndërsa “nën-projekt” përdoret për t’ju referuar klientëve/projekteve të financuara nga Ndërmjetësit Financiar.
6. Kur BERZH financon një linjë krediti ose ndonjë tjetër lloj financimi të planifikuar, kërkesat e kësaj Kërkese Performance duhet të zbatohen tek të gjitha nën-projektet e financuara duke përdorur fondet e BERZH.
7. Kur BERZH ofron financim me kapital ose gjysëm-kapital tek një Ndërmjetës Financiar, kërkesat e kësaj Kërkese Performance duhet të zbatohen tek i gjithë portofoli i nën-

projekteve komerciale të Ndërmjetësve Financiarë që kanë filluar në kohën kur BERZH është bërë aksionere ose investitore, në pajtueshmëri me paragrafin 16 më poshtë.

8. Kur BERZH gjykon se një projekt i Ndërmjetësit Financiar ka risqe minimale (ose nuk ka fare risqe) mjedisore ose sociale, nuk duhet të zbatohet asnjë kërkesë specifike dhe Ndërmjetësit Financiar nuk i duhet të adaptojë asnjë procedurë për administrimin e risqeve mjedisore dhe sociale.

Kërkesat

Proçesi i vlerësimit (*due diligence*) mjedisor dhe social dhe procedurat e monitorimit

9. Ndërmjetësi Financiar do të adoptojë dhe zbatojë proçesin e vlerësimit (*due diligence*) mjedisor dhe social si dhe procedurat e monitorimit (që këtej e tutje: “Procedurat”) konform nivelit të risqeve mjedisore dhe sociale që janë të lidhura me aktivitetet e biznesit të tij dhe me llojin e projektit të zhvilluar me BERZH. Këto Proçedura do të vendosen bashkarisht me BERZH.
10. Kur një Ndërmjetës Financiar demonstroi se ka në dispozicion një grup procedurash për administrimin e riskut mjedisor dhe financiar, BERZH do të rishikoj përmbytjen e këtyre të fundit si dhe kapacitetin zbatues që ka Ndërmjetësi Financiar kundrejt kërkesave të kësaj Kërkesë Performance.
11. Ndërmjetësi Financiar duhet të hartojë Procedurat në mënyrë që të garantojë se kërkesat e paragrafeve 13-16 më poshtë janë plotësuar. Proçedurat duhet të përfshijnë gjithashtu mekanizma për vlerësimin dhe monitorimin e riskut në mënyrën e përshtatshme, duke përfshirë:
 - një kategorizim të riskut të nën-projekteve të propozuara;
 - ndërmarrjen e proçesit të vlerësimit për klientët dhe nën-projektet, konform me risqet e identifikuar;
 - strukturimin e nën-projekteve në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat kombëtare për mjedisin, shëndetin, sigurinë, punën dhe konsultimin publik duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, detyrimin e klientëve për të zbatuar plan-veprimet korrigjuese; dhe
 - monitorimin e nën-projekteve në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëria me kërkesat kombëtare për mjedisin, shëndetin, sigurinë, punën dhe konsultimin publik, dhe, aty ku duhet, plan-veprime korrigjuese.
12. Për të ndihmuar Ndërmjetësin Financiar që të vërë në praktikë Proçedurat, BERZH ka hartuar një manual për administrimin e riskut mjedisor dhe social (“EManual”), i cili përfshin modele proçedurash dhe udhëzime për lloje të ndryshme Ndërmjetësish Financiar dhe shërbimesh financiare. Ndërmjetësve Financiarë që nuk kanë në dispozicion proçedura ekuivalente, u kërkohet që të përdorin pjesë të EManual për sa u përket nën-projekteve respektive.

Kërkesat për nën-projektet

13. Ndërmjetësit Financiarë duhet të shqyrtojnë të gjithë nën-projektet në bazë të Listës së Përfshirjes Mjedisore dhe Social të Bankës në Shtojcën 1 të kësaj Kërkesë Performance. Nën-projektet që përfshijnë aktivitete të biznesit që janë të përfshira në këtë listë nuk janë të pranueshme për mbështetje nga Ndërmjetësi Financiar dhe aplikimet që përfshijnë të tilla aktivitete duhet të refuzohen.
14. Shtojca 2 e kësaj Kërkesë Performance përfshin një sërë aktivitete të biznesit që kanë risqe të larta sociale dhe mjedisore. Kur një nën-projekt përfshin aktivitete të listuara në Shtojcën 2 të kësaj Kërkesë Performance, Ndërmjetësi Financiar duhet të raportojë këtë

15. Ndërmjetësit Financiarë duhet t'u kërkojnë të gjithë klientëve të pajtohen me rregullat dhe standartet kombëtare për sa i përket: (i) mjedisit, (ii) konsultimit publik, dhe (iii) punësimit, duke përfshirë pa kufizime, shëndetin dhe sigurinë në punë, punën e fëmijëve, punën e detyruar; mosdiskriminim për sa i përket punësimit, dhe lirisë për të krijuar shoqëri dhe për negociuar kolektivisht.
16. Kur Ndërmjetësit Financiarë ofrojnë një financim projekti¹ nën një Linjë Krediti të BERZH me një kosto kapitali të projektit prej 10 million US \$ ose më shumë, për nën-projekte që përfshijnë: (i) zhvillime të reja ose (ii) zgjerim apo përmirësim të një aktiviteti ekzistues ku ndryshimet në masë ose në shtrirje mund të shkaktojnë efekte shtesë mjedisore ose sociale të konsiderueshme, këto nën-projekte duhet të plotësojnë Kërkesat e Performancës 1-8 dhe 10 të BERZH.
17. BERZH mund të caktojë kërkesa shtesë ose alternative mjedisore dhe sociale, në varësi të natyrës së Ndërmjetësit Financiar dhe të portofolit të tij të aksioneve dhe në varësi të vendit ku kryhen punimet².

Kapaciteti organizativ brenda Ndërmjetësit Financiar

18. Ndërmjetësi Financiar do të ruajë politikat e veta të burimeve njerëzore, sistemet dhe praktikatat e veta të administrimit në pajtueshmëri me Kërkesën e Performancës 2 të BERZH-Puna dhe kushtet e punës.
19. Ndërmjetësi Financiar duhet të caktojë një punonjës të administratës me përgjegjësi të plotë për çështjet mjedisore dhe sociale, duke përfshirë zbatimin e Proçedurave.
20. Në varësi të madhësisë së Ndërmjetësit Financiar dhe të aktiviteteve të biznesit të tij, Ndërmjetësi Financiar duhet gjithashtu të: (i) emërojë një ose më shumë punonjës si përgjegjës për të kontrolluar zbatimin e përditshëm të Proçedurave, dhe për të ofruar

¹ Financa e projektit është një metodë financimi në të cilën dhënësi i huasë shqyrton së pari tek të ardhurat e gjeneruara prej një projekti të vetëm, si burim ripagimi dhe siguracion për ekspozimin. Ky tip financimi është i zakonshëm për industrinë e mëdha, komplekse dhe të kushtueshme të cilat mund të përfshijnë për shembull termocentrale, fabrika kimike dhe përpunimi, miniera, infrastrukturë për transportin, infrastrukturën e mjedisit dhe telekomunikacionit. Financa e projektit mund të marrë formën e financimit të ndërtimit të instalimeve kapitale të reja, ose rifinancimin e atyre eksistuese, me ose pa përmirësime. Në transaksione të tilla, huadhënësi është pagues i vetëm ose gati ekskluzivisht për paratë e kontratave të prodhimit të këtij investimi, të tillë si energjia elektrike e shitur prej termocentralit elektrik. Huamarrësi është zakonisht një Entitet i Vecantë që nuk i lejohej të kryejë ndonjë funksion tjetër përveç zhvillimit, pronësisë, dhe funksionimit të impjantit. Pasoja është se pagesat varen prej të ardhurave nga projekti dhe mbi verën kolaterale të aseteve të projektit. Burimi: Komiteti i Bazelit për Supervizionin Bankar Nëntor 2005, Shih www.bis.org/publ/bcbs118.pdf

² Për shembull, nëse vendi nuk ka ratifikuar dhe transpozuar në ligjin e vendit të gjitha Konventat e ONP (konventën 29 dhe 105 (punën e detyruar) 87 (lirinë e organizimit) 98 (të drejtën e negociimit kolektiv) 100 dhe 111 (diskriminimin), 138 (moshën minimale) 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve)

ndihmë për zbatimin; (ii) të sigurohet se punonjësve u ofrohet një ekspertizë teknike e mjaftueshme për të vlerësuar transaksionet që kanë risqe shumë të mëdha mjedisore ose sociale, qofshin këta specialistë të brendshëm ose të jashtëm.

21. Ndërmjetësi Financiar duhet të sigurojë se Proçedurat dhe kërkesat e paraqitura në paragrafet 9-20 janë komunikuar qartë tek i gjithë stafi, dhe duhet të ofrojë trajnimin e duhur në mënyrë që të sigurojë se stafi ka aftësitë e nevojshme dhe do t'i ndihmojë për t'i zbatuar.

Raportimi tek BERZH

22. Ndërmjetësi Financiar duhet të dorëzojë tek BERZH raporte periodike (zakonisht vjetore) mbi zbatimin e Proçedurave dhe performancën mjedisore dhe sociale të portofolit të vetë të investimeve/huadhënieve. Formate standarte të raportimit përfshihen në EManual.

Përfshirja e grupeve të interesuara

23. Ndërmjetësi Financiar duhet të krijojë një sistem për komunikimin e jashtëm të çështjeve mjedisore dhe sociale, i cili duhet të ketë një pikë kontakti për të trajtuar kërkesat dhe shqetësimet publike lidhur me çështjet mjedisore dhe sociale. Ndërmjetësi Financiar duhet t'u përgjigjet këtyre kërkesave dhe shqetësimeve në kohë.

Praktikat më të mira

24. BERZH nxit të gjithë Ndërmjetësit Financiarë që të ndjekin praktikat më të mira në menaxhimin e qëndrueshmërisë në të gjitha huadhëniet dhe operacionet e investimeve, pavarësisht nëse ato financohen nga BERZH. Në veçanti, Ndërmjetësit Financiarë janë të nxitur të
 - raportojnë periodikisht tek grupet e jashtme të të interesuarve se si ata i trajtojnë çështjet mjedisore dhe sociale në bizneset dhe aktivitetet e tyre. Kjo mund të bëhet, për shembull, duke përfshirë në Raportin Vjetor të Ndërmjetësit Financiar, në faqen e tij të internetit ose në ndonjë dokument tjetër publik, një seksion i cili përmbledh angazhimin e tij në kërkesat e paraqitura në këtë Kërkesë Performance.
 - punojnë për të zbatuar praktikat më të mira në administrimin e brendshëm mjedisor (përfshirë efikasitetin e energjisë dhe burimeve, reduktimin e mbeturinave dhe riciklimin)
 - zbatojnë Proçedurat e EManual në të gjitha aktivitetet e biznesit të tyre, duke përfshirë ato mbi të cilat nuk aplikohet kjo Kërkesë Performance.
 - identifikojnë, aty ku është e përshtatshme, mundësitë për të zhvilluar produkte financiare me përfitime të mëdha mjedisore dhe/ose sociale (për shembull, financim për investime në efikasitetin e energjisë, në burime të ripërtëritshme ose në biznesin që është pro-biodiversitetit, produkte që u drejtohen grave sipërmarrëse, aksesit në kredit për mikro-sipërmarrësit).

Udhëzime të mëtejshme mbi praktikat më të mira janë të disponueshme në EManual të BERZH. Ndërmjetësit Financiarë duhet të konsiderojnë edhe mundësinë për të marrë pjesë në nismat ekzistuese të përshtatshme ndërkombëtare, të cilat promovojnë praktikat më të mira në sektorin financiar, si p.sh Parimet e Ekuatorit, Iniciativa e Financimit UNEP, dhe Parimet për Investim Me Përgjegjësi³.

³ Parimet e Ekuatorit: www.equator-principles.com; Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP); Nisma Financiare www.unepfi.org; Parimet për Investimet e Përgjegjshme www.unpri.org

KP 9 - Shtojca 1:
Lista e BERZH për Përrjashtimin Mjedisor dhe Social

BERZH nuk do të financojë me vetëdije, në mënyrë direkte ose indirekte, projekte që përfshijnë çka vijon:

- a) Prodhimin ose tregtimin e çdo produkti ose aktiviteti të quajtur ilegal nga ligjet ose rregullat e shtetit mikpritës (d.m.th kombëtare), ose nga marrëveshjet ndërkombëtare, ose që janë subjekt i ndalimeve ndërkombëtare, si p.sh:
 - i. Prodhim ose tregtim i produkteve që përmbajnë PCB⁴
 - ii. Prodhim ose tregtim i produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe substancave të tjera të rrezikshme, të cilat janë subjekt i ndalimeve ndërkombëtare⁵
 - iii. Prodhim ose tregtim i substancave që çlirojnë ozon, të cilat janë subjekt i ndalimeve ndërkombëtare⁶
 - iv. Tregtim i kafshëve të egra ose prodhim i produkteve të kafshëve të egra, të cilat rregullohen nga CITES⁷
 - v. Lëvizje ndërkufitare të mbeturinave, e cila është e ndaluar nga ligji ndërkombëtar⁸
- b) Prodhim ose përdorim ose tregtim i fibrave të palidhura të asbestit ose i produkteve që përmbajnë asbest⁹
- c) Aktivitete të ndaluara nga legjislacioni i vendit mikpritës ose nga marrëveshjet ndërkombëtare për sa i përket mbrojtjes së burimeve të biodiversitetit ose të trashëgimisë kulturore¹⁰
- d) Peshkim me rrjeta në mjedisin detar ku rrjetat i tejkalojnë 2.5 km në gjatësi.
- e) Transportim i naftës ose substancave të tjera të rrezikshme në anije-cisterna që nuk i përmbushin kërkesat IMO¹¹

⁴ PCB – bifenole të poliklorinuar – një grup lëndësh kimike shumë helmuese. PCBtë mund të gjenden në transformatorët elektrikë të mbushur me vaj, dhe shkëmbyesit e energjisë të prodhuar në vitet 1950-85.

⁵ Dokumentat e referuar janë Rregullorja e BEsë (EEC) Nr. 2455/92 lidhur me eksportin dhe importin e disa lëndëve kimike të rrezikshme, e amenduar. Lista e konsoliduar e KB, konsumi i të cilave është i ndaluar, tërhequr nga tregu, shumë të kufizuara ose të pamiratuara prej Qeverive; Konventa për procedurat e informimit të hershëm për kimikatet dhe pesticidet e rrezikshme në tregun botëror (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit e qëndrueshëm organikë, Klasifikimi i pesticideve sipas rrezikshmërisë i OBSH

⁶ Substancat ozon-holluese: Substanca kimike të cilat veprojnë dhe hollojnë ozonin stratosferik, të cilat cojnë në të ashtuquajturat vrma të ozonit. Protokollit i Montrealit liston këto substanca dhe cakton objektivin për zvogëlimin e tyre dhe datat e heqjes nga përdorimi. Pranë BERZH, gjendet lista e substancave kimike të rregulluara sipas Protokollit të Montrealit që përfshin aerosole, lëndët ftohëse, agjentët shkumëformues, lëndët holluese dhe lëndët zjarrfikëse së bashku me hollësitë rreth vendeve nënshkruese dhe datat për heqjen e tyre nga qarkullimi

⁷ CITES: Konventa për tregëtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër. Lista e llojeve të mbrojtura nga CITES gjenden në www.cites.org/eng/app/index.shtml

⁸ Dokumentat e referuar janë: Rregullorja e KE nr 1013/2006 e 14 qershorit 2006 mbi transportin e mbetjeve; Vendimi C (2001) 107/Final i Këshillit të OECD lidhur me rishikimin e Vendimit C (92)39/Final mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të destinuara për operacione rehabilituese; Konventa e Bazelit e 22 marsit 1989 mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimin e tyre.

⁹ Kjo dispozitë nuk zbatohet për blerjen dhe përdorimin e cimentos prej asbesti ku sasia është më pak se 20%

¹⁰ Konventat ndërkombëtare respektive përfshijnë pa kufizime: Konventën për Ruajtjen e Llojeve migratore të kafshëve të egra (Konventa e Bonit); Konventa e ligatave me rëndësi ndërkombëtare vecanërisht e zonave të lagta (Konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e jetës së egër të Evropës dhe habitateve natyrore (Konventa e Bernës); Konventa e Trashëgimisë botërore, Konventa e Shumëllojshmërisë biologjike

¹¹ Kjo përfshin: tankerët të cilët nuk plotësojnë të gjithë kërkesat e certifikatave MARPOL SOLAS, pa kufizim, kodim e përputhshmërisë ISM, tankerët e futur në listen e zëzë nga BE ose të ndaluar nga Marrëveshja e Mirëkuptimit e Parisit mbi kontrollin e porteve publike (Paris MoU) dhe tankerët që janë duke dalë jashtë përdorimit sipas rregullores 136 të MARPOL. Asnjë tanker më i vjetër se 25 vjet nuk duhet përdorur.

- f) Tregtim i produkteve pa pasur liçencat e duhura të importit ose të eksportit, ose prova të tjera autorizimi për transportim nga shtetet relative të eksportit, importit, dhe, aty ku zbatohet, të transportimit.

KP 9 Shtojca 2: Financimi nga Ndërmjetësit Financiarë i aktiviteteve të mëposhtme të biznesit, që janë të ndjeshme në aspektin mjedisor ose social, është subjekt i drejtimit tek BERZH.

Kërkesa e Performancës bazë që pritet të plotësohet nga transaksionet e propozuara është e shkruar me shkrim të pjerrët.

- a) Aktivitete që përfshijnë strehim të padëshiruar- *Kërkesa e Performancës 5 e BERZH*
- b) Aktivitete brenda, ose afër zonave të mbrojtura nga ligji i vendit ose nga marrëveshjet ndërkombëtare, zonat me interes shkencor, habitate të llojeve të rralla/në rrezik, peshkimi me rëndësi ekonomike, dhe pyje të një rëndësie ekologjike- *Kërkesa e Performancës 6 e BERZH*
- c) Aktivitete brenda ose afër tokës së zënë nga Popullësitë Vendase dhe/ose nga grupe të cënuara, përfshirë toka dhe kanale të përdorura për aktivitete të jetesës siç janë rritja e bagëtive, gjuetia, ose peshkimi - *Kërkesa e Performancës 7 e BERZH*
- d) Aktivitete të cilat mund të ndikojnë negativisht në vendndodhjet me rëndësi kulturore ose arkeologjike- *Kërkesa e Performancës 8*
- e) Aktivitete në ciklin e prodhimit të lëndëve djegëse bërthamore (gërrmim, prodhim, pasurim, depozitim uranumi, ose transport i lëndëve djegëse bërthamore)¹²
- f) Prodhim energjie duke përdorur lëndë djegëse bërthamore (pa përfshirë eksportin/importin e energjisë)¹³
- g) Aktivitete që përfshijnë lëshimin e OMGJve në mjedisin natyror-*Kërkesa e Performancës 6 e BERZH.*

¹² Në përmbushje të Politikës së BERZH për Energjinë, Banka lejohet të përdorë fondet e saj (direkt apo indirekt përmes FI-ve) në lidhje me përmirësimin e sigurisë në prodhimin e energjisë bërthamore, ose për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive dhe karburantit radioaktiv të përdorur, dhe për zbërthimin pa lidhje të drejtpërdrejtë me mbylljen e reaktorëve me rrezik të lartë. Cdo aktivitet tjetër në ciklin e prodhimit të karburantit bërthamor është i përjashtuar prej financimit prej Ndërmjetësuesve Financiarë.

¹³ Në përmbushje të Politikës së BERZH për Energjinë, Banka lejohet të përdorë fondet e saj (direkt apo indirekt përmes FI-ve) në lidhje me përmirësimin e sigurisë në prodhimin e energjisë bërthamore, ose për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive dhe karburantit radioaktiv të përdorur, dhe për zbërthimin pa lidhje të drejtpërdrejtë me mbylljen e reaktorëve me rrezik të lartë. Cdo aktivitet tjetër përfshirë edhe prodhimin e energjisë duke përdorur karburant bërthamor është i përjashtuar prej financimit prej Ndërmjetësuesve Financiarë.

*h) Ndërtim i kasakadave të vogla për prodhim energjie hidro- Kriteret e
Pranueshmërisë së BERZH për Projekte Ujore të Vogla*

KP 10: Dhënia e Informacioni dhe Përfshirja e Grupeve të Interesuara

Hyrje

1. BERZH merr në konsideratë angazhimin e grupeve të interesuara si një pjesë e rëndësishme e praktikave të biznesit dhe qytetarisë së korporatës, dhe si një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e produkteve. Në veçanti, angazhimi efektiv i komunitetit është thelbësor për një administrim të suksesshëm të risqeve dhe ndikimeve mbi komunitetet e prekura nga projektet, si dhe për të arritur përfitime të përmirësuara për komunitetin.
2. Për sa i përket çështjeve mjedisore në veçanti, Banka mbështet qasjen e Konventës së Aarhusit, e cila e identifikon mjedisin si një *e mirë publike*. Kjo Konventë konfirmon të drejtën e publikut për tu informuar mbi gjendjen e mjedisit dhe mbi emetimet dhe shkarkimet që lëshohen në të; të drejtën për konsultim kuptimplotë mbi projektet e propozuara ose programet të cilat mund të prekin mjedisin, si dhe të drejtën për tu ankuar nëse ata mendojnë se mjedisi nuk po merret në konsideratë në mënyrën e duhur.
3. Angazhimi i grupeve të interesuara është një proces i vazhdueshëm i cili përfshijnë: (i) dhënien publike të informacionit të duhur nga klienti në mënyrë që të mundësohet një konsultim kuptimplotë me grupet e interesuar, (ii) konsultim kuptimplotë me personat që preken, dhe (iii) një procedurë ose politikë me të cilën njerëzit mund të bëjnë komente ose ankesa. Ky proces duhet të fillojë që në fazën më të hershme të planifikimit të projektit dhe të vazhdojë gjatë jetëgjatësisë së projektit.

Objektivat

4. Kjo Kërkesë Performance (“KP”) paraqet një metodë sistematike për angazhimin e grupeve të interesuara, e cila do të ndihmojë klientët që të ndërtojnë dhe të ruajnë gjatë kohës një lidhje konstruktive me grupet e lidhura me ta, sidomos me komunitetet lokale të prekura. Procesi i përfshirjes të grupeve të interesuara është një komponent i rëndësishëm i vlerësimit, administrimit dhe monitorimit të çështjeve mjedisore dhe sociale që janë të lidhura me investimet e klientit. Pra, kjo Kërkesë Performance duhet të lexohet së bashku me Kërkesën e Performancës 1.

Objektivat specifike të Kërkesave të Performancës 1 dhe 10 janë si vijon:

Vlerësimi dhe administrimi mjedisor dhe social (PR 1)	Dhënia e Informacionit dhe Përfshirja e Grupeve të Interesuara (PR 10)
<ul style="list-style-type: none">• Të identifikojë dhe vlerësojë efektet dhe çështjet mjedisore dhe sociale, qofshin negative apo fitimprurëse, të lidhura me projektin;• Të ndërmarrë masa për të shmangur, ose kur shmangja është e pamundur, për të minimizuar, zbutur ose kompensuar për efektet negative mbi punonjësit, komunitetet e prekura dhe mbi mjedisin;• Të identifikojë dhe, aty ku është e realizueshme, të shfrytëzojë mundësitë për të përmirësuar performancën mjedisore dhe sociale;• Të nxisë një përmirësim të performancës mjedisore dhe sociale nëpërmjet një	<ul style="list-style-type: none">• Të identifikojë njerëzit ose komunitetet që janë prekur ose mund të preken nga projekti, si dhe grupe të tjera të interesuarish;• Të sigurojë se këto grupe të interesuara janë angazhuar ashtu siç duhet në çështjet mjedisore dhe sociale të cilat mund ti prekin ata, nëpërmjet një procesi dhënieje të informacionit dhe konsultimit kuptimplotë;• Të ruajë lidhje konstruktive me grupet e interesuara në një mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet një përfshirjeje kuptimplotë gjatë zbatimit të projektit.

--	--

Kuadri i zbatimit¹

5. Banka duhet të bjerë dakord me klientin se si kërkesat relative të kësaj Kërkese Performance do të trajtohen si pjesë e procesit të përgjithshëm të vlerësimit mjedisor dhe social, planit të veprimtimit mjedisor dhe social (PVMS) dhe/ose sistemit të administrimit të klientit (e paraqitur në Kërkesën e Performancës 1).

Kërkesat

6. Përfshirja e grupeve të interesuara duhet të jetë e lirë nga manipulimi, ndërhyrja, shtrëngimi, dhe kanosja, dhe duhet të kryhet në bazën e informacionit të përpiktë, të duhur, të kuptueshëm dhe të arritshëm, në një format të përshtatshëm nga pikëpamja kulturore.
7. Natyra dhe frekuenca e përfshirjes së grupeve të interesuara duhet të variojë nga njëri projekt tek tjetri, në varësi të risqeve dhe ndikimeve negative që kanë mbi komunitetet e prekura, të ndjeshmërisë së sektorit dhe të mjedisit, si dhe të nivelit të interesit publik. Në mënyrë që të përshtaten karakteristikat e klientëve me ato të projektit, është e nevojshme që të gjithë klientët që kërkojnë financim nga BERZH të ndërmarrin hapat e paraqitura në paragrafët 8 deri në 10 më poshtë, sa më herët në procesin e vlerësimit mjedisor dhe social. Si pjesë e procesit të vlerësimit (*due diligence*), Banka do të vlerësojë nivelin e dhënies së informacionit dhe të konsultimit të kryer nga klienti kundrejt kërkesave të kësaj Kërkese Performance, dhe do të kërkojë angazhim shtesë. Kërkesat e ligjit të vendit për sa i përket informacionit publik dhe konsultimit, përfshirë ligjet që sanksionojnë detyrimet e shtetit mikpritës sipas ligjeve ndërkombëtare² duhet të plotësohen gjithmonë.

Përfshirja gjatë përgatitjes së projektit

Identifikimi dhe analiza e grupeve të interesuara

8. Hapi i parë në përfshirjen e suksesshme të grupeve të interesuara është që klienti të identifikojë individët ose grupet e ndryshme të cilët (i) janë të prekur ose mund të preken (në mënyrë direkte ose indirekte) nga projekti (“grupet e prekura”), ose (ii) mund të kenë një interes tek projekti (“grupe të tjera të interesuara”). Burimet për informacion publik dhe për konsultim duhet të përqëndrohen mbi grupet e prekura, në rradhë të parë.
9. Si pjesë e procesit të identifikimit të grupeve të interesuara, klienti duhet të identifikojë individët dhe grupet të cilët mund të jenë prekur në mënyrë të ndryshme ose jo-propocionale nga projekti për shkak të gjendjes së tyre jo të favorshme ose të cënueshme. Klienti gjithashtu duhet të identifikojë se si grupet e interesuar mund të preken dhe masën (aktuale ose të perceptuar) e ndikimeve të mundshme. Kur ndikimet janë të perceptuara, mund të kërkohet një komunikim shtesë në mënyrë që të ofrohet informacion dhe konfirmim i nivelit të vlerësuar të efekteve. Në identifikimin dhe analizën e grupeve të interesuara duhen përfshirë detaje, në mënyrë që të mundësojë Bankën të përcaktojë nivelin e komunikimit që është i përshtatshëm për projektin në fjalë. Punonjësit gjithmonë konsiderohen si grupe të interesuar.

¹ Në shtesë, kërkesa të vecanta për përgatitjen dhe përgjigjen në raste të emergjencës jepen në KP 4

² Për shembull Konventat e Arhusit dhe ESPOs

10. Në rastin e projekteve të Kategorisë A, klienti duhet të angazhohet në një proces së bashku me grupet e interesuara, për të siguruar identifikimin e të gjitha çështjeve kyçe që duhet të investigohen si pjesë e procesit ndikimit mjedisor dhe social. Ky proces duhet të lehtësojë përgatitjen e Planit për Përfshirjen e Grupeve të Interesuara për projektin. Si pjesë e këtij procesi, grupet e interesuara duhet të kenë mundësinë për të bërë komente dhe rekomandime mbi skicën fillestare të Planit të Përfshirjes së Grupeve të Interesuara dhe mbi dokumentat e tjera për shtrirjen e projektit.

Plani i përfshirjes të grupeve të interesuara

11. Klienti duhet të informojë BERZH se si do të trajtohet komunikimi me grupet e identifikuara të të interesuarve gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projektit, duke përfshirë llojin e procedurës së ankesave që është parashikuar (shih paragrafet 24-26 më poshtë). Nivelet e ndryshme të përfshirjes dhe konsultimit duhet të jenë të përshtatshme për grupet e prekura dhe për grupet e tjera të interesuara. Klienti duhet të zhvillojë procese të ndara për angazhimin e punonjësve dhe për angazhimin e komuniteteve të prekura; angazhimi me punonjësit për sa i përket kushteve të punës, siç janë shëndeti dhe siguria në punë, si dhe për marrëdhëniet në punë, duhet të ndjekë minimalisht kërkesat e Kërkesës së Performancës 2. Kur grupet e interesuara janë identifikuar si të pafavorizuara ose si të cënuara, duhet të ndërmerren metoda të veçanta dhe më shumë burime për të komunikuar me ta, në mënyrë që të kuptojnë plotësisht çështjet që ndikojnë. Klientët duhet të informojnë BERZH gjithashtu për çdo informacion të dhënë ose për aktivitetet e konsultimit të kryera përpara se të kërkojnë financimin nga BERZH.

Publikimi i informacionit

12. Publikimi i informacionit të lidhur me projektin, ndihmon grupet e interesuara të kuptojnë risqet, ndikimet dhe mundësitë e projektit. Nëse komunitetet mund të preken nga ndikime negative mjedisore ose sociale që vijnë nga projekti, atëherë klienti duhet t'u zbulojë atyre informacionin që vijon ("Informacioni"):
- qëllimin, natyrën dhe shkallën e projektit;
 - kohëzgjatjen e aktiviteteve të projektit të propozuar;
 - çdo risk dhe ndikim që ka të bëjë me mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, shëndetin dhe sigurinë publike dhe ndikime të tjera sociale mbi komunitetet, dhe planet e propozuara për zbutje;
 - procesi i parashikuar i konsultimit, nëse ekziston, dhe mundësitë dhe mënyrat në të cilat publiku mund të marrë pjesë; dhe
 - kohën/vendtakimin për takimet publike të parashikuara, dhe procesin me të cilin këto takime do të njoftohen, përmbledhen, dhe raportohen.
13. Informacioni duhet të publikohet në gjuhën/gjuhët lokale dhe në një mënyrë që është e arritshme dhe e përshtatshme nga pikëpamja kulturore, duke marrë parasysh njerëzit e cënuar (p.sh grupet etnike ose njerëzit e zhvendosur). Për projektet që kanë efekte të mëdha negative sociale ose mjedisore, dhënia e informacionit duhet të bëhet sa më herët në procesin e vlerësimit mjedisor dhe social.
14. Nëse është rënë dakord për një plan veprimi mjedisor dhe social (PVMS), klienti duhet ta paraqesë këtë plan për një projekt të Kategorisë A tek grupet e prekura. Në të gjitha rastet e tjera, klienti duhet të japë një përmbledhje jo-teknike. PVMS/përmbledhja duhet të publikohet në përputhje me paragrafin 13, dhe në faqen e internetit të klientit, nëse ekziston një e tillë. Në rast të ndryshimeve materiale në natyrën e projektit ose në ndikimet e tij, ose

Konsultimi kuptimplotë

15. Nevoja për konsultim specifik dhe natyra e tyre duhet të diskutohet me BERZH bazuar në identifikimin e grupeve të interesuara, analizën dhe përshkrimin e detajuar të projektit, dhe në varësi të natyrës dhe madhësisë së efekteve negative aktuale ose të mundshme mbi punonjësit dhe komunitetet e prekura. Kur punonjësit dhe/ose komunitetet e prekura janë, ose mund të jenë subjekt i rreziqeve ose efekteve negative të mëdha nga një projekt, klienti duhet të ndërmarrë një proces konsultimi kuptimplotë në një mënyrë që tu japë grupeve të prekura mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi rreziqet, ndikimet, dhe masat zbutëse të projektit, dhe që e lejon klientin ti konsiderojë këto pikëpamje dhe t'u përgjigjet atyre.

Konsultimi kuptimplotë:

- duhet të bazohet në dhënien e informacionit të duhur duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, dokumenta fillestare dhe plane, përpara se të merren vendime kur mundësitë janë akoma të hapura;
 - duhet të fillojë sa më herët në procesin e vlerësimit mjedisor dhe social;
 - duhet të fokusohet në rreziqet dhe efektet negative sociale dhe mjedisore, dhe në masat dhe veprimet e propozuara për ti zgjidhur ato; dhe
 - duhet të kryhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë evoluimit të natyrës së problemeve, ndikimeve dhe mundësive.
16. Proçesi i konsultimit duhet të bëhet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme nga pikëpamja kulturore. Klienti duhet të përshtas procesin e konsultimit me preferencat gjuhësore të grupeve të prekura, me procesin e tyre të vendim-marrjes, si dhe me nevojat e grupeve jo të favorizuara dhe të cënuara. Konsultimi duhet të përfshijë gjithashtu, përveç grupeve të prekura, grupe ose individë të cilët janë identifikuar si grupe të tjera të interesuara. Proçesi i konsultimit duhet të dokumentohet si pjesë e përkushtimit publik të klientit. Klienti duhet të informojë në kohë të gjithë ata që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik për vendimin përfundimtar mbi projektin, për masat zbutëse mjedisore dhe sociale, dhe për përfitimet e projektit për komunitetet lokale, së bashku me arsyet dhe konsideratat mbi të cilat është bazuar vendimi, dhe me mekanizmin e ankesave dhe çdo proces tjetër.

Publikimi dhe konsultimi për projektet e Kategorisë A

17. Projektet e klasifikuara si Kategoria A mund të rezultojnë në efekte të rëndësishme dhe të shumta negative në të ardhmen për mjedisin dhe/ose shoqërinë, të cilat nuk mund të identifikohen, vlerësohen dhe zbuten lehtësisht, por kërkojnë një proces vlerësimi të formalizuar dhe me pjesëmarrje. Kërkesat e publikimit dhe konsultimit zbatohen në çdo fazë të këtij procesi. Klientët duhet të sigurojnë një dialog kuptimplotë me grupet e prekura dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre të informuar në procesin e vendimmarrjes, në pajtueshmëri me paragrafet 12 deri në 16 më sipër. Pjesëmarrja e informuar përfshijnë konsultimin e organizuar dhe përsëritës, duke bërë që klienti të përfshijë në procesin e tij të vendimmarrjes, pikëpamjet e grupeve të prekura mbi çështje që i prekin ata në mënyrë direkte, si p.sh masat zbutëse të propozuara, ndarja e përfitimeve të zhvillimit dhe e mundësive, dhe çështjet e zbatimit. Njerëzit e prekur mund të kërkojnë një vlerësim të veçantë dhe mund të duhen burime për të kuptuar ndikimet dhe për të lejuar grumbullimin e informacionit të duhur.

18. Në rastin e projekteve që përfshijnë një VNM/VSM, klientët duhet të sigurohen se dhënia e informacionit dhe konsultimi të kryhen në përputhje me paragrafet 12-17. Informacioni i dhënë duhet të përfshijë një raport të plotë VNM/VSM në përputhje me kërkesat e Bankës³. Për më tepër, procesi i konsultimit duhet të përmbushë kërkesat e përpikmërisë për dhënien e informacionit tek BERZH, siç detajohet në paragrafin 3.4.1 të Politikës për Informacion Publik të Bankës, si dhe çdo kërkesë tjetër të zbatueshme nën ligjin e vendit për VNM dhe ligje të tjera relative. VNM/VSM duhet të jetë dokument publik gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit, dhe të përmirësohet me informacione shtesë.
19. Në rastin e projekteve që përfshijnë strehim të padëshiruar, të cilët prekin Popullësitë Vendase ose trashëgiminë kulturore, klienti duhet të zbatojë gjithashtu kërkesat speciale të Kërkesave të Performancës 5, 7 dhe 8.
20. Kur komunitetet lokale janë, ose mund të jenë, të prekura negativisht në mënyrë strikte dhe të përhershme nga një projekt, por nuk përfitojnë proporcionalisht nga ai, klienti duhet të angazhohet me komunitetet e prekura që të përcaktojë mundësitë për programe zhvillimi të komunitetit, nga të cilat ato mund të përfitojnë.

Përfshirja gjatë zbatimit të projektit dhe raportimit të jashtëm

21. Gjatë jetës së projektit, klienti duhet të ofrojë informacion të vazhdueshëm tek grupet e interesuara të identifikuar, konform me natyrën e projektit dhe ndikimet relative mjedisore dhe sociale të tij, dhe nivelin e interesit publik. Ky angazhim i vazhdueshëm duhet të ndërtohet mbi bazën e kanaleve të komunikimit dhe përfshirjes, të përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit (*due diligence*). Në veçanti, klientët duhet të përdorin praktika të përshtatshme për përfshirjen e komunitetit në mënyrë që të zbulojnë informacion dhe të marrin feedback për efektivitetin e zbatimit të masave zbutëse në PVMS, si dhe për interesat dhe shqetësimet e vazhdueshme të komuniteteve të prekura, për sa i përket projektit. Mund të duhet të jepet informacion shtesë gjatë fazave kyçe në ciklin e projektit, si për shembull përpara se të fillojnë ndërtimet, ose përpara se të fillojnë operacionet.
22. Kur komunitetet e prekura janë identifikuar gjatë përgatitjes së projektit, klienti duhet t'u ofrojë atyre raporte periodike mbi progresin, duke zbatuar PVMS, për sa i përket çështjeve që përfshijnë rreziqe ose ndikime të vazhdueshme mbi ta, dhe për çështje të tjera të cilat janë konsideruar si shqetësuese për komunitetin, nga procesi i konsultimit ose nga mekanizmi i ankesave. Këto raporte duhet të jenë në një format të arritshëm për komunitetet e prekura, dhe frekuenca e tyre do të jetë proporcionale me shqetësimet e komuniteteve të prekura, por jo më pak se një herë në vit. Nëse ka ndryshime materiale në projekt, të cilat çojnë në shtimin e efekteve ose çështjeve shqetësuese për komunitetin, klienti duhet të informojë ata se si këto ndikime dhe probleme po trajtohen nga PVMS i rishikuar. Nëse këto ndikime negative shtesë mbi komunitetet e prekura janë të rëndësishme dhe të larmishme, Banka, do të kërkojë aktivitete konsultimi shtesë, për secilin rast, në përputhje me paragrafet 15 deri në 20. Klienti nxitet të japë informacion edhe në faqen e internetit për të mirën e grupeve të tjera të interesuara.
23. Për më tepër, klienti nxitet të publikojë raporte të rregullta tek grupet e jashtme të interesuar, mbi performancën e tij mjedisore dhe sociale, si p.sh si pjesë e Raportit Vjetor ose të ndonjë dokumenti tjetër publik, ose publikim më vete, ose në faqen e internetit.

Mekanizmi i ankesave

³ Formati i VNM/VSM në përputhje me Direktivën e BE-së për VNM gjenden pranë BERZH

24. Klienti duhet të jetë në dijeni dhe t'u përgjigjet në kohë shqetësimeve të grupeve të interesuara lidhur me projektin. Për këtë qëllim, klienti duhet të ngrëjë një mekanizëm, proces ose procedurë ankesash, me anë të cilit duhet të lehtësojë zgjidhjen e problemeve dhe ankesave të grupeve të interesuara, mbi performancën mjedisore dhe sociale të klientit. Mekanizmi i ankesave duhet të përshtatet me risqet dhe efektet e mundshme negative të projektit.
25. Mekanizmi, procesi ose procedura e ankesave duhet të trajtojë problemet me përpikmëri dhe efektivisht, duke përdorur një proces të kuptueshëm dhe transparent i cili të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja kulturore dhe lehtësisht i arritshëm nga të gjitha segmentet e komuniteteve të prekura, pa asnjë kosto dhe pa ndëshkim. Mekanizmi, procesi ose procedura nuk duhet të bllokojë aksesin në çështje gjyqësore ose administrative. Për projektet në të cilat aplikohen Kërkesat e Performancës 5 dhe 7, klienti duhet të sigurojë që ekziston një mekanizëm apeli i pavarur dhe objektiv. Klienti duhet të informojë komunitetet e prekura për procesin e ankesave gjatë aktiviteteve përfshirëse të komunitetit, dhe duhet të raportojë rregullisht tek publiku për sa i përket zbatimit, duke ruajtur privatësinë e individëve.
26. Mekanizmat e ankesave për punonjësit duhet të jenë të ndara nga mekanizmat e ankesave për publikun dhe duhet të jenë në përputhje me Kërkesën e Performancës 2.

Financimi i korporatës

27. Klientët me operacione në disa vendndodhje, të cilët duan të marrin një financim të përbashkët, me kapital aktiv ose një financim me kapital, duhet të adaptojnë dhe zbatojnë një program komunikimi dhe informimi për grupet e interesuara për korporatën, në përputhje me paragrafet 22 dhe 25 më sipër. Programi i përfshirjes të grupeve të interesuara duhet të jetë konform me natyrën e biznesit të kompanisë dhe me efektet relative mjedisore dhe sociale të saj, si dhe me nivelin e interesit publik. Programi duhet të zbatohet në aktivitete. Ky program duhet të përfshijë procedura dhe burime për të siguruar përfshirjen e duhur të grupeve të interesuara në aktivitetet, dhe se grupet e interesuara me aktivitetet marrin informacion mbi performancën mjedisore dhe sociale. Të paktën një herë në vit, klientët duhet të prodhojnë raporte publike për performancën e tyre sociale dhe mjedisore, duke përfshirë një përmbledhje jo-teknike të çdo PVMS, dhe progresin e bërë me zbatimin e tyre, përkundrejt treguesve dhe objektivave të vendosura. Për të gjitha projektet e investimit që kategorizohen si A nën Praktikën e BERZH, klienti duhet të zbatojë procesin e përfshirjes të grupeve të interesuara, i cili paraqitet në paragrafet 6-20 më sipër.